REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
**KOORDINATORI KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT**

draft

# RAPORTI I MONITORIMIT
## PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2023

# STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2015 – 2023

www.drejtesia.gov.al

**TABELA E PËRMBAJTJES**

**I. Informacion përmbledhës mbi Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 dhe Planit të Veprimit 2020-2023**

1.1 Metodologjia e monitorimit
1.2 Konsultimi publik

**II. Progresi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit**

2.1 Reforma të implementuara me sukses në vitin përkatës

2.2 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integrimit evropian
2.3 Komponentët që kanë nevojë për adresimin me qëllim përmirësimin e implementimit
2.4 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit

**III.** Progresi i lidhur me qëllimet politikë, objektivat specifikë dhe masat

3.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit
3.2 Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit
3.3 Konkluzione dhe rekomandime

**IV. Risqet /risku dhe hapat për të adresuar**

4.1 Vlerësimi i riskut duke përdorur dhe treguesit
4.2 Hapat e radhës

**ANEKSE*:***

ANEKSI I: RAPORTIMI I AKTIVITETEVE DHE MASAVE

ANEKSI II: RAPORTIMI I INDIKATORËVE DHE OBJEKTIVAVE

## LISTA E SHKURTIMEVE

| | |
|---|---|
| AAPSK | Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara |
| ADB | Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje |
| AKSHI | Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit |
| AKU | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit |
| AMSHC | Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile |
| AMVV | Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore |
| APP | Agjencia e Prokurimit Publik |
| ASHSGJ | Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor |
| ATP | Agjencia e Trajtimit të Pronave |
| AZHBR | Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural |
| BKH | Byroja Kombëtare e Hetimit |
| DNJF | Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas |
| DPB | Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve |
| DPP | Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit |
| DPPSH | Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit |
| DPSHP | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës |
| DVP | Drejtoria Vendore e Policisë |
| GTA | Grupi Tematik për Antikorrupsionin |
| ILDKPKI | Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave |
| IML | Instituti i Mjeksisë Ligjore |
| KDIMDP | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale |
| KKK | Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit |
| KLP | Këshilli i Lartë i Prokurorisë |
| KQZ | Komisioni Qendror i Zgjedhjeve |
| KSHB | Komiteti Shqiptar i Birësimit |
| KSHZ | Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve |
| MASR | Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë |
| MB | Ministria e Brendshme |
| MBZHR | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MEPJ | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| MIE | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë |
| MK | Ministria e Kulturës |
| MM | Ministria e Mbrojtjes |
| MSHMS | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| MTM | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit |
| PP | Prokuroria e Përgjithshme |
| PV | Plani i Veprimit |
| QBZ | Qendra e Botimeve Zyrtare |
| SNKK | Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit |

draft

| | |
|---|---|
| SPAK | Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar |
| SHÇBA | Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat |
| SHKBB | Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |

draft

# I. INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI STRATEGJINË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2015-2023 DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2020-2023

Korrupsioni është një kërcënim për demokracinë, mirëqeverisjen, konkurrencën e ndershme, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe politik të një vendi.
Ai pengon rëndë zhvillimin ekonomik, duke krijuar një sistem pabarazie, paragjykimi e nepotizmi, duke shkatërruar besimin e njerëzve tek shteti i tyre, prandaj lufta kundër korrupsionit është sot një nga sfidat parësore të çdo shteti me kulturë demokratike, vizion dhe integritet të lartë.
Qeveria shqiptare ka dhe do vazhdojë në mënyrë të pandalur të ketë një vullnet të palëkundur në luftën kundër korrupsionit, përmes aksioneve parandaluese, masave ndëshkuese dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese.
Përparësia e qeverisë në fushën e luftës kundër korrupsionit, përkon më së miri me kushtëzimet e vendosura nga Bashkimi Evropian për hapjen e negociatave për anëtarësimin në BE. Lufta kundër korrupsionit është një ndër pesë politikat të cilat vendi ynë këshillohet t'i ndjekë me përparësi në procesin e integrimit evropian të vendit. Po kështu, parandalimi dhe ndëshkimi i korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentat ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit etj.

Prej vitit 2015 Shqipëria ndjek dhe zbaton Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit. Me Vendimin nr. 516, datë 01.7.2020 të Këshillit të Ministrave afati i zbatimit të SNKK u zgjat deri në vitin 2023.
Vizioni i SNKK-së 2015-2023 është: *"Institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm"*.

Qëllimet madhore të politikës së Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit janë parandalimi, ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi/edukimi rreth korrupsionit. Këto qëllime janë afatgjata dhe shtrihen përgjatë kohës së zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit.

Strategjia dhe Plani i Veprimit parashikojnë objektiva dhe masa specifike që duhen të realizohen për përmbushjen e këtyre objektivave, sipas afateve të detajuara në Planin e Veprimit kundër Korrupsionit. Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit duke qenë një strategji ndërsektoriale, është bazuar në parimin e koordinimit midis institucioneve me qëllim arritjen e objektivave që përfshihen në SKZHI, duke zbatuar një qasje sistematike dhe të integruar.

Gjatë tre vjeçarit të parë të SNKK, institucionet implementuan masa konkrete antikorrupsion të parashikuara në Planin e Veprimit 2015-2017. Në vijim, Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit rishikoi Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë, në mënyrë që të mundësonte përshtatjen e Strategjisë me realitetet e reja dhe prioritetet e sektorëve. Plani i Veprimit 2018 – 2020, ishte plani i dytë

i veprimit në zbatim të Strategjisë, i cili pasi kaloi nëpër një proces konsultimi gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë në luftën kundër korrupsionit, institucione të administratës shtetërore në nivel qëndror dhe lokal dhe institucione të pavarura, organizata dhe partnerë ndërkombëtarë, shoqërinë civile etj, çoi në një nivel më të lartë luftën kundër korrupsionit. Në hartimin e këtij dokumenti u morën parasysh dhe u reflektuan edhe ndryshimet e ndodhura si pasojë e reformave të ndërmarra si Reforma në Drejtësi dhe Reforma Administrative Territoriale.
Pasaporta e Treguesve u miratua në vitin 2018, me vendimin nr.241, datë 20.04.2018, të Këshillit të Ministrave, me anë të së cilës janë përcaktuar tregues të matshëm të realizimit të objektivave të kësaj strategjie. Në këtë vendim u miratua edhe krijimi i Komitetit Kordinator për zbatimin e SNKK-së dhe të Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion. Që prej ngritjes dhe organizimit të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë, në vitin 2021, më zbatim të VKM nr.618/2021, Task Forca Antikorrupsion pushoi së funksionuari dhe filloi nga veprimi Drejtoria e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion.

Komiteti Koordinator kryesohet nga Ministri i Drejtësisë dhe ka në përbërje 10 anëtarë, në nivel Zëvendësministri nga secila Ministri linje (pa përfshirë këtu 2 Ministritë pa portofol). Ajo kryesohet nga Ministri i Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar Antikorrupsion dhe ka në përbërje përfaqësues nga Kryeministria, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Inspektoriati Qendror.

Në datë 01.07.2020, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr.516, i cili miratoi zgjatjen e afatit të zbatimit të SNKK deri në vitin 2023, Planin e ri të Veprimit në zbatim të saj për periudhën 2020–2023 të shoqëruar nga një rishikim i vlerave të treguesve (aneksi 2: Pasaporta e Indikatorëve) për vitet e zbatimit të planit të veprimit (2020-2021-2022-2023).

Plani i Veprimit 2020-2023 përmban 83 masa për zbatimin e të cilave janë të përfshira 22 institucione, të cilat do të punojnë së bashku për më shumë transparencë, llogaridhënie dhe efiçencë në ritmin e luftës kundër korrupsionit në vend. Masa prioritare të këtij plani veprimi janë forcimi i transparencës së institucioneve publike, shtimi i shërbimeve publike online në mënyrë progresive, fillimi nga zbatimi i deklarimit të pasurive online të zyrtarëve publikë, ngritja dhe zbatimi i instrumenteve të luftës së korrupsionit në administratën publike (planet e integritetit), forcimi i bashkëpunimit të autoriteteve dhe agjencive ligjzbatuese në luftën kundër korrupsionit, rritja e forcës ndëshkuese të korrupsionit nga institucionet e posaçme të fushës, ndërveprim i shtuar i autoriteteve që marrin denoncimeve kundër korrupsionit dhe deri në ndërshkimin e tij, forcimi i ndërgjegjësimit publik dhe sensibilizim i shtuar i publikut. Këto masa vijnë në përputhje me agjendën e mirëqeverisjes dhe synojnë t'i japin një hov më cilësor zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit.

Ky raport monitorimi, pasqyron progresin dhe vlerësimin e zbatimit të Planit të Veprimit, për periudhën *janar-qershor 2023*, që korrespondon me vitin e katërt të zbatimit të planit të veprimit në fuqi. Raporti do të ofrojë një informacion mbi progresin e arritur në zbatimin e reformave të

fushës antikorrupsion kundrejt çdo qëllimi politik, objektivi specifik, bazuar në statusin e arritjeve të treguesve të performancës dhe të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të planifikuara në planin e veprimit për vitin 2023.

Për këtë periudhë monitorimi, *janar-qeshor 2023*, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna për 60 masa e 106 aktivitete, të shpërndara përkatësisht në 32 masa e 60 aktivitete për qasjen parandaluese (A), 20 masa e 29 aktivitete për qasjen ndëshkuese (B) dhe 8 masa e 17 aktivitete për qasjen ndërgjegjësuese (C).

Përmes zbatimit të Planit të Veprimit gjatë periudhës *janar - qershor 2023* janë realizuar plotësisht 31 masa, pjesërisht 12 masa dhe nuk janë realizuar 17 masa si dhe janë realizuar plotësisht 58 aktivitete, pjesërisht 8 aktivitete dhe nuk janë realizuar 40 aktivitete.




Në vijim, paraqitet realizueshmëria e objektivave të strategjisë sipas shkallës së realizimit të masave (tabela 1) dhe të treguesve të performancës (tabela 2).

| **Objektivat** | | **Shkalla e realizimit sipas masave** |
|---|---|---|
| **Par and ali** | A.1 Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion | 51 në 85 për qind e masave të zbatuara |

| | | |
|---|---|---|
| | A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike | 86 në 110 për qind e masave të zbatuara |
| | A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike | 86 në 110 për qind e masave të zbatuara |
| | A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit | 51 në 85 për qind e masave të zbatuara |
| | A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave | 86 në 110 për qind e masave të zbatuara |
| | A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike | Mungon raportimi |
| | A.7 Përmiresimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut | 51 në 85 për qind e masave të zbatuara |
| | A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion | 86 në 110 për qind e masave të zbatuara |
| | A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë | 86 në 110 për qind e masave të zbatuara |
| | A.10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit | 0 në 30 për qind e masave të zbatuara |
| | A.11 Adaptimi i politikave anti-korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore | 86 në 110 për qind e masave të zbatuara |
| **Ndëshkimi** | B.1 Përmirësimi i efiçencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit | Mungon raportimi |
| | B.2 Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndërshkimin penal të korrupsionit | Mungon raportimi |
| | B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar | 0 në 30 për qind e masave të zbatuara |
| | B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit | Mungon raportimi |
| **Ndërgjegjësimi** | C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit | 86 në 110 për qind e masave të zbatuara |
| | C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit | 51 në 85 për qind e masave të zbatuara |

| | C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile. | 0 në 30 për qind e masave të zbatuara |
|---|---|---|

Tabela 1: Realizueshmëria sipas masave dhe aktiviteteve

Për këtë periudhë *janar - qershor 2023*, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna për 37 tregues performance, të shpërdarë përkatësisht në 21 tregues për objektivat specifikë në qasjen parandaluese, 9 tregues për objektivat specifikë në qasjen ndëshkuese dhe 7 tregues për objektivat specifikë në qasjen ndërgjegjësuese. Gjatë periudhës janar - qershor 2023, janë arritur vlerat e synuara për 8 tregues performance, pjesërisht për 14 tregues performance dhe nuk janë arritur për 15 tregues performance.

Në mbështetje të parashikimit të bërë në Pasaportën e Indikatorëve, për periudhën *janar-qershor 2023*, janë të matshëm vetëm 9 prej treguesve (frekuenca e matjes gjashtëmujore), të shpërndarë përkatësisht në qasjen parandaluese (A.1.a; A.2.a; A.2.b; A.2.c; A.7.b; A.10; B.1.a; B.1.b dhe B.2.a). Për këtë periudhë raportimi, *janar-qershor 2023*, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna edhe për treguesit e tjerë, gjithashtu, për të cilët institucionet kanë raportuar dhe është bërë vlerësimi i tyre me qëllim vlerësimin e shkallës së përgjithshme të realizueshmërisë së objektivëve të SNKK dhe të Planit të Veprimit.

Në tabelën më poshtë janë të ilustruar të 37 treguesit sipas statusit të realizimit të tyre. Kjo llogaritje është bërë në bazë të vlerave të sjella/raportuara nga institucionet përkatëse, si edhe nga raportimi për masa dhe aktivitete mbi të cilat mbështetet realizueshmëria e treguesit, _edhe në ato raste ku ai ka bazë vjetore matjeje_. Në këtë raport monitorimi, mungojnë të dhënat për indikatorët e 7 objektivëve të SNKK, dhe mungesa e tyre është klasifikuar tek statusi: *vlera e synuar nuk është realizuar*. Këto objektivë i përkasin qasjes ndërgjegjësuese të SNKK.

| Qasja | Treguesit e performancës | **Realizimi i Treguesve të Performancës** | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Vlera e synuar është realizuar plotësisht[1] | Vlera e synuar është realizuar pjesërisht[2] | Vlera e synuar nuk është e realizuar[3] |
| Parandaluese | 21 | 7 | 9 | 5 |
| Ndëshkuese | 9 | 0 | 2 | 7 |
| Ndërgjegjësuese | 7 | 1 | 3 | 3 |
| **Total** | **37** | **8** | **14** | **15** |

[1] Që është realizuar në shkallën 100 për qind
[2] Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.
[3] Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mblidhen të dhëna

GRAFIK

Në vijim, paraqitet realizueshmëria e objektivave të strategjisë sipas shkallës së realizimit të treguesve të performancës:

| | Objektivat | Shkalla e realizimit sipas treguesve të performancës[4] |
|---|---|---|
| **Parandalimi** | A.1 Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion | 75 % |
| | A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike | 100% |
| | A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike | 100% |
| | A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit | 50% |
| | A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave | 100%[5] |
| | A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike | Mungon raportimi |
| | A.7 Përmiresimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut | 81.75%[6] |
| | A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion | 50% |
| | A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë | 40% |
| | A.10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe | 95% |

DRAFT

[4] Përllogaritur sipas formulës $NR = \frac{TP\ 1\ NR + TP\ 2\ NR}{2\ TP} \times 100\%$

[5] Vlera është pasojë e matjes vetëm të treguesit të performances A.5.a

[6] Për matjen e këtij objektivi janë marrë në vlerësim vetëm 3 tregues. Treguesit A.7.a, është në pamundësi matjeje këtë 6-mujor. Në këtë periudhë raportuese është matur vlera e raportuar për vitin 2022.

| | | |
|---|---|---|
| | përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit | |
| | A.11 Adaptimi i politikave anti-korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore | 18% |
| **Ndëshkimi** | B.1 Përmirësimi i efiçencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit | Mungon raportimi |
| | B.2 Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndërshkimin penal të korrupsionit | Mungon raportimi |
| | B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar | 0% |
| | B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit | 25% |
| **Ndërgjegjësimi** | C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjërë mbi pasojat e korrupsionit | 62.5% |
| | C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit | 40% |
| | C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile. | 0% |

Tabela 2: Realizueshmëria sipas treguesve të performancës

DRAFT

Përsa më sipër, nga analiza e kryer rezulton se, progresi i arritur për secilin prej qëllimeve të politikave, parandalim – ndëshkim – ndërgjegjësim, paraqitet:

| | |
|---|---|
| Qasja Parandaluese (A) | 61.34 % |
| Qasja Ndëshkuese (B) | 6.25 % |
| Qasja Ndërgjegjësuese (C) | 34.16 % |

Për këtë periudhë *janar – qershor 2023*, janë shënuar arritje të mira në qasjen parandaluese (A), ndëshkuese (B) dhe ndërgjegjësuese (C) të zbatimit të strategjisë, përmendim:

- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka monitoruar 200 nga 313 autoritete publike dhe 31 nga 61 njësi të Vetëqeverisjes Vendore për këtë periudhë raportuese. Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve është instaluar ne 27 autoritete publike duke e cuar numrin total të autoriteteve publike që kanë instaluar regjistrin elektronik në 222 autoritete.

- Agjencia e Prokurimit Publik ka arritur objektivat, duke mbajtur elementët e ndryshuar në regjistrin e parashikimeve nën masën 20% si dhe procedurat me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe ndryshimet e kontratave nën masën 10%. APP ka nxjerrë 3 rekomandime të cilat lidhen me formën e komunikimit në procedurat e prokurimit publik, njoftimin mbi modifikimin e kontratave Marrëveshjeve gjatë kohëzgjatjes së tyre dhe mbi zbatimin e prokurimit publik të gjelbër në Shqipëri.
- AKSHI ka lehtësuar përgjigjet përmes platformës e-albania, në të cilën aktualisht regjistrohen 2 827 371 përdorues. Në këtë mënyrë digjitalizimi i shërbimeve publike ka bërë të mundur reduktimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe burokracisë në marrjen e shërbimeve, njëkohësisht me rritjen e transparencës dhe efikasitetit. Ndërkohë, pranë kësaj platforme regjistrohen në total 1 227shërbime të aksesueshme për qytetarët.
- ILDKPKI ka vijuar të mirëmbajë sistemin e deklarimit të pasurive dhe interesave privatë. edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, sipas parashikimeve në këtë Planin e Veprimit në fuqi. Ajo gjithashtu ka përgatitur një raport vlerësimi për zbatueshmërinë e ligjit 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve". Në vijim të përpjekjeve për të forcuar qasjen parandaluese, ILDKPKI ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, me Komitetin Shqiptar të Helsinkit (KSHH), në kuadër të zbatimit të nismës "Shoqëria civile kundër korrupsionit - nga një sfidë lokale në një përgjigje europiane".
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë evidenton 4030 rekomandime të pranuara dhe zbatuara. Gjatë kësaj periudhe janë adresuar 2 raste të reja nga struktura të auditit të brendshëm, është kryer 1 referim në Prokurori si dhe janë iniciuar inspektime financiare për 90% të sinjalizimeve. MFE ka miratuar gjithashtu Programin e Trajnimit të Vijueshëm Profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik për vitin 2023, sipas të cilit, është planifikuar të trajnohen 350 auditues. Gjatë kësaj periudhe janë trajnuar gjithësej 125 auditues të brendshëm si dhe janë kryer 6 vlerësime të jashtme të cilësisë, përkatësisht në: INSTAT, FSDKSH, DPSHTRR, Bashkia Vau Dejes, Bashkia Fier dhe Bashkia Fushë Arrëz. Po ashtu janë trajnuar gjithësej 7 inspektorë financiarë publikë mbi menaxhim e riskut, si dhe 8 inspektorë mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.
- Ministria e Drejtësisë po integron të dhënat statistikore të prodhurara në lidhje me historikun e ndjekjeve dhe dënimeve penale, në një platformë të re elektronike për mbledhjen, raportimin dhe përpunimin e këtij informacioni, të krijuar nga shërbimet e Komisionit Evropian, në kuadrin e mbështetjes së kapaciteteve të vendeve kandidate/kandidate potenciale, për të mbledhur dhe raportuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të plotë, të dhënat statistikore.
- Drejtoria e Pëgjithshme Antikorrupsion ka vijuar gjithashtu me zhvillimin e politikave të integritetit dhe transparencës në organet publike. Gjatë kësaj periudhe raportuese është vlerësuar se një pjesë e konsiderueshme e institucioneve të varësive të ministrive të linjës, kanë miratuar dhe po ndjekin tashmë një Plan Integriteti.
- Organet qendore dhe ato të varësisë nuk raportojnë raste të zyrtarëve të tyre të gjetur në shkelje për praktika korruptive.

- Në nivelin vendor, Bashkia Roskovec ka miratuar një plan integriteti gjatë kësaj periudhe raportuese, duke e çuar numrin total në 22 bashki në vend, që kanë miratuar një Plan Integriteti. Nga ana tjetër janë inkurajuar përmes 5 takimeve konsultative edhe njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore. Ky proces pritet të finalizohet së shpejti edhe në Bashkinë Lushnje dhe Librazhd.
- Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje vijon të sigurojë një platformë të qëndrueshme dhe të besueshme të qytetarëve për të denoncuar praktikat e parregullta dhe ato abuzive. Kështu pranë kësaj platforme janë marrë gjithësej 202 ankesa, të cilat janë deleguar pranë Drejtorisë së Pëgjithshme të Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë. Ndërkohë ankesat e tjera administruara pranë Policisë së Shtetit kryesisht kanë që të lidhur me çështje të korrupsionit, konfliktit të pronësisë, sjelljes së punonjësve të strukturave e policisë, vendosje gjobe në mënyrë të padrejtë, etj. Ankesat janë trajtuar me përgjegjësi të plotë dhe rastet kur janë evidentuar shkelje serioze, janë referuar pranë organeve që ushtrojnë ndjekjen penale.
- Agjencia e Mbikqyrjes Policore ka patur një bashkëpunim të frytshëm me strukturat e Policisë së Shtetit, përmes hetimeve të përbashkëta, në kuadër të operacionit "Toyota Double", ku janë proceduar disa persona të dyshuar për veprat penale të shpërdorimit të detyrës, kontrabandës me mallrat e licensuara dhe ato për të cilat paguhet akcizë.
- AAPSK ka marrë në administrim pasuri të sekuestruar për veprën penale të korrupsionit në vlerën 32,034,000.00 lekë.
- Policia e Shtetit ka vijuar të ndërtojë kapacitete përmes strukturave të specializuara që merren me hetimin e krimit të korrupsionit. Gjithashtu gjatë veprimtarisë së saj 6 mujore, janë evidentuar gjithsej 443 vepra penale, me 510 autorë. Niveli i zbulueshmërisë për Policinë e Shtetit është në masën 84.19%. Për veprat penale të korrupsionit janë evidentuar gjithësej 194 vepra penale, nga të cilat jane zbuluar 167, ose 86.8%. Gjatë kësaj periudhe, ka vazhduar bashkëpunimi i shtuar dhe shkëmbimi i informacionit me partnerët ndërkombëtarë me një total prej 443 praktikash, nga te cilat 266 praktika me Interpolin, 79 praktika me Europolin dhe 88 praktika me Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare.
- Drejtoria e Pëgjithshme Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë, vijuar punën me rezultate solide në kryerjen e hetimeve administrative, gjatë kësaj periudhe raportuese. Konkretisht, gjatë periudhës janar - qershor 2023, janë administruar në total 202 ankesa, në përfundim të shqyrtimit të të cilave, janë dhënë 83 masa për fillimin e ecurisë disiplinore, 29 masa për largim nga detyra, 109 rekomandime si dhe janë referuar 9 raste në prokurori, me 28 persona të kallëzuar.
- Në kuadër të forcimit të qasjes ndërgjegjësuese, Ministria e Drejtësisë ka miratuar Planin e Komunikimit dhe Vizibilitetit për vitin 2023 si dhe ka zhvilluar fushatën e parë publike për vitin 2023.
- Në rrjetet e komunikimit të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion, Facebook, Twitter dhe LinkedIn, janë publikuar një seri me 15 video udhëzuese dhe

ndërgjegjësuese për të nxitur qytetarët duke denoncuar praktikat dhe abuzimet në institucionet publike, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve antikorrupsion. Këto video informuese, synojnë të promovojnë mekanizmin e raportimit të rasteve të dyshuara të korrupsionit, pranë rrjetit të koordinatorëve kundër korrupsionit. Gjithashtu gjatë gjysmës së parë të vitit 2023, Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion, ka mbajtur të informuar publikun mbi aktivitetin e saj përmes njoftimeve periodike në rrjetet sociale Facebook, Twitter dhe LinkedIn. dhe buletinit mujor të publikuar në linkun: https://drejtesia.gov.al/e-buletin/.

Gjatë kësaj periudhe zbatimi të planit të veprimit, janë identifikuar edhe problematika, duke ndikuar në realizueshmërinë e disa prej objektivave të strategjisë dhe në arritjet e qëllimit themelor dhe përfundimtar të politikave.

Sfida kryesore të zbatimit të planit të veprimit dhe treguesve të performancës, mund të përmenden:

- Mungesa e resurseve financiare për të mbështetur implementimin e planit të veprimit vijon të mbetet një sfidë, duke qenë se ka ndikim të drejtpërdrejtë tek realizimi i objektivave të vendosura, të cilat mund të rezultojnë të vështira ose të pamundura për tu realizuar.
- Nevoja për përkrahje dhe angazhim të institucioneve të tjera që nuk janë përfshirë në planin e veprimit. Është e rëndësishme që të gjitha institucionet relevante të bashkëpunojnë dhe të angazhohen në zbatimin e strategjisë për të arritur rezultatet e dëshiruara. Mungesa e bashkëpunimit dhe përkrahjes nga këto institucione mund të krijojë pengesa në përmbushjen e objektivave.
- Zbatimi i masave disiplinore dhe ligjore për rastet e korrupsionit dhe sjelljes së paligjshme të zyrtarëve në kohë dhe me efiçencë, vijon të mbetet një sfidë. Nëse nuk ka ndjekje të saktë dhe të shpejtë të rasteve të korrupsionit dhe abuzimeve të tjera, do të mungojë ndikimi i ndëshkimit dhe sanksioneve në parandalimin e veprave të tilla në të ardhmen.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe informimit të qytetarëve për mekanizmat e denoncimit të korrupsionit dhe praktikave të paligjshme, vijon të mbetet një çështje që ka nevojë për përmirësim. Nëse qytetarët nuk janë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe mjetet e disponueshme për të raportuar abuzet, është e vështirë që ata të mobilizohen për të ndihmuar në luftën kundër korrupsionit dhe për të promovuar integritetin në institucione.
- Rëndësia e trajnimeve dhe zhvillimit të kapaciteteve për zyrtarët dhe personelin e institucioneve relevante. Gjatë kësaj periudhe monitorimi nuk janë evidentuar investime të rëndësishme në trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve e kështu ata vijojnë të kenë vështirësi në zbatimin e politikave dhe strategjive të vendosura.
- Nevoja për monitorim dhe vlerësim të rregullt të zbatimit të planit të veprimit. Pa një sistem të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, është e vështirë të vlerësohet efektiviteti dhe progresi i planit dhe të merren masat korrigjuese nëse ka nevojë. Për këtë arsye synohet që kjo sfidë të adresohet në Strategjinë e re Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023 - 2030.

- Asnjë Bashki gjatë kësaj periudhe raportuese nuk ka alokuar buxhetin e përcaktuar për zbatimin e Planit të Integritetit.
- Do duhet të kryhet edhe vlerësimi i nevojave për përmirësimin e masave kundër korrupsionit.
- Nuk janë kryer auditimeve të brendshme pilot dhe vizita studimore mbi etikën dhe integritetin.
- Institucionet e varësisë të ministrive të linjës duhet të impenjohen kundrejt procesit të vlerësimit të riskut të integritetit në institucionet e varësitë, sipas Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit dhe të miratojnë Planet e Integritetit për institucionet e tyre.
- Të zhvillohet bashkëpunimi ndërkombëtar, sidomos në ato fusha apo sektorë që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në realizueshmërinë e treguesve të performancës.
- Raportimi i duhur mbi kostot administrative dhe buxhetin e përdorur për realizimin e aktiviteteve e masave konkrete, të cilat kanë afektuar gjithashtu në realizimin e vlerave të treguesve të performancës.

## *1.1 Metodologjia e monitorimit*

### 1.1.1 Koordinimi institucional për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.618, datë 20.10.2021 dhe Urdhrit të Kryeministrit Nr.128, datë 08.11.2021, është miratuar struktura dhe organika e Ministrisë së Drejtësisë dhe është ngritur Sektori i Planifikimit dhe Monitorimit Strategjik në Fushën Antikorrupsion, pranë Drejtorisë së Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues dhe për hartimin e raporteve periodike të monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2015 - 2023.

Ministria e Drejtësisë kryen koordinimin dhe organizimin e takimeve me të gjitha institucionet kontribuese, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Raporti i monitorimit të dokumentit strategjik (SNKK) për periudhën 1 janar deri më 30 qershor 2023 është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga institucionet përgjegjëse dhe kontributore të planit të veprimit.

### 1.1.2 Periodiciteti i hartimit të Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Ministria e Drejtësisë do të hartojë raporte tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët do të prodhojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në planin e veprimit të SNKK-së vitin 2023, që korrespondon edhe me vitin e fundit të zbatimit të kësaj strategjie.

### 1.1.3 Manuali i Raportimit sipas sistemit IPSIS

Ministria e Drejtësisë do të hartojë raportin e monitoritmit dhe të performancës për periudhën përkatëse sipas manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS. Sipas këtij dokumenti strategjik, secili institucion raporton mbi nivelin e zbatimit të çdo objektivi dhe mase, mbi buxhetin e caktuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në përgjithësi. Bashkërendimi për respektimin e manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS do të kryhet me Agjencinë SASPAC.

### 1.1.4 Përputhshmëria e raporteve të monitorimit dhe performancës me parimet e Mirëqeverisjes

Ministria e Drejtësisë do të hartojë raportin e monitorimit dhe të performancës për periudhën përkatëse në përputhje me parimet e mirëqeverisjes.

Parimet e Mirëqeverisjes përmbajnë një kornizë të vlerësimit të Raporteve të Monitorimit dhe të Performancës e cila mundëson analizën e rregullt të progresit të arritur në zbatimin e Parimeve dhe caktimin e standardeve që duhet të përmbush vendi.

Parimet janë të hartuara për vendet që duan të anëtarësohen në BE dhe që marrin ndihmë nga BE-ja përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA). Kushtet e *acquis*, si dhe direktivat dhe udhëzimet e tjera të BE-së, janë thelbi i Parimeve në fushat ku ekzistojnë acquis. Në fushat e tjera, parimet rrjedhin nga standardet dhe kërkesat ndërkombëtare, si dhe nga praktikat e mira në shtetet anëtare të BE-së dhe në vendet e OECD-së. Si standard minimal për një administratë të mirë të orientuar drejt performancës, vendet duhet të sigurojnë respektimin e këtyre parimeve themelore. Bashkërendimi për vlerësimin e raportit të monitorimit[7] dhe të performancës lidhur me përmbushjen e këtyre parimeve do të kryhet me Njësinë e Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri.

### 1.1.5 Mekanizimi i Integruar i Politikave

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.157, datë 22.10.2018 *"Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e Mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar",* janë krijuar 8 Grupe Tematike, të cilat janë pjesë e Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik. Konkretisht, për Ministrinë e Drejtësisë është ngritur Grupi Tematik Antikorrupsion (GTA).[8]

GMIP do të sigurojë një strukturë të menaxhimit të nivelit të lartë, lidhur me:

- vendimmarrjen politike dhe menaxheriale të nivelit të lartë në planifikimin dhe monitorimin e reformave sektoriale, politikave dhe kuadrit strategjik;
- koordinimin e planifikimit, programimit dhe monitorimit për sektorët e përfshirë, nëpërmjet organizimit të dialogut të rregullt me partnerët për zhvillim;

---

[7] Para se raporti i monitorimit dhe performancës të aprovohet në strukturat vendimmarrëse.
[8] Këtë rol e luan Komiteti Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit.

- ofrimin e mbështetjes në kuadrin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;
- dialogun qeveritar mbi politikat me partnerët për zhvillim, qeverisjen vendore, shoqërinë civile dhe sektorin privat, zbatimin e masave brenda fushës dhe sektorëve përkatës dhe promovimin dhe mbështetjen e iniciativave të koordinuara.

### 1.1.6 Fazat për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Fazat që do të ndiqen për përgatitjen dhe konsolidimin e raportimit dhe monitorimit të performancës, paraqiten si më poshtë:

**Faza 1:** dërgimi i kërkesës për kontribut në datë 3 korrik 2023 për të gjitha institucionet raportuese dhe konsolidimi i paketës në përputhje me standardet e sistemit IPSIS dhe Parimet e Mirëqeverisjes;
**Faza 2:** dërgimi i paketës së plotë për vlerësim në 20.07.2023 pranë Njësisë e Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri për vlerësim të raportit të performancës në përputhje me parimet e mirëqeverisjes.
**Faza 3:** konsolidimi i paketës pas marrjes dhe reflektimit të komenteve të sjella nga Njësia e Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri;
**Faza 4:** organizimi i mbledhjes së GTA-së më datë _.08.2023 për konsultimin e paketës së konsoliduar, marrjen e komenteve nga aktorët, si dhe miratimi i tij;
**Faza 5:** reflektimi i komenteve dhe finalizimi i paketës së raportit të monitorimit dhe performancës;
**Faza 6:** publikimi i raportit vjetor në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë;
**Faza 7:** dërgimi i procedurave (minutat e takimit, konkluzionet operacionale, raporti i konsultimit publik) të mbledhjes së GTA-së dhe paketa finale, së bashku me linkun për njohje Njësisë së Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri.
**Faza 8:** dërgimi i procedurave (minutat e takimit, konkluzionet operacionale, raporti i konsultimit publik) të mbledhjes së GTA-së dhe paketa finale, së bashku me linkun për njohje Agjencisë SASPAC.

### 1.1.7 Parimet e Mirëqeverisjes që do të merren në konsideratë për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Raporti i Monitorimit dhe Performancës do të zbatojë parimet e mirëqeverisjes që do të duhet të ndiqen në zbatimin e një sistemi të mirë dhe efektiv të M & R-së:

- EFIKASITETI: Agregimi i niveleve të dokumenteve. Ky parim duhet të lejojë shfrytëzimin e sinergjive mes raporteve të dokumenteve të ndryshme. Nëse dokumentet janë të lidhura ngushtë në aspektin e përmbajtjes, atëherë sistemi i M & R-së duhet ta marrë këtë parasysh për të mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të njëri-tjetrit dhe jo mbivendosjen e njëri-tjetrit. Elementet bazë të raporteve të M & R-së (p.sh. objektivat, aktivitetet, indikatorët) në

dokumentin e nivelit më të ulët do të zhvillohen drejt përmbajtjes së M & R-së në dokumentet e nivelit në të lartë. Duhet të merren parasysh lidhjet. Ky parim duhet të përmirësojë frekuencën dhe përmbajtjen e raporteve të M & R-së.

- LLOGARIDHËNIA: Respektimi i përmbajtjes së dokumenteve të planifikimit. Raportet e monitorimit duhet të përqendrohen në elementet e dokumenteve të planifikimit për të siguruar llogaridhënie lidhur me reformat dhe ndërhyrjet e planifikuara.
- RËNDËSIA: Respektimi i nevojave të përdoruesve të monitorimit dhe performancës. Raportet e M & R-së duhet të jenë të përshtatura për nevojat e përdoruesit në aspektin e përmbajtjes, gjatësisë dhe frekuencës. Për më tepër, raportet duhet të japin llogari për arritjen e rezultateve në mënyrë të verifikueshme dhe në raport me treguesit SMART.

Komponentët kryesorë që Raportet e Monitorimit dhe Performancës do të vlerësohen për përputhshmërinë me Parimet e Mirëqeverisjes lidhen me komponentët e mëposhtëm:

**Qasja analitike e strukturuar bazuar në evidenca dhe konsultim**

- Informacioni i dhënë shpjegon kuadrin metodologjik në përputhje me procedurat dhe standartet e sistemit.
- Progresi ndaj secilit qëllim politik dhe objektivi specifik të strategjisë bazuar në tregues si dhe zbatimin e reformave kryesore në sektor është paraqitur qartë.
- Shkalla në të cilën palët kryesore të interesit janë përfshirë në procesin e hartimit të raportit dhe raporti i monitorimit është konsultuar me të gjithë grupet si dhe publikuar në webin respektiv të institucionit (evidencë kryesore është raporti i konsultimit publik për procesin si dhe evidentimi që komentet janë marrë në konsideratë).
- Shkalla e paraqitjes analitike të zhvillimeve të sektorit globalisht ose në rajon.
- Shkalla e paraqitjes analitike të zbatimit të strategjisë me efekte në axhendën e integrimit evropian.
- Shkalla e paraqitjes analitike lidhur me identifikimin e fushës e cila adresohet për përmirësim si dhe efektet në ekzekutimin përgjithshëm të buxhetit.

**Progresi i arritur vs qëllimet e politikave, objektivat specifike dhe masat**

- Shkalla në të cilën progresi shpreh qartë vlerësimin e arritjeve kryesore duke përdorur treguesit e perfomancës. Është vlerësuar analiza përmes grafikëve, dashboards, analizës së thelluar dhe vizualisht përmes tabelave). Gjithashtu paraqitet qartë identifikimi i shkallës së performancës.
- Shkalla në të cilën progresi adreson vlerësimin e sfidave, boshllëqeve dhe jo efikasitetit (identifikohet qartë në raportin e monitorimit se cilat fusha (bazuar në qëllimet e politikave / objektivat specifike) tregojnë performancën më të dobët/jo rezultative, vs performancën më të lartë të objektivave, duke përdorur treguesit e rezultateve, përmes grafikëve, dashboards, analizës së thelluar dhe vizualisht përmes tabelave.

- Treguesit e Performancës janë pjesë e analizës për çdo qëllim politike dhe çdo objektiv specifik dhe jepen me premisa krahasueshmërie në vite apo për periudha të caktuara.
- Konkuluzionet dhe rekomandimet janë të bazuara në përputhje me evidencat e raportit dhe japin masa konkrete për korrektim/përmirësim për t'u adresuar në vendimmarrje.

**Performanca e kategorizuar sipas standarteve**

- Përcaktimi i nivelit të arritjes së objektivit të secilit tregues të performancës është identifikuar. Është kryer mbledhja e të dhënave të disponueshme. Eshtë llogaritur norma e realizimit të treguesit: 1) vlera e synuar, 2) vlera bazë dhe 3) të dhënat për arritjen e synimit.
- Niveli i arritjes së objektivit është përcaktuar. Gjithashtu është llogaritur norma mesatare e zbatimit të të gjithë treguesve të performancës lidhur me çdo objektiv të veçantë (është kryer hedhja e të dhënave të niveleve të realizimit të çdo treguesi të lidhur me performancën dhe pjesëtimin me numrin e treguesve të performancës).
- Niveli i përcaktimit të shkallës së realizimit të objektivit për një nga katër (4) intervalet e sistemit të performancës është kryer dhe analizuar. Gjithashtu Intervali është përcaktuar në bazë të nivelit të tolerancës. (i.dobët, ii. Mjaftueshëm, iii. Mirë, iv. Shumë mirë, v.Tejkaluar)

**Risqet**

- Shkalla në të cilën identifikohen risqet në nivel qëllimi politike dhe objektiv specifik në zbatim të Ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
- Shkalla në të cilën analizohen risqet në nivel qëllimi politike dhe objektiv specifik.
- Vlerësimi i riskut është kryer në përputhje me kategorizimet i.ulët; ii. mesëm dhe iii.lartë.
- Vlerësimi i mundësisë së ndodhjes së riskut është kryer në përputhje me kategorizimet i.ulët; ii. mesëm dhe iii.lartë.

**Analizat financiare**

- Shkalla e analizës së kryer lidhur me (i) në buxhetin e përdorur në periudhën e monitorimit, (ii) hendekun e financimit dhe (iii) nevojat e ardhshme.
- Analiza e buxhetit të përdorur është analizuar e lidhur me programet buxhetore (identifikohen saktë numri total i programeve buxhetore) në tre (3) nivele: (i) qëllimi i politikave (ii) objektivi specifik (iii) masat/ produktet si dhe totali për strategjinë.
- Shkalla e analizës financiare është kryer ku janë identifikuar dhe shkaqet e mungesës së fondeve dhe se si ky hendek do të trajtohet në të ardhmen.

**Plani i Veprimit**

- Plani është zbërthyer në realizueshmërinë e masave/produkte/aktivitete.
- Janë identifikuar institucionet zbatuese dhe kodet referuese për programet buxhetore.
- Janë identifikuar qartë periudha e realizueshmërisë.

- Institucionet e tjera/bashkëpunuese janë identifikuar.
- Masat/produktet janë të përputhura me produktet e programeve buxhetore (identifikohen qartë programet buxhetore).

### 1.1.8 Procedura për analizimin e të dhënave për raportin e monitorimit dhe performancës

Analiza e të dhënave është bërë në përputhje me parimet e mirëqeverisjes dhe strukturës vlerësuese për arritjen e performancës në Kryeministri.
Së pari është analizuar zbatimi i masave duke dhënë një rezultat sasior dhe cilësor të realizimit të tyre përkundrejt kryerjes së aktiviteteve respektive të lidhura me to.
Së dyti, është analizuar arritja e vlerës së synuar për këtë periudhë e përcaktuar në treguesit e performancës, duke vlerësuar gjithashtu edhe shkallën e ndikimit të masave të realizuara në arritjen e vlerës së synuar.
Së treti është analizuar realizimi i objektivëve specifike përmes përllogaritjes së realizimit të treguesve të performancës dhe përqindjes së masave të lidhura me objektivin përkatës të realizuara.

Zbatueshmëria e masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit klasifikohet me vlerat si më poshtë:

**E zbatuar:** është raportuar statusi "E zbatuar" për ato masa/aktivitete të cilat janë përmbushur.
**Pjesërisht e zbatuar/Në proces:** është raportuar statusi "Në proces" për ato masa/aktivitete, të cilat në periudhën e raportimit kanë pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijojnë të jenë në zbatueshmëri prej tyre.
**E pazbatuar:** Të pazbatuara janë raportuar ato masa/aktivitete të cilat nuk kanë regjistruar zhvillim për periudhën raportuese si dhe gjithashtu ato masa/aktivitete për të cilat nuk ka pasur progres.

Për përllogaritjen e realizimit të objektivëve specifike sipas arritjes së vlerës vjetore të treguesit të perfomancës është përdorur formula si më poshtë [9]:

$$\text{NR} = \frac{\text{TP 1 NR} + \text{TP 2 NR}}{\text{2 TP}} \text{ x } 100\%$$

Përllogaritja e realizimit të objektivit përkundrejt zbatimit të masave është kryer në bazë të 4 intervaleve të sistemit të performancës si në tabelën dhe kodin e ngjyrave më poshtë:[10]

| Kategoria | Niveli i Tolerancës | Pikët (110) |
|---|---|---|
| Dobët | Nga 0 deri në 30 për qind e masave të realizuara | 30 |

[9] Formula e përllogaritjes është marrë nga guida metodologjike e hartimit të raporteve të monitorimit të dokumenteve strategjike IPSIS.
[10] Vlerësim është realizuar në përputhje me Guidën Metodologjike "Struktura e raporteve të monitorimit për dokumentet strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale për agjendën e mirëqeverisjes".

| | | |
|---|---|---|
| Mjaftueshëm | Nga 31 në 50 për qind e masave të realizuara | 20 |
| Mirë | Nga 51 në 85 për qind e masave të realizuara | 35 |
| Shumë mirë | Nga 86 në 110 për qind e masave të realizuara | 25 |
| Tejkaluar | 111 dhe më lart | N/A |

Niveli tjetër i analizës është realizuar sipas qëllimeve të politikës. Bazuar në të dhënat e realizueshmërisë për secilin nivel analitik (masa, tregues performance, objektiv specifik) është vlerësuar secili nga katër qëllimet e politikave: 1. Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, efiçencën dhe llogaridhënien; 2. Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane; 3. Një Sistem i Drejtësisë Penale i mbështetetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit; 4. Koordinimi, manaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucione e sektorit.

### *Matrica e Riskut*

Në raportin e monitorimit vlerësohet identifikim i risqeve me qëllim identifikimin e hapave që do të duhen të ndiqen për t'u adresuar në kuadër të implementimit të objektivëve të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit.

Vlerësimi i riskut është kryer në përputhje me tabelën më poshtë[11]:

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Mundësia | E lartë | 3 | 6 | 9 | |
| | E mesme | 2 | 5 | 8 | |
| | E ulët | 1 | 4 | 7 | |

DRAFT

[11] Analiza dhe vlerësimi i riskut është kryer referuar Guidës Metodologjike për hartimin e raporteve të monitorimit për Agjendën e Mirëqeverisjes.

| | | | |
|---|---|---|---|
| E ulët | E mesme | E lartë | |
| Ndikimi | | | |

### 1.1.9 Konsultimi publik i raportit të monitorimit dhe performancës

Në përputhje me kriteret ligjore për konsultimin publik, pas hartimit të draft raportit, Ministria e Drejtësisë e dërgoi në datën 20.07.2023 dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe me datë 04.08.2023 publikoi draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve, në faqen e internetit www.drejtesia.gov.al, në menu prioritete/strategjia ndërsektoriale/strategjia ndërsektoriale kundër korrupsionit. Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kreu reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft raportin e monitorimit dhe vijoi me zhvillimin e një takimi të dedikuar datë _.08.2023, në kuadër të diskutimit të analizës së kryer, gjetjeve të raportit, vlerësimit të qëllimeve të politikës në prezencë të të gjithë institucioneve zbatuese dhe raportuese të planit të veprimit.
Raporti i konsultimit publik të raportit të monitorimit publikohet gjithashtu në faqen e internetit të ministrisë, www.drejtesia.gov.al.

## II. PROGRESI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT

Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023 ka si synim arritjen e objektivave madhorë të kësaj strategjie nëpërmjet realizimit të masave konkrete antikorrupsion, me qëllim zhvillimin e një shoqërie në të cilën ekziston një sistem i përgjegjshëm dhe efikas kundër korrupsionit, i cili është në gjendje për të përfituar rezultate të prekshme dhe të tregojë tendencë drejt eliminimit maksimal të kërcënimeve të korrupsionit, si dhe vullnetit për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin. Për të monitoruar ecurinë e SNKK 2015-2023, është hartuar raporti periodik i rradhës, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit 2020 - 2023, i cili mbulon periudhën *1 janar 2023 deri më 30 qershor 2023*.

### 2.1 Reforma të implementuara me sukses në vitin përkatës

Zbatimi i SNKK kontribuon në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) i cili është dokumenti kryesor strategjik kombëtar që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit, duke siguruar përmbushjen e standardeve dhe progresin në procesin e integrimit evropian.

SNKK ka identifikuar tre qëllime kryesore politikash (Qasje) përmes të cilave synon të përmbushë vizionin e saj dhe 18 objektiva specifikë, si më poshtë:

***Qasja Parandaluese*** ka për qëllim forcimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në administratën publike dhe të gjithë segmenteve shtetërore. Fokus i veçantë i dedikohet institucioneve që ofrojnë shërbime publike për qytetarët.

Kjo qasje ka dhe numrin më të madh të objektivave dhe për pasojë dhe masave/aktiviteteve që institucionet përgjegjëse planifikojnë të zbatojnë për arritje e objektivave:

*A.1 Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion*
*A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike*
*A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike*
*A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit*
*A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave*
*A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike*
*A.7 Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut*
*A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion*
*A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë*
*A.10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit*
*A.11 Adaptimi i politikave antikorrupsion në nivelin e qeverisjes vendore*

***Qasja Ndëshkuese*** ka për qëllim të forcojë zbatimin e ligjit dhe sundimin e shtetit të së drejtës, të ndëshkojë aktet korruptive në të cilat zyrtarët publikë mund të përfshihen dhe të garantojë integritetin e organeve shtetërore. Kjo qasje përbëhet nga objektivat e mëposhtme:

*B.1 Përmirësimi i efiçencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit*
*B.2 Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit*
*B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar*
*B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit*

***Qasja Ndërgjegjësuese*** ka për qëllim përfshirjen e publikut në luftën kundër korrupsionit, duke e informuar mbi veprimtarinë shtetërorë kundër korrupsionit dhe nxitur atë për të përdorur në mënyra aktive kanalet për ta denoncuar atë. Kjo qasje përbëhet nga objektivat e mëposhtme:

*C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit*
*C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit*
*C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile*

DRAFT

***Realizueshmëria e objektivave specifikë të të tre qëllimeve të politikave (3 qasjeve) të SNKK, në nivel objektivi***

Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave - duke mbledhur realizueshmërinë në përqindje të qëllimeve të politikës dhe pjestuar me numrin e tyre - realizueshmëria e qëllimit strategjik ndërinstitucional kundër korrupsionit, për këtë periudhë monitorimi paraqitet si më poshtë: 33.91%.

DRAFT

| Qasja A | Realizueshmëria |
|---|---|
| A.1 | 75% |
| A.2. | 100% |
| A.3 | 100% |
| A.4 | 50% |
| A.5 | 100%[12] |
| A.6 | - |
| A.7 | 81.75% |
| A.8 | 50% |
| A.9 | 40% |
| A.10 | 95% |
| A.11 | 18% |

| Qasja B | Realizueshmëria |
|---|---|
| B.1 | - |
| B.2 | - |
| B.3 | 0% |
| B.4 | 25% |

| Qasja C | Realizueshmëria |
|---|---|
| C.1 | 62.5% |
| C.2 | 40% |
| C.3 | 0% |

Tabela 3: Realizueshmëria sipas objektivëve

Statusi aktual i këtij raporti, nuk mund të masë plotësisht nivelin e realizimit për disa objektivë, për arsye të mungesës së informacionit për treguesit e performancës së tyre. Shiko tabelën 3.

Numri i institucioneve të përfshira në procesin e zbatimit të Planit të Veprimit 2020 - 2023 është 22 (10 Ministri, 12 institucione të nivelit qëndror).

Zbatimi i SNKK realizohet përmes Planit të Veprimit 2020 - 2023, i cili përmban **83 masa** dhe **152 aktivitete,** të ndara përkatësisht në: 45 masa dhe 81 aktivitete për qasjen parandaluese, 29 masa dhe 44 aktivitete për qasjen ndëshkuese, dhe 9 masa dhe 27 aktivitete për qasjen ndërgjegjësuese.

[12] Kjo matje është bërë duke marrë në konsideratë vetëm objektivin A.5.a.

| Qasja (Qëllimet e Politikës) | Masat dhe Aktivitetet | Parashikimi për Realizimin e Masave | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2020 | Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2021 | Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2022 | Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2023 |
| Parandaluese | Masa | 34 | 33 | 31 | 38 |
| | Aktivitete | 63 | 66 | 64 | 65 |
| Ndëshkuese | Masa | 25 | 22 | 21 | 23 |
| | Aktivitete | 37 | 31 | 31 | 32 |
| Ndërgjegjësuese | Masa | 9 | 9 | 9 | 12 |
| | Aktivitete | 24 | 22 | 18 | 23 |
| **Total** | **Masa** | **68** | **64** | **61** | **73** |
| | **Aktivitete** | **124** | **119** | **113** | **120** |

Rezulton se parashikimi i masave dhe aktiviteteve përgjatë viteve të zbatimit të planit të veprimit është pothuaj në raporte të njëjta për të tre qasjet. Ka një balancim të planifikimit për zbatim, të masave dhe aktiviteteve duke siguruar të njëjtën masë ndërveprimi dhe iniciativash institucionale dhe ndërinstitucionale.

Gjatë periudhës raportuese *1 janar - 30 qershor 2023*, janë monitoruar në total 60 masa e 106 aktivitete, nga të cilat rezulton se janë zbatuar në total 31 nga masat dhe kryer 58 nga aktivitetet.

| Qasja (Qëllimet e Politikës) | Masat dhe Aktivitetet | Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Masa dhe aktivitete të parashikuara për periudhën janar - qershor 2023 | Masa dhe aktivitete **plotësisht** të realizuara | Masa dhe aktiviteteve **pjesërisht** të realizuara[13] | Masa dhe aktivitete të **parealizuara**[14] |
| Parandaluese | Masa | 32 | 18 | 8 | 6 |
| | Aktivitete | 60 | 38 | 5 | 17 |

[13] Aktivitet "pjesërisht i realizuar" është ai aktivitet që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.
[14] Aktivitet "i parealizuar" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind.

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Ndëshkuese | Masa | 20 | 7 | 3 | 10 |
| | Aktivitete | 29 | 10 | 2 | 17 |
| Ndërgjegjësuese | Masa | 8 | 6 | 1 | 1 |
| | Aktivitete | 17 | 10 | 1 | 6 |
| **Total** | **Masa** | **60** | **31** | **12** | **17** |
| | **Aktivitete** | **106** | **58** | **8** | **40** |

Rezulton se nga totali prej 60 masash e 106 aktivitetesh të parashikuara në planin e veprimit për periudhën *janar - qershor 2023*, statusi aktual i tyre për të tre qëllimet e politikave (qasjet e Strategjisë), është raportuar si më poshtë:

- 31 masa e 58 aktivitete të realizuara;
- 12 masa e 8 aktivitete ende në proces zbatimi;
- 17 masa e 40 aktivitete të pazbatuara.

Përsa më sipër, nga **31 masa e 58 aktivitete të realizuara** për janar-qershor 2023, konkretisht 18 masa/38 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 7 masa/10 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 6 masa/10 aktivitete i përkasin qasjes ndërgjegjësuese (C).

Nga **12 masa e 8 aktivitete të cilat janë ende në proces zbatimi** për janar-qershor 2023, konkretisht 8 masa/5 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 3 masa/2 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 1 masë/1 aktivitet i përkasin qasjes ndërgjegjësuese (C).

Nga 1**7 masa e 40 aktivitete të parealizuara për janar-qershor 2023**, konkretisht 6 masa/17 aktivitete i përkasin qasjes parandaluese (A), 10 masa/17 aktivitete i përkasin qasjes ndëshkuese (B), si dhe 1 masë/6 aktivitete i përkasin qasjes ndërgjegjësuese (C).

## 2.2 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integrimit evropian

Ky raport monitorimi mat ndër të tjera, vlerën dhe ecurinë e disa treguesve të perfomancës që lidhen me çështje prioritare në agjendën e shtetit shqiptar, në procesin e integrimit europian.

Implementimi i Planit të Veprimit, 6-mujori 1, 2023 ka një impakt të rëndësishëm në agjendën e integrimit evropian të Shqipërisë. Ky strategji është një instrument kyç për të luftuar korrupsionin dhe për të siguruar qasje të barabartë për të gjithë qytetarët dhe për të rritur nivelin e transparencës dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë dhe administratës publike. Disa impakte të rëndësishme të implementimit të strategjisë janë:

Qasja parandaluese: Implementimi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit ka ndihmuar në zhvillimin dhe përmirësimin e mekanizmave të parandalimit të korrupsionit. Përmes platformës

së denoncimeve, qytetarët kanë pasur mundësi të raportojnë praktikat e parregullta dhe abuzive. Kjo platformë siguron një mjet të qëndrueshëm dhe të besueshëm për të luftuar korrupsionin. Më tej, zhvillimi i politikave të integritetit dhe transparencës në organet publike tregojnë angazhimin e vazhdueshëm të qeverisë për të ndërtuar një sistem të qëndrueshëm parandalues kundër korrupsionit.

Qasja ndëshkuese: Implementimi i strategjisë ka rritur përgjegjësinë dhe llogaridhënien për shkeljet e korrupsionit. Përmes hetimeve të përbashkëta dhe bashkëpunimit të thelluar me organet e drejtësisë, janë administruar masa ndëshkuese për personat e dyshuar për vepra penale të korrupsionit. Në veçanti, përmendja e operacionit "Toyota Double" dhe procedimit të personave të dyshuar tregon angazhimin e policisë dhe institucioneve të tjera në luftën kundër korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës.

Qasja ndërgjegjësuese: Implementimi i strategjisë ka përmirësuar ndërgjegjësimin dhe informimin e publikut në lidhje me korrupsionin dhe praktikat antikorrupsion. Përmes fushatave publike, trajnimeve dhe publikimeve në rrjetet sociale, qytetarët janë nxitur të denoncojnë raste të dyshuara të korrupsionit dhe të marrin pjesë aktivisht në luftën kundër korrupsionit. Kjo ndihmon në kultivimin e një mjedisi ku njerëzit ndiejnë se kanë rolin e tyre në luftën kundër korrupsionit dhe janë të informuar për të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Implementimi i kësaj strategjie ndihmon Shqipërinë në procesin e integrimit në disa drejtime:

Rritja e transparencës: Lufta kundër korrupsionit dhe përmirësimi i integritetit në administratën publike përmirësojnë transparencën në sistemin e drejtësisë dhe institucionet publike. Kjo është një kërkesë kyçe në agjendën e integrimit evropian, ku një prej vlerave themelore është transparenca në proceset vendimmarrëse dhe qeverisëse.

Stabiliteti i sistemit juridik: Përmirësimi i luftës kundër korrupsionit rrit besimin në sistemin e drejtësisë dhe në sundimin e ligjit. Ky është një faktor kyç për integrimin evropian, pasi një sistem i drejtësisë funksional dhe i besueshëm është thelbësor për të garantuar të drejtat dhe liritë e qytetarëve dhe për të mbrojtur interesat e tyre.

Harmonizimi me standardet evropiane: Implementimi i strategjisë kundër korrupsionit ndihmon Shqipërinë të përputhet me standardet evropiane në fushën e integritetit, transparencës dhe llogaridhënies. Kjo përmirëson përputhshmërinë e legjislacionit dhe praktikave vendore me direktivat dhe konventat evropiane, që janë thelbësore në procesin e integrimit evropian.

Implementimi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit për këtë periudhë raportuese, paraqet hapa të rëndësishëm drejt luftës së korrupsionit dhe integrimin evropian të Shqipërisë. Përmirësimi i qasjes parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuese ndihmon në forcimin e institucioneve, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, dhe harmonizimin me standardet evropiane. Këto përparime pozitive e afrojnë Shqipërinë më shumë me kriteret dhe vlerat evropiane, duke e zhvilluar në rrugën e integrimit në Bashkimin Evropian.



DRAFT

## 2.3 Komponentët që kanë nevojë për adresimin me qëllim përmirësimin e implementimit

Rezulton se ndër objektivat me mungesë të plotë realizueshmërie apo me realizueshmëri të dobët, për periudhën raportuese *1 janar - 30 qershor 2023,* janë përkatësisht disa prej objektivëve në të tre qasjet e SNKK, përmendim përkatësisht, objektivët A.9, A.11, B.3, B.4, C.2 dhe C.3.

Objektivi A.4: Niveli i zbulueshmërisë për veprat penale të korrupsionit ka nevojë për t'u adresuar. Kjo njësi matëse për Policinë e Shtetit ka pasuar një ulje të lehtë këtë periudhë 6 mujore, krahasimisht me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo tregon se ka nevojë për përmirësim të veprimeve hetimore dhe përforcim të kapaciteteve për hetimin e krimit të korrupsionit.

Objektivi A.7: Vlerësimi i jashtëm i cilësisë: Përkundër trajnimeve të zhvilluara për audituesit e brendshëm, ka pasur një numër të kufizuar vlerësimesh për cilësinë. Për këtë shkak nevojitet një rritje e numrit të tyre dhe shtrirje e vlerësimeve të jashtme të cilësisë për të siguruar monitorim më të gjerë dhe përmirësim të performancës së auditimit në sektorin publik.

Objektivi A11: Implementimi i planit të integritetit në nivelin vendor: Edhe pse disa bashki kanë miratuar plane të integritetit, numri i tyre është ende i ulët në krahasim me numrin total të bashkive. Nevojiten domosdoshmërisht përpjekje për të inkurajuar dhe përmirësuar implementimin e planeve të integritetit në nivelin vendor.

Objektivi B.1: Përkundër platformës së qëndrueshme të denoncimit të parregulltive, numri i ankesave të raportuara është relativisht i ulët, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kjo tregon se është e rëndësishme që qytetarët të kenë besim të shtuar në mekanizmat ekzistues të denoncimit dhe se të bëhen përpjekje të koordinuara për të rritur ndërgjegjësimin dhe besueshmërinë në këto mekanizma.

Objektivi C1: Ndërgjegjësimi publik dhe përdorimi i rrjeteve sociale: Përkundër publikimit të informacionit në rrjetet sociale dhe fushatave publike, ka ende hapësira për të rritur ndërgjegjësimin publik dhe përdorimin e mekanizmave ekzistues të raportimit të rasteve të dyshuara të korrupsionit.

Objektivi C2: Mungesa e veprimeve disiplinore të ndjekura pas shqyrtimit të ankesave. Në disa raste, pas shqyrtimit të ankesave, nuk janë evidentuar veprime disiplinore të mjaftueshme për shkeljet e konstatuara. Kjo mund të tregojë për nevojën për të përmirësuar proceset e monitorimit dhe ndjekjes së veprave disiplinore dhe të sigurojë që ato të jenë efektive.

Përmirësimi i çështjeve të mësipërme do të ndihmonte në përmirësimin e efektivitetit dhe zbatimit të masave dhe aktiviteteve si dhe tregusve të performancës në fund të vitit 2023.

## 2.4 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit

Financimi i Planit të Veprimit realizohet nga dy burime kryesore: buxheti i shtetit dhe mbështetja financiare e partnerëve ndërkombëtarë (donatorë).

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të masave/aktiviteteve të Planit të Veprimit 2020 - 2023, institucioneve përgjegjëse u është kërkuar të raportojnë mbi buxhetin e planifikuar për vitin raportues dhe buxhetin e përdorur në bazë të aktivitetit të kryer për realizimin e objektivit specifik të strategjisë nga secili institucion përgjegjës.

Buxheti i përdorur sipas objektivave dhe burimi konkret i financimit është si vijon:

A.1: 3.081 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A.2: 16.606 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A.3: 0 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A.4: 60.640 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A.5: 19.661 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A.6: _ lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A.7: 10.126 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A.8: 10.911 lekë, mbuluar nga buxhetit i shtetit.

A.9: 2.650 lekë, mbuluar nga buxhetit i shtetit.

A.10: 2.848 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

A.11: 38.790 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

B.1: 153.985 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër nga donatorë: Rai (*Regional Anti Corruption Initiative*) dhe The Aire Center, OSCE.

B.2: 50 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

B.3: 37.5 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

B.4: 20,995 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

C.1: 8320 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

C.2: 0 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

C.3: 0 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

Objektivat A6, B1, B2 dhe C3 nuk kanë raportuar kosto të përdorur (0).

Edhe për këtë raport monitorimi, rezulton se për një pjesë të aktiviteteve të kryera gjatë këtij viti, zbatimi, kostot vijojnë të raportohen në “kosto administrative”, dhe mungon një vlerë konkrete e tyre.

Buxheti i përdorur sipas qëllimeve të politikës/Qasjeve A-B-C, është:

***Qëllimi i politikës 1 (qasja parandaluese- A)***

165.313 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit

***Qëllimi i politikës 2 (qasja ndëshkuese - B)***

175,067.5 lekë mbuluar nga buxhetit i shtetit.

***Qëllimi i politikës 3 (qasja ndërgjegjësuese - C)***

8320 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit

Totali i buxhetit të përdorur për këtë periudhë është: *348.700.500 lekë.*

## III. PROGRESI I LIDHUR ME QËLLIMET POLITIKE, OBJEKTIVAT SPECIFIKE DHE MASAT

Ky kapitull përshkruan progresin e arritur në kuadër të përmbushjes së tre qasjeve të SNNK, në drejtim të secilit qëllim politik,[15] objektivi dhe masave/aktiviteteve të Planit të Veprimit 2020 - 2023, për periudhën e monitorimit *1 janar - 30 qershor 2023*.
Qëllimet e politikave dhe objektivat specifikë bëhen të realizueshëm nëpërmjet masave dhe aktiviteteve në funksion të zbatimit të masave, të parashikuara për zbatim nga institucionet përgjegjëse edhe bashkëpunëtore të Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

### 3.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit

Në përputhje me SNKK, janë kryer aktivitete dhe realizuar dhe masa të parashikuara në Planin e Veprimit 2020 - 2023 për periudhën raportuese të lidhura me të 3 qëllimet e politikës, përkatësisht parandalimin, ndëshkimin dhe ndërgjegjësimin.

***Qasja Parandaluese - Përmbledhje për arritjet në parandalimin e korrupsionit***

Përmes **qëllimit të politikës (qasjes) parandaluese SNKK** synohet çrrënjosja e korrupsionit në administratën publike dhe në të gjitha segmentet shtetërore, si dhe nga institucionet që ofrojnë shërbime publike për qytetarët. Kjo qasje përmban numrin më të madh të objektivave specifike dhe për rrjedhojë dhe të masave dhe aktiviteteve të planifikuara për t'u zbatuar nga institucionet e përfshira.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë.

| Qasja (Qëllimet e Politikës) | Masat dhe Aktivitetet | Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Masa dhe aktivitete të parashikuara për periudhën janar - qershor 2023 | Masa dhe aktivitete **plotësisht** të realizuara | Masa dhe aktiviteteve **pjesërisht** të realizuara[16] | Masa dhe aktivitete të **parealizuara**[17] |

[15]Plani i Veprimit dhe progresi për secilin objektiv është përfshirë në aneksin e këtij raporti.
[16] Aktivitet "pjesërisht i realizuar" është ai aktivitet që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.
[17] Aktivitet "i parealizuar" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind

| Parandaluese (A) | Masa | 32 | 18 | 8 | 6 |
|---|---|---|---|---|---|
| | Aktivitete | 60 | 38 | 5 | 17 |

Rezulton se nga 32 masa e 60 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2020 – 2023, për janar-qershor 2023, për Qasjen A (Parandaluese), janë zbatuar 18 masa/38 aktivitete prej tyre, 8 masa/5 aktivitete janë ende në proces zbatimi, 6 masa/17 aktivitete janë të pazbatuara përkatësisht (masa A.6.1; A.6.2; A.6.3; A.6.4; A.6.5 dhe A.10.2 dhe aktivitete A.4.2.1; A.4.4.3; A.6.1.1; A.6.1.2; A.6.2.1; A.6.2.2; A.6.3.1; A.6.3.2; A.6.4.1; A.6.4.2; A.6.5.1; A.6.5.2; A.6.5.3; A.7.1.4; A.7.3.2; A.7.3.4 dhe A.10.2.1).

GRAFIK

Nga 21 treguesit e performances për qasjen parandaluese (A), është arritur vlera e synuar për 7 tregues performance, është arritur pjesërisht vlera e synuar për 9 tregues performance si edhe nuk është arritur vlera e synuar për 5 tregues performance.

| **Qasja Parandaluese** | Treguesit e performancës | Realizimi i Treguesve të Performancës | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Vlera e synuar është realizuar plotësisht[18] | Vlera e synuar është realizuar pjesërisht[19] | Vlera e synuar nuk është e realizuar[20] |
| | 21 | 7 | 9 | 5 |

GRAFIK

### ***A.1 Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion***

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

*A.1.a: Numri i institucioneve të cilat kanë implementuar saktë programe transparence*

*A.1 b: Bërja operacional regjistrit qendror për ankesat dhe përgjigjet që në vitin 2020*

Plani i Veprimit për Objektivin A.1 parashikon 6 Aktivitete dhe 3 Produkte/Masa

[18] Që është realizuar në shkallën 100 për qind
[19] Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.
[20] Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mblidhen të dhëna



DRAFT

**A.1.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.1.a** për vitin 2023 është *5% rritje në krahasim me vitin 2022* .

Gjatë vitit 2022, nga 374 autoritete publike të monitoruara online, 331 kanë zbatuar programin e transparencës dhe e kanë publikuar atë.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (4) dhe masat (2) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| A.1.1 | Krijimi i sistemit të matjes së transparencës dhe llogaridhënies, përfshirë metodologjinë e studimit dhe një grup treguesish të transparencës me qëllim matjen dhe raportimin në mënyrë periodike të nivelit të transparencës tek autoritetet publike qendrore dhe të varësisë. |
| A.1.1.1 | Raport vjetor mbi indeksin e Transparencës së Autoriteteve Publik (*Hartimi dhe publikimi i 1 raporti vjetor).* |
| A.1.1.2 | Monitorim të transparencës në sasinë e 1/4 të numrit total te autoriteteve publike çdo 3 mujor. |
| A.1.2 | Krijimi i sistemit të matjes së transparencës dhe llogaridhënies, përfshirë metodologjinë e studimit dhe një grup treguesish të transparencës me qëllim matjen dhe raportimin në mënyrë periodike të nivelit të transparencës tek njësitë e vetqeverisjes vendore. |
| A.1.2.1 | Raport vjetor mbi indeksin e Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (*Hartimi dhe publikimi i 1 raporti vjetor).* |
| A.1.2.2 | Monitorim të transparencës në sasinë e 1/4 të numrit total te autoriteteve publike çdo 3 mujor |

Realizimi i masave të parashikuara kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të numrit të autoriteteve publike të monitoruara çdo 3 mujor dhe me vlera të matshme përkundrejt prodhimit të raportit mbi indeksin e transparences të autoriteteve publike qendrore dhe raportit mbi indeksin e transparencës së autoriteteve publike të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Për *janar-qershor 2023,* Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim Komisioneri) ka realizuar monitorimin e programeve të transparencës mbi 1/2 të Autoriteteve Qendrore dhe të Varësisë. Në total janë monitoruar 200 nga 313 autoritete publike.

Ky monitorim është realizuar në sasinë ½ të numrit total edhe pranë autoriteteve publike / njësitë e vetëqeverisjess vendore. Në total janë monitoruar 31 nga 61 Njësi të Vetëqeverisjes Vendore. Të gjitha autoritetet publike të monitoruara kanë të publikuar Programin e Transparencës.

Raporti vjetor mbi indeksin e Transparencës së këtyre autoriteteve publike është parashikuar për zbatim në 3M4 2023.

Në përfundim vlerësohet se gjatë vitit 2022, 331 autoritete publike kanë të publikuar në faqet e tyre zyrtare Programin e Transparencës. 5% rritje në krahasim me vitin 2022 që është objektivi për vitin 2023, përllogaritet në 17 autoritete publike të shtuara, pra **348** - objektivi për vitin 2023. Duke qenë se aktualisht janë 231 autoritete publike kanë të publikuar në faqet e tyre zyrtare Programin e Transparencës, llogaritet se ky tregues performance është realizuar në masën **66%.**

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve (shtojca 2 e Planit të Veprimit), paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | 2015 | |
| | N/A | |
| | 2017 | 181 |
| | 2018 | 20% rritje nga vlera bazë |
| | 2019 | 15% rritje në krahasim me vitin 2018 |
| | 2020 | 12% rritje në krahasim me vitin 2019 (treguesi është arritur në masën 57%) |
| | 2021 | 9% rritje në krahasim me vitin 2020 |
| | 2022 (targeti i synuar) | 7% rritje në krahasim me vitin 2021 |
| | **2023 (targeti i synuar)** | 5% rritje në krahasim me vitin 2022 |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i arritur)** | **66%** |

**A.1.b**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.1.b** për vitin 2023 është përdorimi i regjistrit nga 25% më shumë autoritete publike krahasuar me vitin 2022.

Gjatë vitit 2022, regjistri u bë i zbatueshëm në 194 194 autoritete publike në total, që kanë instaluar dhe përdorin regjistër elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve.

Për të arritur vlerat e treguesit për vitet për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masa (1) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| A.1.3 | Instalimi i regjistrit qendror të kërkesave dhe përgjigjeve dhe mbikëqyrja e përditësimit të regjistrit nga ana e koordinatorëve për të drejtën e informimit (2020-21 institucione; 2021-24 institucione; 2022-25 institucione; 2023-25 institucione). |
| A.1.3.1 | Numri i institucioneve ku është instaluar regjistri qendror i kërkesave dhe përgjigjeve |
| A.1.3.2 | Monitorime të KDIMDHP ndaj koordinatorëve të AP për regjistrin e kërkesë-ankesave |

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të numrit të autoriteteve publike të monitoruara çdo 3 mujor.

Për *janar-qershor 2023*, është kryer monitorimi i autoriteteve publike për regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve. Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve është instaluar ne 27 autoritete publike duke e cuar numrin total të autoriteteve publike që kanë instaluar regjistrin elektronik në 222 autoritete. Duke mbajtur në konsideratë objektivin për vitin 2023, ky tregues performance konsiderohet i realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve (shtojca 2 e Planit të Veprimit), paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | 2015 | |
| | N/A | |
| | 2017 | N/A |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | Përdorimi i regjistrit nga 30 institucione (p.sh. të gjitha ministritë dhe institucionet e pavarura) |
| | 2020 | Përdorimi i regjistrit nga 70 % më shumë autoritete publike krahasuar me vitin 2019 (treguesi është arritur në masën 133%) |

DRAFT

| | | |
|---|---|---|
| | 2021 | Përdorimi i regjistrit nga 50 % më shumë autoritete publike krahasuar me vitin 2020 |
| | 2022 | Përdorimi i regjistrit nga 30 % më shumë autoritete publike krahasuar me vitin 2021 |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Përdorimi i regjistrit nga 25 % më shumë autoritete publike krahasuar me vitin 2022 |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **100%** |

*Shënim*: referuar Pasaportës së Indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

### Niveli i realizimit të objektivit A.1.

Niveli i realizimit të *Objektivit A.1 Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - qershor 2023 **është 83%.**

Përllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR\ A.1 = \frac{TP\ A.1.a\ (66\%) + TP\ A.1.b\ (100\%)}{2\ TP} \times 100\% = 83\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit A.1 për këtë periudhë raportimi është **mirë** (51 në 85 për qind e masave të realizuara).

### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga KDMDHP për monitorimin zbatimit të planit të veprimit për 6M1 2023.

### Risqet për realizimin e Objektivit A.1

Nuk paraqitet asnjë risk evident për realizueshmërinë e këtij objektivi.

### *A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike*

DRAFT

Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:

*A.2.a: Raporti i elementëve të ndryshuar në Planet Vjetore të Prokurimit*

*A.2.b: Pjesa e kontratave të dhëna përmes procedurave me negocim pa publikuar paraprakisht njoftimin e kontratës*

*A.2.c: Pjesa e kontratave të ndryshuara gjatë vitit*

Plani i veprimit për Objektivin A.2 parashikon 6 Aktivitete dhe 3 Produkte/Masa

**A.2.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.2.a** për vitin 2023 është: *Elementët e ndryshuar në regjistrin e parashikimeve në masën 20%*.

Gjatë vitit 2022, përqindja e elementeve të ndryshuar në regjistrin e parashikimeve ishte 13.61%.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masa (1) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| A.2.1 | Përmirësimi i procesit të planifikimit nëpërmjet publikimit paraprak të procedurave të prokurimit |
| A.2.1.1 | Hartimi dhe miratimi i formularëve të njoftimit paraprak dhe njoftimit periodik të procedurave të prokurimit |
| A.2.1.2 | Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të APP në lidhje me përdorimin e njoftimeve paraprake dhe periodike të procedurave të prokurimit (trajnime, vizita studimore, etj) |

Për *janar - qershor 2023*, janë zhvilluar trajnime me qëllim forcimin e kapaciteteve të punonjësve të APP në lidhje me përdorimin e njoftimeve paraprake dhe periodike të procedurave të prokurimit.

Gjithashtu, hartimi dhe miratimi i formularëve të njoftimit paraprak dhe njoftimit periodik të procedurave të prokurimit është realizuar plotësisht gjatë vitit 2021.

Duke qenë se elementët e ndryshuar në regjistrin e parashikimeve kanë qenë në masën 8.2%, gjatë kësaj periudhe raportuese, ky tregues performance konsiderohet i realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | N/A |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | 35% |
| | 2020 | 20% |

DRAFT

| | | |
|---|---|---|
| | 2021 | 20% |
| | 2022 | Elementët e ndryshuar në regjistrin e parashikimeve në masën 20% |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Elementët e ndryshuar në regjistrin e parashikimeve në masën 20% |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **100%** |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

**A.2.b**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.2.b** për vitin 2023 është: Procedurat me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ndaj totalit të procedurave të fituara në masën 10%.

Gjatë vitit 2022, procedurat me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ndaj totalit të procedurave të fituara kanë qenë në masën 4,9%.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masa (1) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| A.2.2 | Mekanizma për përmirësimin e zbatimit të kontratave |
| A.2.2.1 | Hartimi dhe miratimi i instrumentave të nevojshëm për monitorimin e zbatimit të kontratës (Plani i zbatimit të kontratës; formulari i zbatimit të kontratës) |
| A.2.2.2 | Forcim i kapaciteteve të punonjësve të APP në lidhje me monitorimin e zbatimit të kontratës (trajnime, vizita studimore, etj). |

Për *janar-qershor 2023*, Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare e Administratës Publike në bashkëpunim, me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së dhe me suportin e Qeverisë Italiane, Franceze dhe Sllovake në Shqipëri, në kuadër të Profesionalizimit, pas hartimit të kurrikulave për nivelin bazë, të mesëm, të avancuar dhe ekspert, ka organizuar trajnimin e trajnerëve në fushën e prokurimit publik, me qëllim mbështetjen dhe forcimin e kapaciteteve, transparencës dhe llogaridhënies të njësive të prokurimit publik. Ky trajnim ofron metodat dhe mjetet për të siguruar një proces efikas të të nxënit dhe përfshin të gjitha fazat e ciklit të të nxënit, metodat, teknikat dhe mjetet e përdorura gjatë dhënies së një kursi trajnimi. Është krijuar dhe certifikuar trupa e trajnerëve në fushën e prokurimit publik, të cilët do të zhvillojnë një seri

DRAFT

trajnimesh me qëllim rritjen e kapaciteteve të nëpunësve që merren me prokurimet publike pranë AK. Sa më sipër trajnerët e APP kanë filluar trajnimet e punonjësve të prokurimeve ne rang qendror dhe vendor. Java e parë e trajnimeve , u zhvillua në fund të muajit qershor, 21-27 qershor. Në këtë javë trajnimi, përfaqësues të institucioneve të ndryshme të administratës publike, përgjegjës për prokurimet publike u trajnuan mbi njohuritë bazë për sa i përket prokurimeve publike. Gjithashtu përfaqësues nga APP kanë bërë një trajnim 2 ditor, konkretisht 19-20 Qershor të organizuar nga Ambasada Franceze në Tiranë, mbi monitorimin e zbatimit të kontratave. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të ATRAKO dhe ASHPP.

Në përfundim, duke qenë se procedurat me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ndaj totalit të procedurave të fituara kanë qenë gjatë kësaj periudhe raportuese në masën 2.05%, ky tregues performance konsiderohet i realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | 31.80% |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | 15% |
| | 2020 | 10% |
| | 2021 | 10% |
| | 2022 | 10% |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Procedurat me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ndaj totalit të procedurave të fituara në masën 10% |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **100%** |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

### A.2.c

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.2.c** për vitin 2023 është: ***Ndryshimet e kontratave në masën 10%.***

Gjatë vitit 2022, përqindja e kontratave të ndryshuara gjatë vitit ka qenë në masën 0,3%,

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masa (1) si më poshtë.

| A.2.3 | Mekanizma për përmirësimin e dokumentave të tenderit dhe specifikimeve teknike |
|---|---|
| A.2.3.1 | Hartimi dhe publikimi i rekomandimeve të vazhdueshme nga APP në lidhje me përmbajtjen e dokumentave të tenderit të përgatitura nga autoritetet/entet kontraktore me qëllim përmirësimin e tyre (Nr. i rekomandimeve të nxjerra) |
| A.2.3.2 | Forcim i kapaciteteve të punonjësve të APP në lidhje me përgatitjen e dokumentave të tenderit, në përputhje me parimet e transparencës, mosdiskriminimit, trajtimit të barabartë, konkurrencës së lirë dhe të ndershme (trajnime, vizita studimore, etj) |

Për *janar-qershor 2023*, APP ka vijuar me nxjerrjen e rekomandimeve të cilat publikohen dhe gjenden në faqen zyrtare të APP. Në janar 2023 është miratuar Vendimi Nr. 22, datë 18.1.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 384, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për formën e komunikimit në procedurat e prokurimit publik" (https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=95876131-18ab-4ecb-8cdf-40a17f461152)

APP ka publikuar në faqen e saj Rekomandimin Nr. 3166 Prot., date 14.04.2023 "Njoftim mbi Modifikimin e kontratave Marrëveshjeve kuadër gjatë kohëzgjatjes së tyre'.

https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=a11830de-bbdc-4c86-b1df-6fe55b692dea

Në faqen zyrtare të saj, APP, ka publikuar edhe një udhërrëfyes orientues për të gjitha Autoritetet Kontraktore në lidhje me "Zbatimin e prokurimit publik të gjelbër në Shqipëri" konkretisht në: https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=92c25399-7384-45d8-8358-613148b7165c

Në përfundim, duke qenë se përqindja e ndryshimeve të kontratave nga të dhënat e administruara për periudhën Janar-Qershor 2023 është 6.78%, ky tregues performance konsiderohet i realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | 21.20% |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | 15% |
| | 2020 | 10% (treguesi është arritur në masën 100%) |
| | 2021 | 10% |
| | 2022 | 10% |

DRAFT

| | | |
|---|---|---|
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | 10% |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **100%** |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

**Niveli i realizimit të objektivit A.2.**

Niveli i realizimit të *Objektivit A.2. Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-qershor 2023 **është 100%.**

Përllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{NR A.2} = \frac{\text{TP A.2.a } (100\%) + \text{TP A.2.b } (100\%) + \text{TP A.2.c } (100\%)}{3 \text{ TP}} \text{ x } 100\% = 100\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit A.2 për këtë periudhë raportimi është **shumë mirë** (56 në 110 për qind e masave të realizuara).

**Verifikueshmëria e të dhënave**

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Agjencia e Prokurimit Publik për monitorimin zbatimit të planit të veprimit për 6M1 2023.

**Risqet për realizimin e Objektivit A.2**

Ky objektiv ka mundësi të ulët risku dhe ndikim të mesëm të tij, forcimi i kapaciteteve të vazhdueshme të stafit dhe strukturave që merren me njohuritë në fushën e prokurimeve përbën kërkesë të shtuar dhe detyrë për tu kryer.

### *A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike*

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

*A.3: Numri i shërbimeve elektronike funksionale për qytetarët, bizneset dhe institucionet publike*

Plani i veprimit për Objektivin A.3 parashikon 6 Aktivitete dhe 3 Produkte/Masa

DRAFT

Për vitin 2019, vlera e synuar ishte 582, rritur me 20 shërbime elektronike krahasuar me vitin 2018. Për vitin 2020, vlera e synuar ishte 602, rritur më 20 shërbime elektronike krahasuar me vitin 2019. Për vitin 2021, vlera e synuar ishte 670, rritur më 68 shërbime elektronike krahasuar me vitin 202. Për vitin 2022, vlera e synuar ishte 720, rritur më 50 shërbime elektronike krahasuar me vitin 2021

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.3** për vitin 2023 është 750 shërbime elektronike.

Gjatë vitit 2021, numri total i shërbimeve elektronike arriti në 1225 shërbime elektronike, duke arritur një nivel zbatimi në masën 170%.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masa (1) si më poshtë.

| A.3.1 | Numri i shërbimeve elektronike funksionale për qytetarët, bizneset dhe institucionet publike |
|---|---|
| A.3.1.1 | Nr. shërbimesh elektronike të shtuara; (2020-602 shërbime; 2021-670 shërbime; 2022-720 shërbime e 2023-750 shërbime) |
| A.3.1.2 | Përcaktim i formës së aplikimit për e-shërbimet; kryerje analize e regjistrave elektronike ndërveprues |
| A.3.1.3 | Kryerje e zhvillimeve teknike për ekspozimin e të dhënave nga e-sistemet fundore të institucioneve |
| A.3.1.4 | Kryerje e zhvillimeve teknike për të konsumuar ëebservice-t përkatëse të e-sistemeve |
| A.3.1.5 | Kryerja e vlerësimit për strukturimin e informacionit për publikim në portalin e-Albania. |
| A.3.1.6 | Zhvillimet e nevojshme teknike për implementimin e shërbimit me vulë elektronike/nënshkrim elektronik (që mund të ofrohet). |

Për *janar-qershor 2023*, AKSHI ka vijuar punën për shtimin e shërbimeve elektronike dhe përmirësimin e shërbimeve ekzistuese në portalin unik qeveritar e-Albania. Ndërkohë është rritur edhe numri i sistemeve të lidhura me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit. Janë kryer përcaktimet e formave të aplikimit për e-shërbimet si dhe analizat e regjistrave elektronike ndërveprues. AKSHI ka përcaktuar format e aplikimit për e-shërbimet si dhe është kryer analizë e regjistrave elektronike ndërveprues. Në vijim të punës për shtimin e shërbimeve, janë kryer z hvillimet teknike për ekspozimin e të dhënave nga e-sistemet fundore të institucioneve si dhe ato për të konsumuar webservice-t përkatëse të e-sistemeve. Është kryer vlerësimi për strukturimin e informacionit për publikim në portalin e-Albania dhe janë marrë masat për të gjitha zhvillimet e nevojshme teknike për implementimin e shërbimit me vulë elektronike/nënshkrim elektronik (që mund të ofrohet).

AKSHI ka lehtësuar përgjigjet përmes platformës e-albania, në të cilën aktualisht regjistrohen 2.827.371 përdorues. Në këtë mënyrë digjitalizimi i shërbimeve publike ka bërë të mundur

reduktimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe burokracisë në marrjen e shërbimeve, njëkohësisht me rritjen e transparencës dhe efikasitetit. Ndërkohë, pranë kësaj platforme regjistrohen në total 1 227 shërbime të aksesueshme për qytetarët.

Në përfundim konstatohet se numri i shërbimeve elektronike të nivelit 3 & 4 të autenticitetit është 1227, deri në qershor të vitit 2023, çka dëshmon se ky tregues performance është arritur në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | 527 |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | 582, rritur me 20 shërbime elektronike krahasuar me vitin 2018 |
| | 2020 | 602, rritur më 20 shërbime elektronike krahasuar me vitin 2019 (treguesi është arritur në masën 141%) |
| | 2021 | 670, rritur më 68 shërbime elektronike krahasuar me vitin 2020 |
| | 2022 | Numri i shërbimeve elektronike të nivelit 3 & 4 të autenticitetit do të jetë 720, rritur më 50 shërbime elektronike krahasuar me vitin 2021 |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Numri i shërbimeve elektronike të nivelit 3 & 4 të autenticitetit do të jetë 750, rritur më 30 shërbime elektronike krahasuar me vitin 2022 |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **100%** |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

### Niveli i realizimit të objektivit A.3.

Niveli i realizimit të *Objektivit A.3. Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike* në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar-qershor 2023 **është 100 %.**

DRAFT

Shkalla e realizimit të objektivit A.3 për këtë periudhë raportimi është **shumë mirë** (81 deri në 110 e masave të realizuara).

### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për 6M1 2023.

### Risqet për realizimin e Objektivit A.3

Nuk paraqitet asnjë risk evident për realizueshmërinë e këtij objektivi.

### *A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit*

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

*A.4: Numri i hetimeve për korrupsion sipas denoncimeve të qytetarëve*

Plani i veprimit për Objektivin A.4 për vitet 2020-2023 parashikon 12 aktivitete dhe 5 masa.

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.4** për vitin 2023 *është*: *trendi rritës i numrit të numrit total të hetimeve për korrupsion të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve*, krahasuar me vitin e mëparshëm.

Përveç numrit total të hetimeve për korrupsion të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve, ky tregues përmban dhe një nën-tregues performance që është *raporti i hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve, të cilat janë dërguar nëpërmjet portaleve online, krahasuar me numrin total të hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve*.

Gjatë vitit 2022 nuk u evidentua një trend rritës në lidhje me 2021.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (12) dhe masat (5) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| A. 4.1 | Mekanizma për ngritjen/vënien në funksion të sistemit për ndjekjen/ monitorimin e hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve |
| A.4.1.1 | Ngritja e njësisë qendrore për hetimin e krimit ekonomik financiar, me 20 oficerë te përzgjedhur nga studentët e ekselencës, të cilët do trajnohen ne Akademinë e Sigurisë |
| A.4.1.2 | Ngritja e një sektori të posaçëm për gjetjen/ hetimin e aseteve kriminale që rrjedhin nga veprimtaria e korrupsionit, në përshtatje me standartet Europiane të AROS |
| A.4.1.3 | Rishikimi i procedurave standarte të punës bazuar në ristrukturimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit. |

| | |
|---|---|
| A. 4.2 | Ndërveprim funksional dhe përmirësim bashkëpunimi të strukturave të Policisë së Shtetit që hetojnë korrupsionin, në portalin www.shqiperiaqëduam.al |
| A.4.2.1 | Marrëveshje bashkëpunimi PSH-ADB |
| A.4.2.2 | Nr. i rasteve të aksesit të PSh në platformë; |
| A.4.3 | Forcim bashkëpunimi PSH- SHÇBA për hetimin e subjekteve të përfshira në korrupsion |
| A.4.3.1 | Ngritja e grupeve të përbashkëta institucionale të punës PSh - SHÇBA; Nr. i rasteve te hetimeve të përbashkëta |
| A.4.3.2 | Nr. i subjekteve të dërguara për procedime penale për veprën penale të korrupsionit nga hetimet përbashkëta. |
| A.4.4 | Kapacitete të ngritura të strukturave të specializuara që merren me hetimin e krimit të korrupsionit në PSH |
| A.4.4.1 | Trajnime të kryera (shefa të sektorëve në DVP dhe specialistëve kundër korrupsionit në DPP) |
| A.4.4.2 | Nr. i personave të trajnuar, 20 persona/vit |
| A.4.4.3 | Trajnime të specialistëve për hetimin e korrupsionit, pranë ambienteve të Qendrës së Formimit Policorë Tiranë, me trajnues nga strukturat e Prokurorisë dhe Gjykatës,126 persona/vit. (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj). |
| A.4.5 | Monitorim proaktiv dhe i vazhdueshëm i medias së shkruar dhe elektronike, rrjeteve sociale, pritja dhe zgjidhja në kohë ankesave/rasteve/informacioneve të denoncuara publikisht për krimin e korrupsionit |
| A.4.5.1 | Forcimi i kapaciteteve të strukturave teknike të PSH dhe SHÇBA për monitorimin/gjurmimin e rasteve |
| A.4.5.2 | Nr. i personave/staf i përfshirë në këto grupe për monitorimin e rasteve të denoncuara për prirje për korrupsion |

Për *janar - qershor 2023*, nga struktuarat e Policisë në adresën e Platformës së Bashkëqeverisjes janë marrë gjithsejt 143 ankesa. Ankesat në platformën e bashkëqeverisjes kanë adresuar kryesisht këto tematika:
- Konflikt pronësie e mos mbështetje nga strukturat e policisë.
- Ankesë për punonjësit e strukturave e policisë për probleme të ndryshme.
- Për vendosje gjobe në mënyrë të padrejtë, etj.

17 nga ankesat per dyshime të arsyeshme për vepra penale janë dërguar për trajtim në Drejtoritë vendore të policive përkatëse dhe është sugjeruar fillimi i procedimit penal nëse ekzistojnë elemente te veprave penale. Bazuar në ankesat e marra dhe të trajtuara ka filluar ecuria displinore për punonjës policie në 4 raste.

Në kuadër të operacionit “Toyota Double” janë kryer hetime të përbashkëta nga strukturat e Seksionit për Hetimin e Krimit Ekonomik dhe Financiar në DVP Korçë dhe Sektorin e Hetimit të AMP-së Korçë, ku është kryer arrestimi i dy shtetasve dhe hetimi në gjendje të lirë i një punonjësi policie në strukturat e kufirit të PKK Goricë, të dyshuar për veprat penale "Kontrabandë me mallra të licensuara", "Kontrabandë me mallra për të cilat paguhet akcizë ose me pezullim të pjesshëm apo të plotë nga detyrimet doganore ose të akcizës", "Ruajtje depozitim i mallrave të dyshuara kontrabandë" dhe “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga nenet 171, 172, 174 dhe 248 të Kodit Penal. Janë dërguar për procedim penal 2 shtetas, nga të cilët 1 punonjes policie.

Agjencia e Mbikqyrjes Policore pranë linjës së gjelbër ka marrë 1958 telefonata, ku:
963 telefonata kanë qenë brenda objektit të punës së AMP-së dhe nëpërmjet strukturave të Agjencisë është kontaktuar menjëherë telefonuesi duke i dhënë zgjidhje problemit të ngritur.
647 telefonata kanë qenë jashtë fushës së veprimtarisë së AMP-së dhe shtetasve u është dhënë informacioni i kërkuar dhe janë adresuar pranë strukturës përkatëse ku duhet të depozitojnë ankesën e tyre.
348 telefonata kanë qenë me objekt informacion në lidhje me veprimtarinë e AMP-së.

Janë administruar në sistemin e Menaxhimit të Çështjeve/Moduli i Ankesave, 604 ankesa të ardhura pranë Shërbimit, nga të gjitha portat e komunikimit të vëna në dispozicion të tyre:

Nëpërmjet postës elektronike të AMP-së - 282 ankesa;
Nëpërmjet postës zyrtarë të AMP-së -107 ankesa;
Nëpërmjet paraqitjes në Drejtoritë Rajonale - 102 ankesa
Nëpërmjet paraqitjes në zyrën e ankesave të AMP-së - 95 ankesa
Nëpërmjet institucioneve të tjera - 9 ankesa
Nga Avokati i Popullit - 4 ankesa
Nga Portali i Bashkëqeverisjes - 4 ankesa
Nga publikimet në media e rrjetet sociale - 1 ankesë

Në përfundim të hetimeve, në 25 raste është sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor nga Drejtoria e Standardeve Profesionale, në Policinë e Shtetit dhe Komisioni Disiplinor i Agjencisë, për 102 punonjës policie, të ndara sipas shërbimeve të policisë:
Në 6 raste për 15 punonjës të strukturave të hetimit të krimit;
Në 3 raste për 13 punonjës të strukturave të rendit dhe sigurisë publike;
Në 9 raste për 48 punonjës të strukturave të kufirit & migracionit;
Në 7 raste për 26 punonjës të strukturave të policisë rrugore.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, PSH ka evidentuar gjithësej 443 vepra penale, me 510 autorë[21].

[21] Ne krahasim me 6 mujorin e pare të vitit 2022, janë 88 vepra penale më pak.

Duke qenë se nuk ka ende një trend rritës me vitin 2022, por ka një punë të konsoliduar në këtë drejtim, treguesi i performancës është vlerësuar si i arritur në masën **50%** për këtë periudhë raportuese.

Gjithashtu edhe për këtë raport monitorimi, nuk janë prodhuar të dhëna për matjen e nën/treguesit A.4.a.1. *Raporti i hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve nëpërmjet portaleve online.*

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesve sipas Pasaportës së Treguesve (shtojca 2 e Planit të Veprimit), paraqitet si vijon:

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | 678 |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | 5% rritur, në lidhje me 2018 |
| | 2020 | 5 % rritur, në lidhje me 2019 (treguesi është arritur në masën 0%) |
| | 2021 | trend rritës në lidhje me 2020 |
| | 2022 | trend rritës në lidhje me 2021 |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | trend rritës në lidhje me 2022 |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **50%** |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

### Niveli i realizimit të objektivit A.4.

Niveli i realizimit të *Objektivit A.4. Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit* në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar-qershor 2022, është **50%.**

Shkalla e realizimit të objektivit A.4 për këtë periudhë raportimi është **mjaftueshëm** *(31 deri në 50 për qind e masave të realizuara).*

### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Policia e Shtetit për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit për periudhën 6M1 2023.

DRAFT

**Risqet për realizimin e Objektivit A.4**

Ky objektiv ka mundësi të lartë risku, pasi ndikohet drejtpërdrejtë nga numri i rasteve të korrupsionit të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve.

## *A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave*

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

*A.5.a: Bërja funksionale e sistemit online për deklarimin e pasurive deri në vitin 2020.*

*A.5.b: Zbatimi i ligjit për Sinjalizimin dhe mbrojtjen e Sinjalizuesve*

Plani i veprimit për Objektivin A.5 parashikon 8 Aktivitete dhe 7 Masa.

### A.5.a

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.5.a** për vitin 2023 është *analizimi i funksionimit të sistemit elektronik të deklarimit të pasurisë dhe interesave private*.

Gjatë vitit 2022, vlera e synuar u arrit në masën 100%, pasi u realizua forcimi i kapaciteve të përdoruesve të sistemit të deklarimit elektronik të pasurisë dhe interesave private nëpërmjet trajnimeve.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (5) dhe masat (4) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| A. 5.1 | Deklarimi i pasurisë nga subjektet e ligjit (deklaruesit dhe personat e lidhur me të) përmes sistemit online |
| A.5.1.1 | 80% e subjekteve që mbartin detyrimin për deklarim nëpërmjet sistemit elektronik, e kryejnë atë. |
| A. 5.2 | Mirëmbajtja e sistemit elektronik të deklarimit të pasurive dhe interesave private |
| A.5.2.1 | Sistemi elektronik në gjendje funksionale (mirëmbajtje për çdo vit) |
| A. 5.3 | Forcim i kapaciteve të përdoruesve të sistemit të deklarimit të pasurive nëpërmjet trajnimit |
| A.5.3.1 | Plani dhe materialet e trajnimit të përfunduara. |

| | |
|---|---|
| A.5.3.2 | 400 përdoruesve të trajnuar në nivel qendror dhe vendor (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj). |
| A. 5.4 | Analizimi i funksionimit të sistemit të deklarimit të pasurive dhe interesave private |
| A.5.4.1 | Termat e referencës të hartuara dhe vlerësimi i kryer, i hartuar dhe konsultuar |

Për *janar-qershor 2023*, pas ngritjes dhe funksionimit të sistemit, ILDKPKI ka vazhduar edhe gjatë këtij periudhe raportuese, me mirëmbajtjen e tij, sipas parashikimeve në Planin e Veprimit.

Me përfundimin e pilotimit të sistemit dhe adresimit dhe zgjidhjes së gjithë problematikave të konstatuara, ILDKPKI në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Evropës filloi seancat e trajnimit me Autoritetet Përgjegjëse të ngritura pranë institucioneve publike. Gjatë periudhës raportuese u trajnuan 329 përfaqësues të Autoriteteve Përgjegjëse si dhe u sigurua asistenca për një numër të konsiderueshëm të subjekteve deklaruese. Trajnimet synuan rritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të autoriteteve publike të cilat janë përgjegjëse për menaxhimin e procesit të deklarimit të interesave private. Këto aktivitete shërbyen edhe për njohjen e pjesëmarrësve me sistemin elektronik të deklarimit, me modulet kryesore të tij si dhe për dhënien e informacionit teknik me qëllim lehtësimin e procesit të deklarimit, nëpërmjet këtij sistemi.

Më tej, ILDKPKI, në kuadër të vazhdimit të bashkëpunimit me Komitetin Shqiptar të Helsinkit (KSHH), në vijim të zbatimit të nismës me titull "Shoqëria civile kundër korrupsionit – nga një sfidë lokale në një përgjigje europiane", ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi. Në kuadër të kësaj nisme, një nga objektivat prioritare që synohet të arrihet është rritja e transparencës, aksesit të hapur dhe llogaridhënies, si dhe angazhim i kapaciteteve institucionale në luftën kundër korrupsionit.

Në qershor 2023, ILDKPKI në bashkëpunim me Koalicionin e Europës Juglindore për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, zhvilloi një tryezë diskutimi, në kuadër të aktiviteteve për promovimin e përmirësimit të kuadrit ligjor dhe praktikës për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Fokusi kryesor i tryezës së diskutimit ishte progresi i transpozimit dhe përafrimit të legjislacionit të sinjalizimit me Direktivën e BE-së për sinjalizimin në vendet e Evropës Juglindore.

Në përfundim konstatohet se në kuadër të objektivit të vitit 2023, për këtë tregues performance "*Analizimi i funksionimit të sistemit elektronik të deklarimit të pasurisë dhe interesave private*", ILDKPKI ka vazhduar zbatimin e kontratës "Për shërbimin e Mirëmbajtjes së Sistemit të Deklarimit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit EACIDS" dhe mirëmbajtjen e sistemit dhe analizën e rezultateve. Për këtë arsye ky tregues performance vlerësohet i arritur në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | |
|---|---|
| | N/A |

| **Vlerat Bazë** | N/A | |
|---|---|---|
| | 2017 | 678 |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | Ngritja e infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e sistemit |
| | 2020 | Nënshkrimi i 15 memorandumeve të bashkëpunimit nga ILDKPKI (treguesi është arritur në masën 6%) |
| | 2021 | Deklarimi online i pasurive dhe interesave prej 80% e zyrtarëve |
| | 2022 | Forcim i kapaciteve të përdoruesve të sistemit të deklarimit elektronik të pasurisë dhe interesave private nëpërmjet trajnimit. |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Analizimi i funksionimit të sistemit elektronik të deklarimit të pasurisë dhe interesave private. |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **100%** |

Realizueshmëria e këtij treguesi në vite paraqitet si në tabelën më poshtë:

| | Projeksioni sipas vlerës së synuar | Vlera e arritur |
|---|---|---|
| E dhëna fillestare bazë 2018 | - Plotësimi i procedurave të prokurimit dhe nënshkrimi i kontratës.<br>- Projektimi i sistemit dhepërgatitja e dokumentacionit.<br>- Zhvillimi i sistemit dhe ngritja e infrastrukturës | Janë realizuar të gjitha procedurave të prjektuara në vlerën e synuar |
| Vlera e synuar 2019 rritje 5% | - Përfundimi i zbatimit, vizualizimit/<br>- funksionimit të sistemit, instalimi i bazës së të dhënave dhe ndërtimi i aplikacionit<br>- Zgjidhja e problemeve dhe rikodimi/ritestimi<br>- Testimi i integruar dhe dorëzimi<br>- Pajisja me materialet e trajnimit dhe me përdoruesit e trajnimit<br>- Pranimi përfundimtar dhe vendosja në funksionim të plotë e sistemit. | Janë realizuar të gjitha procedurave të prjektuara në vlerën e synuar |

DRAFT

| | | |
|---|---|---|
| Vlera e synuar 2020 rritje 5% | Memorandume Mirëkuptimi të nënshkruara ndërmjet ILDKPKI dhe 17 institucioneve.[22] | Vlera e synuar nuk është arritur. Memorandum i nënshkruar vetëm me 1 institucion nga 17.[23] |
| Vlera e synuar 2021 | Deklarimi online i pasurive dhe interesave prej 80% e zyrtarëve | Është krijuar gjithë infrastruktura e nevojshme. Subjektet deklaruese do të fillojnë të deklarohen përmes sistemit elektronik EACIDS duke filluar nga data 1 janar 2022. |
| Vlera e synuar 2022 | Forcim i kapaciteve të përdoruesve të sistemit të deklarimit elektronik të pasurisë dhe interesave private nëpërmjet trajnimit. | Janë kryer seancat e trajnimit në 15 institucione publike dhe ka trajnuar në total rreth 600 subjekte deklaruese. |
| Vlera e synuar 2023 | Analizimi i funksionimit të sistemit elektronik të deklarimit të pasurisë dhe interesave private | 100% |

**A.5.b**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.5.b** *për vitin 2023 është:* Konsultimi dhe miratimi i ndryshimeve në ligjin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

Gjatë vitit 2022, u krye vlerësimi gjithëpërfshirës mbi zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, duke ngritur grupin e punes, pergatitur termat e references, kontraktuar ekspertin, pregatitur dhe dorezuar raportin perkates të vleresimit mbi zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masat (3) si më poshtë.

[22] Qendra Kombëtare e Biznesit, Agjencia e Prokurimit Publik, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme Detare, ATRAKO, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Banka e Shqipërisë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, SPAK, Inspektori i Lartë i Drejtësisë

[23] Prokuroria e Përgjithshme

| | |
|---|---|
| A. 5.5 | Monitorimi i ushtrimit të funksioneve nga njësitë përgjegjëse për zbatimin e ligjit për sinjalizimin |
| A. 5.5.1 | Termat e referencës të hartuara (faza 1) Monitorimi i kryer për 166 Njësi Përgjegjëse në sektorin publik (faza II) Raporti vlerësues i hartuar me rekomandimet e dhëna për njësitë përgjegjëse në sektorin publik mbi zbatimin e ligjit të sinjalizimit (faza III) |
| A. 5.6 | Analizim gjithëpërfshirës mbi zbatueshmërinë e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve |
| A.5.6.1 | Termat e referencës të hartuara dhe vlerësimi i kryer, i hartuar dhe shpërndarë, me palët e interesuara |
| A. 5.7 | Organizimi i sesioneve konsultuese dhe hartimi i ndryshimevenë ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve |
| A. 5.7.1 | Rekomandime të hartuara bazuar mbi gjetjet e vlerësimit (I) Ndryshime ligjore të hartuara bazuar mbi rekomandimet e hartuara të vlerësimit (II) 3 sesione konsultuese mbi ndryshimet ligjore të hartuara me palët e interesuara (III) |

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që kryesisht kanë filluar në tremujorin e katërt të vitit 2021.

Gjatë *janar - qershor 2023*, ILDKPKI, në kuadër të vazhdimit të bashkëpunimit me Komitetin Shqiptar të Helsinkit (KSHH), në vijim të zbatimit të nismës me titull "Shoqëria civile kundër korrupsionit – nga një sfidë lokale në një përgjigje europiane", ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi. Në kuadër të kësaj nisme, një nga objektivat prioritare që synohet të arrihet është rritja e transparencës, aksesit të hapur dhe llogaridhënies, si dhe angazhim i kapaciteteve institucionale në luftën kundër korrupsionit.

Në qershor 2023, ILDKPKI në bashkëpunim me Koalicionin e Europës Juglindore për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, zhvilloi një tryezë diskutimi, në kuadër të aktiviteteve për promovimin e përmirësimit të kuadrit ligjor dhe praktikës për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Fokusi kryesor i tryezës së diskutimit ishte progresi i transpozimit dhe përafrimit të legjislacionit të sinjalizimit me Direktivën e BE-së për sinjalizimin në vendet e Evropës Juglindore.

Në përfundim vlerësohet se përafrimi i ligjit 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" me Direktivën e BE 2019/1937, sipas parashikimit në PKIE 2023-2025, ka si afat të kryerjes vitin 2024. *Për këtë shkak, ky tregues performance është në pamundësi për t'u matur gjatë vitit 2023.*

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | 161 |
| | 2018 | N/A |

DRAFT

| | | |
|---|---|---|
| | 2019 | 80% e sinjalizimeve të jashtme të regjistruara përfundohen brenda afatit ligjor |
| | 2020 | 85% e sinjalizimeve (treguesi është arritur në masën 100%) |
| | 2021 | 100% e sinjalizimeve |
| | 2022 | Vlerësim gjithëpërfshirës mbi zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve administrative nga ILDKPKI, përfundohen brenda afatit ligjor |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Konsultimi dhe miratimi i ndryshimeve në ligjin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **-[24]** |

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në tabelën më poshtë:

| | Projeksioni sipas vlerës së synuar | Vlera e arritur |
|---|---|---|
| E dhëna fillestare bazë | - | |
| Vlera e synuar 2018 | 70% e raportimeve të sinjalizuesve të iniciuara nga jashtë dhe të përfunduara brenda afatit ligjor | Raportuar 100%. Pa të dhëna se sa ka qënë numri i raporteve të të përfunduara brenda afatit |
| Vlera e synuar 2019 | 80% e raportimeve të sinjalizuesve të iniciuara nga jashtë dhe të përfunduara brenda afatit ligjor | Raportuar 100%. Pa të dhëna. Pa të dhëna se sa ka qenë numri i raporteve të të përfunduara brenda afatit |
| Vlera e synuar 2020 | 85% e raportimeve të sinjalizuesve të iniciuara nga jashtë dhe të përfunduara brenda afatit ligjor | Raportuar 100%. 9 raporte të përfunduara sipas afateve ligjore. |
| Vlera e synuar 2021 | Realizimi brenda afatit ligjor i hetimeve administrative e 85% të sinjalizimeve të jashtme (të kryera në ILDKPKI), mbi numrin total të sinjalizimeve të jashtme. | 11 raste të sinjalizimeve të jashtme të regjistruara pranë ILDKPKI. Për të gjitha rastet (100%), ka |

[24] Pamundësi matjeje për vitin 2023.

| | | |
|---|---|---|
| | | filluar apo është finalizuar hetimi administrativ në përputhje me afatet që parashikon ligji nr.60/2016. |
| Vlera e synuar 2022 | Vlerësim gjithëpërfshirës mbi zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve administrative nga ILDKPKI, përfundohen brenda afatit ligjor | Në proces finalizimi – 50% |
| Vlera e synuar 2023 | Konsultimi dhe miratimi i ndryshimeve në ligjin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve | -[25] |

**Niveli i realizimit të objektivit A.5.**

Niveli i realizimit të *Objektivit A.5. Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - qershor 2023 **është 100%**.

Përllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{NR A.5} = \frac{\text{TP A.5.a (100\%)} + \text{TP A.5.b } (-\%)}{2\text{ TP}} \text{ x } 100\% = 100\%$$[26]

**Verifikueshmëria e të dhënave**

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga ILDKPKI për monitorimin zbatimit të planit të veprimit për 6M1 2023.

**Risqet për realizimin e Objektivit A.5**

Ky objektiv ka mundësi të ulët risku dhe do të mund të ndikohet nga finalizimi në kohë i arritjeve të pritshme dhe treguesve.

***A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike***

Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:

[25] Pamundësi matjeje gjatë kësaj periudhe raportuese.
[26] Ky tregues performance është vlerësuar pas llogaritjes vetëm të treguesit të performancës A.5.a.

*A.6.a: Numri i raporteve të publikuara të auditimit nga partitë politike të certifikuara nga auditorët e jashtëm.*

*A.6.b: Raporti i sanksioneve të dhëna për rastet e identifikuara në kontekstin e shkeljeve të Kodit Zgjedhor.*

*A.6.c: Financat e partive politike të audituara në përputhje me rekomandimet e BE/ACFA.*[27]

Plani i veprimit për Objektivin A.6 parashikon 11 Aktivitete dhe 5 Masa.

**A.6.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.6.a** për vitin 2023 *është: 100% e raporteve të auditimit nga partitë politike, të çertifikuara nga auditorë të jashtëm dhe të pranuara nga KQZ, për partitë parlamentare; Trend rritës për partitë e tjera.*

Për vitin 2022 vlera e synuar ishte 100% e raporteve të auditimit nga partitë politike, të çertifikuara nga auditorë të jashtëm dhe të pranuara nga KQZ, për partitë parlamentare; Trend rritës për partitë e tjera. Gjatë vitit 2022 u dorëzuan të gjitha raportet e auditimit për vitin kalendarik 2021 nga 132, dhe të gjitha raportet e auditimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore, të dates 6 mars 2022.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masat (3) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| A. 6.1 | Përmirësim (rishikim i mëtejshëm) i modelit standard për raportimin financiar për vitin kalendarik; Forcim i kapaciteteve për financierët e partive, strukturën e posaçme në KQZ, audituesit ligjorë. |
| A. 6.1.1 | Modeli standard i miratuar/i rishikuar (në përputhje me ndryshimet e reformës legjislative) |
| A. 6.1.2 | Seanca trajnimi të kryera (I) Seanca trajnimi të kryera për modelin e raportimit financiar (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj). |
| A.6.3 | Përmirësim (rishikim i mëtejshëm) i formatit standard për raportimin nga ekspertët monitorues dhe audituesit ligjorë për përdorimin e raporteve të miratuara; Forcim/zhvillim i kapaciteteve për stafin teknik të KQZ, për përdorimin e raporteve të miratuara |
| A. 6.3.1 | Modeli standard i miratuar/i rishikuar |
| A. 6.3.2 | Trajnime të kryera për përvetësimin dhe plotësimin në mënyrën e duhur të këtij formati (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj). |

[27] ACFA (Anti Corruption Frameëork Assessment) është projekti i financuar nga Bashkimi European që u zbatua në periudhën 2014-2015.

| | |
|---|---|
| A.6.4 | Përditësim i vazhdueshëm i udhëzimeve në lidhje me raportimin financiar (në përputhje me ndryshimet mundshme ligjore); Forcim i kapaciteteve për stafin teknik të KQZ, për përdorimin e raporteve të miratuara |
| A. 6.4.1 | Udhëzimet e përditësuara të raportimit financiar |
| A. 6.4.2 | Trajnime të kryera për përvetësimin dhe plotësimin në mënyrën e duhur të këtij formati. |

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2021 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit (vjetor).

Gjatë *janar - qershor 2023*,

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | 61% (11 nga 18) |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | 75% e raporteve të auditimit |
| | 2020 | 80% e raporteve të auditimit (treguesi është arritur në masën 45%) |
| | 2021 | Auditimi i raporteve financiare të fushatës elektorale dhe auditimi i vitit kalendarik 2020. |
| | 2022 | 100% e raporteve të auditimit nga partitë politike, të çertifikuara nga auditorë të jashtëm dhe të pranuara nga KQZ, për partitë parlamentare; Trend rritës për partitë e tjera |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | 100% e raporteve të auditimit nga partitë politike, të çertifikuara nga auditorë të jashtëm dhe të pranuara nga KQZ, për partitë parlamentare; Trend rritës për partitë e tjera. |
| | **2023 (targeti i arritur)** | |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

**A.6.b**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.6.b** për vitin 2023 *është: **rritja** në masën 100% e sanksioneve të dhëna për rastet e identifikuara të shkeljeve finaciare nga partitë politike.*

Gjatë vitit 2022, ka qenë në proces vendimmarrja nga ana e KSHZ lidhur me sanksionet për rastet e identifikuara dhe objektivi ishte i realizuar në masën 50%.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masat (3) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| A. 6.2 | Ngritja e kapaciteteve profesionale për personat përgjegjës që kontrollojnë financimin e partive politike; Forcim i kapaciteteve për stafin teknik të KQZ |
| A. 6.2.1 | Trajnime të kryera (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj) |
| A.6.2.2 | Tryeza pune/seminare për stafin e KQZ. |

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2021 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit (vjetor).

Për *janar-qershor 2023,*

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | 38% |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | 75% e raporteve të auditimit |
| | 2020 | 30% e sanksioneve (treguesi është arritur në masën 155%) |
| | 2021 | 50% e sanksioneve |
| | 2022 | 70% e sanksioneve |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | 100% e sanksioneve |
| | **2023 (targeti i arritur)** | |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

DRAFT

**A.6.c**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.6.c** për vitin 2023 *është:* **mbajtja** në 5 e *raporteve financiare vjetore të partive politike.* Për vitin 2023 vlera është po e njëjta.

Për vitin 2019, vlera e synuar ka qenë mbajtja në 5 e raporteve financiare vjetore të partive politike. Për vitin 2020 dhe 2021, vlera e synuar ka qenë e njëjtë.

Për vitin 2022, u lidhën kontratat e ekspertëve kontabël të licensuar dhe ka vijuar faza e dorëzimit të raporteve të auditimit për fushatën zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore 2022, por nuk ka patur parti të audituara.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi performance për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masat (3) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| A.6.5 | Përditësim i vazhdueshëm i metodologjisë së kontrollit dhe verifikimit të financave të partive politike; Forcim i kapaciteteve për strukturën e posaçme në KQZ, dhe gjithë palët e interesuara në lidhje me këtë metodologji (seanca trajnshmesh të programuara) |
| A.6.5.1 | Metodologji e përmirësuar/ e përditësuar |
| A.6.5.2 | Nr. i personave të trajnuar (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj) |
| A.6.5.3 | Raporte kontrolli të financave të partive politike të publikuar/ raporte të KQZ të publikuar. |

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2021 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit (vjetor).

Për *janar - qershor 2023,*

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | 5 |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | 5 |
| | 2020 | 5 (treguesi është arritur në masën 100%) |
| | 2021 | 5 |
| | 2022 | 5 |
| | **2023 (targeti i synuar)** | **5** |

DRAFT

| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2022 (targeti i arritur)** | |
|---|---|---|

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

**Niveli i realizimit të objektivit A.6.**

Niveli i realizimit të *Objektivit A.6. Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - qershor 2023 është _%.

Përllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{NR A.6} = \frac{\text{TP A.6.a (50\%)} + \text{TP A.6.b (50\%)} + \text{TP A.6.c (40\%)}}{\text{3 TP}} \text{ x } 100\% = _\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit A.6 për këtë periudhë raportimi është _ (31 deri në 50 për qind e masave të realizuara).

**Verifikueshmëria e të dhënave**

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga KQZ për monitorimin zbatimit të planit të veprimit për 6M 1 2023.

**Risqet për realizimin e Objektivit A.6**

Ky objektiv ka mundësi të ulët risku dhe ndikim të mesëm të tij, forcimi i kapaciteteve të vazhdueshme të stafit dhe strukturave si dhe kryerja e auditimeve te raporteve financiare të partive politike.

***A.7 Përmiresimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut***

Për këtë objektiv janë përcaktuar 4 tregues performance:

*A.7.a: Raporti i rekomandimeve të auditimit të brendshëm të pranuara dhe zbatuara nga subjektet publike.*

*A.7.b: Numri i rasteve që vijnë nga auditime të brendshme që raportohen për hetim financiar*

*A.7.c: Numri i referimeve në prokurori si pasojë e inspektimeve financiare*

*A.7.d: Numri i inspektimeve financiare të kryera nga Njësia e Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë referuar sinjalizimeve të pranuara*

Plani i veprimit për Objektivin A.7 parashikon 12 Aktivitete dhe 4 Masa.

**A.7.a**

*Raporti i rekomandimeve të auditimit të brendshëm të pranuara dhe zbatuara nga subjektet publike.*

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.7.a** për vitin 2023 *është trend rritës përkundrejt vlerës bazë + viti paraardhës.*

Për vitin 2019, vlera e synuar ka qenë 60%. Për vitin 2020, vlera e synuar ka qenë trend rritës përkundrejt vlerës bazë të 2015. Për vitin 2021, vlera e synuar ka qenë trend rritës përkundrejt vlerës bazë + viti paraardhës.

Në vitin 2022, janë raportuar të dhëna për vitin 2021, nga ku rezulton se rekomandimet e nxjerra nga IAs (internal audits) dhe të pranuara nga institucionet janë 99.4% e rekomandimeve të pranuara, ose 7845. Numri i rekomandimeve të nxjerra nga IAs (internal audits) dhe të implementuara/zbatuara nga institucionet, për vitin 2021 kanë qenë 49.3% e rekomandimeve, ose 3865.

Ky tregues performance nuk është matur në vitin 2022, pasi raportimi i plotë për këtë tregues performance bëhet në muajin maj të vitit pasardhës. Kështu, vlerat e raportuara nga MFE për vitin 2022, në këtë raportim 6 mujor të 2023, paraqiten si më poshtë në vijim:

**Nën- treguesi a.1**: Rekomandimet e nxjerra nga IAs (*internal audits*) dhe të pranuara nga institucionet

*Objektivat për t'u arritur në 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023 janë:* Trend rritës për të gjitha vitet.

**Nën-tregues a.2**: Numri i rekomandimeve të nxjerra nga IAs (*internal audits*) dhe të implementuara/zbatuara nga insitucionet

*Objektivat për t'u arritur në 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023 janë:* Trend rritës për të gjitha vitet.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi performance për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (4) dhe masa (1) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| A. 7.1 | Rritja e kapaciteteve të auditit të brendshëm përmes zhvillimit të trajnimeve të vijueshme profesionale (TVP) të organizuara çdo vit, ku përfshihen çështje të |

| | |
|---|---|
| | mashtrimit dhe korrupsionit dhe kryerja e vlerësimeve të jashtme të cilësisë (VJC), të cilat fokusohen tek vlerësimi i performances së veprimtarisë audituese dhe tek rekomandimet e dhëna për përmirësimet e nevojshme në aktivitetin e auditit të brendshëm |
| A. 7.1.1 | Vlerësimi i nevojave për trajnim (I) Hartimi dhe miratimi i programit të TVP (II) Përgatitja e materialeve të trajnimit (III) Zbatimi i programit të TVP dhe 100% e auditit të brendshëm të punësuar dhe të certifikuar në sektorin publik (IV) 15 vlerësime të jashtme të cilësisë/vit. |
| A. 7.1.2 | Hartimi i udhëzuesit për audituesit e brendshëm në auditimin e mashtrimit financiar dhe korrupsionit. |
| A.7.1.3 | Trajnimi i audituesve të brendshëm mbi prezantimin e udhëzuesit në auditimin e mashtrimit financiar dhe kontrollit. Trajnimi i audituesve të brendshëm mbi etikën dhe integritetin. |
| A.7.1.4 | Kryerja e auditimeve të brendshme pilot dhe vizitë studimore mbi etikën dhe integritetin. |

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2022 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit (vjetor).

*Për janar-qershor 2023*, bazuar në Programin e Trajnimit të Vijueshëm Profesional të audituesve të Brendshëm në sektorin publik për vitin 2023, është miratuar Urdhri i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 295, datë 30.12.2022, ku është planifikuar të trajnohen 350 auditues. Gjatë kësaj periudhe monitorimi janë trajnuar gjithësej 125 auditues të brendshëm.

MFE ka kryer miratimin e planit vjetor të Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (perfshirë Vlerësimin e Jashtëm të Cilesise), me anë të shkresës nr.4806/1, date 09.03.2023. Gjithashtu janë realizuar 6 Vlerësime të Jashtme të Cilësisë: INSTAT, FSDKSH, DPSHTRR, Bashkinë Vau Dejes, Bashkinë Fier dhe Bashkinë Fushë Arrëz.

Duke mbajtur në konsideratë se objektivi për vitin 2023 është trend rritës përkundrejt vlerës bazë + viti paraardhës dhe numrin e rekomandime të pranuara dhe zbatuara për vitin 2021 dhe 2022, vlerësohet që ky tregues performance është arritur në masën 100%[28].

| Viti | Rekomandime të pranuara | Rekomandime të pranuara dhe zbatuara |
|---|---|---|
| 2016 | 7629 | 5183 |
| 2017 | 8341 | 4625 |

[28] Vlera e matur kryhet mbi bazën e shifrave të raportuara për vitin 2022 dhe krahasimi bëhet me vitin parardhës 2021.

| | | |
|---|---|---|
| 2018 | 7897 | 4501 |
| 2019 | 8294 | 4941 |
| 2020 | 7889 | 4177 |
| 2021 | 7845 | 3865 |
| 2022[29] | 7745 | 4030 |

**<u>Nën- treguesi a.1</u>**: Rekomandimet e nxjerra nga IAs (*internal audits*) dhe të pranuara nga institucionet. Për vitin 2021 ka një trend rritës me 99.4% e rekomandimeve të pranuara.

**<u>Nën-tregues a.2[30]</u>**: Numri i rekomandimeve të nxjerra nga IAs (*internal audits*) dhe të implementuara/zbatuara nga institucionet. Për vitin 2021 janë zbatuar 49.3% e rekomandimeve.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | N/A |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | 60% |
| | 2020 | trend rritës përkundrejt vlerës bazë të 2015 |
| | 2021 | trend rritës përkundrejt vlerës bazë + viti paraardhës |
| | 2022 | trend rritës përkundrejt vlerës bazë + viti paraardhës |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | trend rritës përkundrejt vlerës bazë + viti paraardhës |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **100%[31]** |

**A.7.b**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.7.b** për vitin 2023 *është: **rritja** në masën 10%.* Vlera e synuar për vitin 2023 është po e njëjta.

Për vitin 2020, 2021 dhe 2022 vlera e sy*nuar e treguesit ishte rritje në masën 10 %.*

[29] Këto të dhëna analizohen nga Raportet Vjetore të Auditimit të Brendshëm të cilat sipas përcaktimeve ligjore duhet të konsolidohen në Maj të vitit pasardhës. Pra, ky tregues për vitin 2022 është raportuar në qershor 2023.
[30] Raporti vjetor, përfundon në Maj të vitit pasardhës.
[31] Ky raport përmban të dhënat e treguesit për vitin 2022, pasi ato gjenerohen në muajin Maj të çdo viti pasaardhës. Për këtë periudhë monitorimi nuk ka mundësi gjenerimi të dhënash.



DRAFT

Gjatë vitit 2022, janë adresuar 2 raste nga struktura të auditit të brendshëm dhe treguesi i performancës është arritur në masën 50%.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masa (1) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| A. 7.2 | Ndërgjegjësim me qëllim informimin e drejtuesve të njësive të auditit të brendshëm mbi mundesite e bashkepunimit me inspektimin financiar publik |
| A. 7.2.1 | Takim me drejtues të DAB të institucioneve, 2 seminare/vit |
| A.7.2.2 | Përfaqësuesit e njësive DAB të institucioneve informohen mbi mundësitë e bashkëpunimit me inspektimin financiar public |
| A.7.2.3 | Takime të kryera |

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2022 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit (vjetor).

Gjatë *janar-qershor 2023*, janë realizuar takime me strukturën audituese të Ministrisë së Kulturës, më datë 24 maj dhe 26 maj 2023. Janë zhvilluar gjithashtu takime me strukturën audituese të AZHBR, në 6 shkurt dhe 9 mars 2023. Përfaqësuesit e njësive DAB u njohën me 3 raste konkrete dhe u diskutua për mundësi bashkëpunimi të mëtejshme. Gjithashtu janë zhvilluar 4 takime pune.

Në përfundim, duke mbajtur në konsideratë faktin se objektivi i treguesit të performancës është 10% rritje në krahasim me vitin 2022, ku janë adresuar vetëm 2 raste nga struktura të auditit të brendshëm, konstatohet se vlera për vitin 2023 duhet të jetë matematikisht 2.2 raste (2 raste + 10% rritje). Gjatë periudhës janar - qershor 2023 janë adresuar 2 raste të reja nga struktura të auditit të brendshëm. Kështu vlera e arritur për këtë tregues performance gjatë periudhës janar - qershor 2023 është 90%, çka tregon për një rezultat domethënës, duke mbajtur parasysh faktin se ky tregues performance matet mbi baza vjetore.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | N/A |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | 5 |
| | 2020 | Rritje me 10% (treguesi është arritur në masën 100%) |
| | 2021 | Rritje me 10% |

| | | |
|---|---|---|
| | 2022 | Rritje me 10% |
| | **2023 (targeti i synuar)** | Rritje me 10% |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i arritur)** | **90%** |

**A.7.c**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.7.c** për vitin 2023 është: 15% nga viti referues (2019).

Për vitin 2019, objektivi vjetor ka qenë 2 referime. Për vitin 2020, objektivi ka qenë 3% nga viti referues. Për vitin 2021, objektivi ka qenë 5% nga viti referues. Për vitin 2022, objektivi ka qenë 10% nga viti referues.

Për vitin 2022, kanë qenë në proces 3 inspektime te pafinalizuara.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi performance për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (4) dhe masa (1) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| A.7.3 | Rritja e kapaciteteve të inspektimit financiar publik përmes zhvillimit të trajnimeve profesionale vazhduese të organizuara çdo vit, në të cilat përfshihen çështje të mashtrimit dhe korrupsionit |
| A.7.3.1 | Vlerësimi i nevojave për trajnim (I) Hartimi i programit të trajnimit (II) Trajnimi i inspektorëve financiarë publikë, lidhur me trajtimin e parregullsive financiare, keqmenaxhimit financiar, shpërdorimit të detyrës dhe korrupsionit (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj) (III) |
| A.7.3.2 | Trajnime të strukturës së Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale për hetimin e korrupsionit, pranë ambienteve të Qendrës së Formimit Policor Tiranë, me trajnues nga strukturat e Policisë, Prokurorisë, Gjykatës, etj. *Trajnimet kryhen për çdo vit të zbatimit të PV |
| A.7.3.3 | Kryerja e vizitave studimore dhe trajnimeve mbi etikën dhe integritetin (aktivitet që fillon në vitin 2021) |
| A.7.3.4 | Përfaqësuesit e strukturës Antikorrupsion të informohen mbi mundësitë e bashkëpunimit me strukturat e tjera ndërinstitucionale, dhe të zhvillojnë seminare të përbashkëta lidhur me detyrat e tyre funksionale (DPD, DPT, PSH, etj.) |

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2022 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit (vjetor).

Për *janar-qershor 2023*, janë trajnuar 7 inspektorë financiarë publik mbi menaxhim e riskut, trajnim i kryer në datën 10 Shkurt 2023 si dhe 8 inspektorë mbi kontrollin e brendshëm financiar publik, statusin dhe zhvillimet në këtë fushë, trajnim i kryer në datën 10 Mars 2023. Ndëkohë, kryerja e vizitave studimore dhe seminareve mbi etikën dhe integritetin është parashikuar të zhvillohet në tremujorin e fundit të vitit.

Në përfundim, konstatohet se gjatë kësaj periudhe raportuese është kryer 1 referim në Prokurori që ka rezultuar nga inspektimet financiare. Objektivi i këtij treguesi performance për vitin 2023 është 15% nga viti referues 2019. Në vitin 2019 ka pasur 2 referime në prokurori që kanë rezultuar nga inspektimet financiare. 15% rritje mbi 2 raste, është 2.3 raste (*që treguesi i performancës të konsiderohet i realizuar 100%*). Kështu arrihet në konkluzionin se ky tregues performance, deri në këtë periudhë raportuese është arritur në masën 43% (*1 rast/2.3 raste*).

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | N/A |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | 2 referime |
| | 2020 | 3% nga viti referues (treguesi është arritur në masën 0%) |
| | 2021 | 5% nga viti referues |
| | 2022 | 10% nga viti referues |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | 10% nga viti referues |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **43%** |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

### A.7.d

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.7.d** për vitin 2023 *është: për 95% të sinjalizimeve (që plotësojnë kriteteret e ligjit), të jenë iniciuar inspektime.*

*Për vitin 2019, objektivi ka qenë që për 95% të sinjalizimeve, të jenë iniciuar inspektime. Për vitin 2020, objektivi ka qenë 80% e sinjalizimeve. Për vitin 2021, objektivi ka qenë 85% e sinjalizimeve.*

Në vitin 2022, për 90% të sinjalizimeve janë iniciuar inspektime. Megjithatë në raportimin e kryer nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk evidentohet një numër konkret i inspektimeve të kryera për vitin 2022, i cili do të bënte të mundur vlerësimin kumulativ të inspektimeve në 3 vite.

DRAFT

Për të arritur vlerat e këtij treguesi performance për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (5) dhe masa (2) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| A.7.3 | Rritja e kapaciteteve të inspektimit financiar publik përmes zhvillimit të trajnimeve profesionale vazhduese të organizuara çdo vit, në të cilat përfshihen çështje të mashtrimit dhe korrupsionit |
| A.7.3.1 | Vlerësimi i nevojave për trajnim (I) Hartimi i programit të trajnimit (II) Trajnimi i inspektorëve financiarë publikë, lidhur me trajtimin e parregullsive financiare, keqmenaxhimit financiar, shpërdorimit të detyrës dhe korrupsionit (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj) (III) |
| A.7.3.2 | Trajnime të strukturës së Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale për hetimin e korrupsionit, pranë ambienteve të Qendrës së Formimit Policor Tiranë, me trajnues nga strukturat e Policisë, Prokurorisë, Gjykatës, etj. |
| A.7.3.3 | Kryerja e vizitave studimore dhe seminareve mbi etikën dhe integritetin |
| A.7.3.4 | Përfaqësuesit e strukturës Antikorrupsion të informohen mbi mundësitë e bashkëpunimit me strukturat e tjera ndërinstitucionale, dhe të zhvillojnë seminare të përbashkëta lidhur me detyrat e tyre funksionale (DPD, DPT, PSH, etj.) |
| A.7.4 | Veprimtari informuese/sensibilizuese, me qëllim ndërgjegjësimin e institucioneve publike dhe publikut mbi funksionet e DIFP si dhe rritjen e transparencës mbi misionin e inspektimit |
| A.7.4.1 | Informacion i përditësuar në faqen zyrtare mbi DIFP (I) Deklarata të bëra publike (II) Menu informacioni në web (III) |

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2022 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit (vjetor).

Për *janar-qershor 2023*, janë trajnuar 7 inspektorë financiarë publik mbi menaxhim e riskut, trajnim i kryer në datën 10 Shkurt 2023 si dhe 8 inspektorë mbi kontrollin e brendshëm financiar publik, statusin dhe zhvillimet në këtë fushë, trajnim i kryer në datën 10 Mars 2023. Ndëkohë, kryerja e vizitave studimore dhe seminareve mbi etikën dhe integritetin është parashikuar të zhvillohet në tremujorin e fundit të vitit.

Gjithashtu është përditësuar informacioni mbi veprimtarinë e DIFP në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Në përfundim, konstatohet se gjatë kësaj periudhe raportuese për 90% të sinjalizimeve janë iniciuar inspektime financiare publike. Objektivi i këtij treguesi performance për vitin 2023 është që për 95% të sinjalizimeve (*që plotësojnë kriteteret e ligjit*), të jenë iniciuar inspektime. Kështu

arrihet në konkluzionin që ky tregues performance është arritur në masën 94%, gjatë kësaj periudhe raportuese. (*90/94*)

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | N/A |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | 70% |
| | 2020 | 80% e sinjalizimeve |
| | 2021 | 85% e sinjalizimeve |
| | 2022 | 90% e sinjalizimeve |
| | **2023 (targeti i synuar)** | 95% e sinjalizimeve |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i arritur)** | **94%** |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

### Niveli i realizimit të objektivit A.7.

Niveli i realizimit të Objektivit A.7 *Përmiresimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - qershor 2023 është **81.75 %.**

$$\text{NR A.7} = \frac{\text{TP A.7.a (100\%)} + \text{TP A.7.b (90\%)} + \text{TP A.7.c (43\%)} + \text{TP A.7.d (94\%)}}{\text{4 TP}} \text{ x } 100\% = 81.75\%$$

Duke llogaritur vlerën e tre treguesve të perfomancës, shkalla e realizimit të objektivit A.7 për këtë periudhë raportimi është **mirë** (*51 në 85 për qind e masave të zbatuara*).

### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e mbledhur nga Ministria Financave dhe Ekonomisë për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për periudhën 6M1 2023.

DRAFT

**Risqet për realizimin e Objektivit A.7**

Ky objektiv ka mundësi të mesme risku dhe ndikim të mesëm të tij, pasi sfidohet efikasiteti i strukturave dhe proceseve të rëndësishme si auditimi, inspektimi i brendshëm, etj.

### *A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion*

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance: *A.8: Numri i institucioneve publike që kanë kryer analiza vjetore për prirjet për korrupsion.*

Plani i veprimit për Objektivin A.8 parashikon 10 Aktivitete dhe 7 Masa.

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.8** për vitin 2023 është *të gjithë ministritë, institucionet e varësisë së tyre kanë zbatuar vlerësim risku.*

Për vitin 2022 objektivi ishte *mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut të testuara dhe zbatuara në të gjithë institucionet qendrore (ministritë).* Gjatë këtij viti, mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut janë testuar dhe zbatuar në të gjitha ministritë e linjës, fazë e cila i ka paraprirë miratimit të Planeve të Integritetit nga ana e tyre.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (10) dhe masat (7) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| A. 8.1 | Dokumenta strategjikë të hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës (analiza e riskut për prirjet ndaj korrupsionit) |
| A. 8.1.1 | Udhëzues/metodologjia mbi vlerësimin e riskut të integritetit në qeverisjen qendrore, i hartuar dhe i miratuar |
| A.8.2 | Forcim i kapaciteteve të stafit të MD mbi procesin e vlerësimit të riskut të integritetit për këtë institucion |
| A. 8.2.1 | Trajnim i stafit mbi identifikimin e risqeve te integritetit /Takime pune mbi identifikimin e proceseve të punës që janë të ekspozuara ndaj risqeve të integritetit (faza I) Identifikim i risqeve të integritetit sipas proceseve të punës (faza II) Analizim dhe vlerësim i intensitetit të risqeve të identifikuara (faza III) Trajtimi i risqeve prioritare dhe atyre të moderuara si edhe hartimi i planit të veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit në MD (faza IV) |
| A.8.3 | Vlerësimi i riskut të integritetit në institucionet e varësisë së MD sipas modelit të zhvilluar në MD (Udhëzuesit) |
| A. 8.3.1 | Plan pune për informimin dhe prezantimin ndaj institucioneve të varësisë të MD, për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit dhe prezantimi i udhëzuesit |

| | |
|---|---|
| A. 8.3.2 | Vlerësimi i riskut në institucionet e varësisë të MD, i hartuar dhe i miratuar |
| A.8.4 | Vlerësimi i riskut të integritetit në institucionet qendrore dhe varësitë e tyre, sipas Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për qeverisjen qendrore (udhëzuesi) |
| A.8.4.1 | Plan pune për informimin dhe prezantimin ndaj ministrive të linjës, për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit dhe prezantimi i Udhëzuesit ministrive; |
| A.8.4.2 | Vlerësimi i riskut në nga ministritë, i hartuar dhe i miratuar |
| A.8.4.3 | Vlerësimi i riskut në nga ministritë dhe institucionet e tyre të varësisë, i hartuar dhe i miratuar |
| A.8.5 | Kontrolli dhe verifikimi (hetimi administrativ) i zbatimit të ligjshmërisë dhe/ose denoncimeve për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare në të gjitha institucionet e administratës publike dhe agjencitë shtetërore |
| A.8.5.1 | Nr. i raporteve të inspektimeve të grupeve të inspektimit (I) Nr. i masave të marra në përfundim të inspektimeve (II) Nr. i rasteve të referuara në prokurori (III) |
| A.8.6 | Raportimi i rasteve të masave disiplinore, administrative e kallëzimeve penale për rastet e korrupsionit në administratë |
| A.8.6.1 | Nr. i rasteve/zyrtarëve të gjetur në shkelje për praktika korruptive. |
| A.8.7 | Transparencë e rritur e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit për rastet e kontrolleve të bëra nga TFA |
| A.8.7.1 | Nr. i komunikimeve (deklarata, konferenca, njoftime për shtyp) online të KKK për rastet e kontrolleve të TFA |

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej vitit 2023 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit (vjetor).

Gjatë *janar-qershor 2023*, Ministria e Drejtësisë ka vijuar procesin e nxitjes dhe koordinimit të përpjekjeve institucionale për të kryer vlerësimin e riskut kryesisht në insitucionet e varësive të ministrive të linjës. Planet e Integritetit të miratuara, janë bazuar në rezultatet e vlerësimit të riskut në proceset kryesore të punës në institucionet publike. Ky angazhim ka synuar adresimin e problemeve të mundshme të korrupsionit si dhe uljen e riskut në institucionet publike. Ky proces vijon të mbetet për t'u kryer në institucionet e varësive të ministrive të linjës, i cili pritet që të përmbushet sipas përcaktimeve ligjore.

Gjithashtu, në zbatim të aktiviteteve të parashikuara për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës, Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion, pranë Ministrisë së Drejtësisë e cila njëkohësisht luan edhe rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, ka administruar në

total 202 ankesa për këtë periudhë raportuese. Në përfundim të shqyrtimit të tyre, janë dhënë 83 masa për fillimin e ecurisë disiplinore, 29 masa për largim nga detyra, 109 rekomandime si dhe janë referuar 9 raste në prokurori, me 28 persona të kallëzuar. Nga ana e saj Ministria e Drejtësisë nuk ka patur raste të zyrtarëve të gjetur në shkelje për praktika korruptive.

Gjatë kësaj periudhe ka patur njoftime dhe përditësime të rregullta të KKK për rastet e kontrolleve të TFA[32], në profilet sociale të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion, Facebook, Twitter dhe LinkedIn.

Në përfundim, duke mbajtur në konsideratë objektivin për vitin 2023, ku të gjitha ministritë dhe institucionet e tyre të varësisë duhet të kenë zbatuar një vlerësim risku, vihet re:

Me kërkesën zyrtare Nr.3204 prot, datë 02.05.2023, me përmbajtje "*Mbi hartimin e planit të integritetit në institucionet e varësisë së ministrive*"dhe koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë, ky proces ka filluar të zbatohet edhe nga të gjitha institucionet e varësive të ministrive të linjës.

12 institucionet e varësisë së *Ministrisë së Drejtësisë* e kanë kryer vlerësimin e riskut dhe kanë miratuar Planet e Integritetit, përpara kësaj periudhe raportuese.
Lidhur me institucionet e varësisë së *Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit*, për këtë periudhë raportuese Agjencia Kombëtare e Turizmit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit kanë kryer vlerësimin e riskut;

Lidhur me institucionet e varësisë së *Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*, Instituti i Higjenës e kanë zbatuar vlerësimin e riskut.

Lidhur me institucionet e varësisë së *Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme*, gjatë kësaj periudhe raportuese janë dërguar udhëzimet përkatese me shkresë të Sekretarit të Përgjithshem të ministrisë, për kryerjen e vlerësimit të riskut dhe hartimin e Planit të Integritetit në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomatik, duke përcaktuar edhe afatin deri ne fund te vitit 2023.

Lidhur me institucionet e varësisë së *Ministrisë së Brendshme*, të gjitha kanë zbatuar vlerësimin e riskut.

Të gjitha institucionet e varësisë së *Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural*[33], e kanë kryer vlerësimin e riskut.

---

[32] Pas ndryshimeve ligjore të vitit 2021, është shfuqizuar TFA dhe kompetencat e saj i ka marrë Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion.
[33] Institucionet e varësisë që kanë kryer vlerësimin e riskut janë:
Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural – AZHBR

Gjithashtu 6 institucione të Ministrisë së Finacave dhe Ekonomisë e kanë kryer vlerësimin e riskut.

Në këto kushte ky tregues performance është vlerësuar i arritur në masën 50%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | N/A |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | Instrumenti i hartuar për vlerësimin e rrezikut po zbatohet në 10 Ministri. |
| | 2020 | Udhëzime të zhvilluara dhe të pranuara për kryerjen e vlerësimit të riskut në institucionet publike (qendrore);<br>Është përgatitur një program trajnimi për zbatimin e manualit;<br>Eshtë miratuar udhëzimi për kryerjen e vlerësimit të riskut<br>Është vendosur një plan veprimi ndërinstitucional për kryerjen e vlerësimeve të riskut;<br>Mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut kanë filluar të testohen në 2020 dhe janë zbatuar në 10 institucione publike qendrore/ministri<br>(treguesi është arritur në masën |

DRAFT

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë – ISUV
Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës
Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve
Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve
Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore - QTTB Fushë-Krujë
Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore - QTTB Lushnje
Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore - QTTB Korçë
Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore - QTTB Vlorë
Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore - QTTB Shkodër
Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, Durrës
Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë
Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, Fier
Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, Korçë
Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor, Tiranë
Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor, Lushnje
Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor, Korçë
Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor, Shkodër
Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve

| | | |
|---|---|---|
| | | 50%) |
| | 2021 | Mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut të testuara dhe zbatuara në të gjithë institucionet e varësisë së MD |
| | 2022 (targeti i synuar) | Mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut të testuara dhe zbatuara në të gjithë institucionet qendrore (ministritë) |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Të gjithë ministritë, institucionet e varësisë së tyre kanë zbatuar vlerësim risku |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **50%** |

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në grafikun më poshtë:

| | Projeksioni sipas vlerës së synuar | Vlera e arritur |
|---|---|---|
| E dhëna fillestare bazë | - Mungesa e kuadrit për kryerjen e vlerësimit sistematik të rrezikut të integritetit/korrupsionit | |
| Vlera e synuar 2018 | - Eshtë hartuar dhe miratuar udhëzimi/manuali për kryerjen e vlerësimit të rrezikut të integritetit/korrupsionit në institucionet publike si pjesë e planit të integritetit.<br>- Është hartuar një program trajnimi lidhur me zbatimin e manualit.<br>- Po zbatohet një plan veprimi ndër institucional për kryerjen e vlerësimeve të vlerësimit të rrezikut të korrupsionit. | Vlera e synuar nuk është arritur. |
| Vlera e synuar 2019 | - Instrumenti i hartuar për vlerësimin e rrezikut po zbatohet në 10 Ministri. | Vlera e synuar nuk është arritur. |
| Vlera e synuar 2020 | - Udhëzime të zhvilluara dhe të pranuara për kryerjen e vlerësimit të riskut në institucionet publike (qendrore);<br>- Është përgatitur një program trajnimi për zbatimin e manualit;<br>- Është vendosur një plan veprimi ndërinstitucional për kryerjen e vlerësimeve të riskut;<br>- Mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut kanë filluar të të testohen 2020 dhe zbatuara në 10 institucione publike qendrore/ministri | Eshtë miratuar udhëzimi për kryerjen e vlerësimit të riskut në institucionet publike.<br>Është hartuar programi i trajnimit për zbatimin e manualit dhe |

| | | |
|---|---|---|
| | | kryerjen e vlerësimit të riskut, për të filluar nga zbatimi në vitin në vijim (2021)<br>Plan veprimi ndërinstitucional për kryerjen e vlerësimeve të riskut rezulton ende i papërfunduar (në proces).<br>Por nuk realizuar produkti i 4-rt i treguesit. |
| Vlera e synuar 2021 | Mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut të testuara dhe zbatuara në të gjithë institucionet e varësisë së MD | 100% |
| Vlera e synuar 2022 | Mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut të testuara dhe zbatuara në të gjithë institucionet qendrore (ministritë) | 100% |
| Vlera e synuar 2023 | Të gjithë ministritë, institucionet e varësisë së tyre kanë zbatuar vlerësim risku | 50%[34] |

**Niveli i realizimit të objektivit A.8**

Niveli i realizimit të Objektivit A.8 *Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion* në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar - qershor 2023 është **50%.**

Shkalla e realizimit të objektivit A.8 për këtë periudhë raportimi është **mjaftueshëm** (31-50 për qind e masave të realizuara).

**Verifikueshmëria e të dhënave**

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e mbledhur nga Ministria e Drejtësisë për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për 6M1 2023.

[34] Sipas vlerësimit të kryer në 6M1 2023. Megjithatë ky tregues performance do të matet plotësisht në fund të vitit 2023.

**Risqet për realizimin e Objektivit A.8**

Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për të hartuar raportet e monitorimit evidentohet si një risk potencial në vijueshmërinë e realizimit të objektivit A.8.

### *A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publik*

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance: Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë.

Plani i veprimit për Objektivin A.9 parashikon 3 Aktivitete dhe 3 Masa.

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.9** për 2023 është *të gjitha varësitë e institucioneve qendrore miratuan dhe publikuan një plan integriteti*.

Për vitin 2022 objektivi ishte të gjitha institucionet qendrore (ministritë) miratuan dhe publikuan një plan integriteti. Gjatë këtij viti, të gjitha ministritë e linjës miratuan dhe publikuan një plan integriteti dhe kështu, treguesi i performancës u vlerësua i arritur në masën 100%.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masat (3) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| A.9.2 | Hartimi/miratimi dhe zbatimi i Planeve të Integritetit nga të gjitha institucionet e varësitë e MD |
| A. 9.2.1 | Takime informuese/ndërgjegjësuese për punonjësit e varësive të MD mbi procesin e hartimit/miratimit dhe zbatimit të Planeve të Integritetit; Nr. i Planeve të Integritetit të hartuara dhe të miratuara nga institucionet e varësisë së MD |
| A.9.3 | Hartimi/miratimi dhe zbatimi i Planeve të Integritetit nga të gjitha institucionet qendrore (ministritë) |
| A. 9.4.1 | Takime informuese/ndërgjegjësuese për punonjësit e institucioneve të varësive mbi procesin e hartimit/miratimit dhe zbatimit të Planeve të Integritetit; Dokumenti Plan Integriteti i hartuar dhe miratuar |
| A.9.5 | Dokumente strategjike të hartuara përmes një procesi gjithëpërfshirës/metodologjia-udhëzuesi për vlerësimin e zbatimit të masave |
| A.9.5.1 | Hartimi i metodologjisë për vlerësimin e zbatimit të vlerësimit të PI; ngritja e një strukture të raportit të vlerësimit |

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej 2023 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit (vjetor).

Në *janar - qershor 2023,* Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e institucionit lider dhe koordinues në udhëheqjen e politikave të integritetit, ka kryer komunikime frekuente dhe ka dërguar kërkesë zyrtare për institucionet e varësisë mbi procesin e zbatimit të Planeve të Integritetit, tashmë i miratuar në 12 institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë. Ministria e Drejtësisë ka ndjekur të njëjtën metodologji edhe me ministritë e linjës, të cilat do të kujdesen që ky proces të kryhet edhe nga institucionet e tyre të varësisë.

Me kërkesën zyrtare Nr.3204 prot, datë 02.05.2023, me përmbajtje "*Mbi hartimin e planit të integritetit në institucionet e varësisë së ministrive*"dhe koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë, ky proces ka filluar të zbatohet edhe nga të gjitha institucionet e varësive të ministrive të linjës.

12 institucionet e varësisë së *Ministrisë së Drejtësisë* e kanë kryer vlerësimin e riskut dhe kanë miratuar Planet e Integritetit, përpara kësaj periudhe raportuese.

Sa i takon institucioneve të varësisë së *Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit*, Agjencia Kombëtare e Turizmit ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit. Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka hartuar draftin final dhe është në fazë të reflektimit të komenteve të bëra nga MTM. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit janë në proces përgatitje të Planeve të Integritetit.

Sa i takon institucioneve të varësisë së *Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*, Instituti i Higjenës e ka miratuar Planin e Integritetit.

Gjithashtu 6 institucione të Ministrisë së Finacave dhe Ekonomisë kanë miratuar Planin e Integritetit.

Sa i takon institucioneve të varësisë së *Ministrisë së Brendshme*[35], të gjitha kanë hartuar Planet e Integritetit, përvec Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqëndruara, e cila është ende në proces të miratimit të tij.

Lidhur me institucionet e varësisë së *Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme*, gjatë kësaj periudhe raportuese janë dërguar udhëzimet përkatese me shkresë të Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë, për kryerjen e vlerësimit të riskut dhe hartimin e Planit të Integritetit në Drejtorinë e Shërbimit të Trupit Diplomatik, duke përcaktuar edhe afatin deri ne fund te vitit 2023.

---

[35] Policia e Shtetit ka miratuar Planin e dytë të Integritetit 2022-2024, gjatë vitit 2022, i cili është ndarë me të gjitha strukturat vendore dhe qëndrore të policisë. Dokumenti gjendet në linkun: https://www.asp.gov.al/plani-i-integritetit-tepolicise-se-shtetit.

Po ashtu, të gjitha institucionet e varësisë së *Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural*[36], kanë miratuar Planet e tyre të Integritetit.

*Përsa i përket institucioneve të varësisë së ministrive të linjës, në tërësi gjatë kësaj periudhe monitorimi, vihet re se është arritur një progres i lehtë.*

Gjithashtu, duke zgjeruar politikat e integritetit përtej administratës shtetërore, vlerësohet gjithashtu fakti që Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar një Plan Integriteti dhe e ka publikuar në linkun: https://www.idp.al/wp-content/uploads/2022/09/2.-22_9_22-Plan-Integriteti-IDP-.pdf.
Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka miratuar dhe publikuar Planin e vet të Integritetit në link: https://klp.al/2023/03/09/plani-integritetit-2023-2025/. Procesi po vijon në institucione si Parlamenti, Gjykata Kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor me ndihmën e OJF-ve si IDM dhe ALTRI.

Në përfundim, fakti që Planet e Integritetit tashmë janë miratuar plotësisht vetëm në institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë dhe ministritë e linjës, në krahasim me totalin e institucioneve që kanë detyrimin për të miratuar një Plan Integriteti gjatë vitit 2023, (ministri linje + institucione varësie), është vlerësuar arritja në masën 40% e këtij treguesi.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | |
|---|---|
| | N/A |
| | N/A |

DRAFT

[36] Institucionet e varësisë të MBZHR që kanë miratuar Planet e Integritetit janë:
Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural – AZHBR
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë – ISUV
Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës
Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve
Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve
Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore - QTTB Fushë-Krujë
Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore - QTTB Lushnje
Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore - QTTB Korçë
Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore - QTTB Vlorë
Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore - QTTB Shkodër
Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, Durrës
Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, Lezhë
Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, Fier
Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, Korçë
Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor, Tiranë
Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor, Lushnje
Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor, Korçë
Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor, Shkodër
Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | 2017 | N/A |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | 10 ministri kanë miratuar dhe publikuar planin e integritetit |
| | 2020 | Një model/udhëzues për hartimin e planit të integritetit miratuar dhe publikuar nga Ministria e Drejtësisë. (treguesi është arritur në masën 100%) |
| | 2021 | Të gjitha varësitë e MD miratuan dhe publikuan një plan integriteti |
| | 2022 | Të gjitha institucionet qendrore (ministritë) miratuan dhe publikuan një plan integriteti |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Të gjitha varësitë e institucioneve qendrore miratuan dhe publikuan një plan integriteti |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **40%** |

Realizueshmëria e këtij treguesi që nga hartimi i treguesve paraqitet si në tabelën më poshtë:

| | Projeksioni sipas vlerës së synuar | Vlera e arritur |
|---|---|---|
| E dhëna fillestare bazë | Mungesa e kuadrit për hartimin e planeve të integritetit. | |
| Vlera e synuar 2018 | Një model/udhëzues për hartimin e planit të integritetit miratuar dhe publikuar nga Ministria e Drejtësisë. | Vlera e synuar nuk është arritur. |
| Vlera e synuar 2019 | 10 ministri kanë miratuar dhe publikuar planin e integritetit | Vlera e synuar nuk është arritur. |
| Vlera e synuar 2020 | Një model/udhëzues për hartimin e planit të integritetit miratuar dhe publikuar nga Ministria e Drejtësisë. | Është miratuar udhëzuesi për hartimin e planit të integritetit. |
| Vlera e synuar 2021 | Të gjitha varësitë e MD miratuan dhe publikuan një plan integriteti | Vlera e synuar është arritur. 12 institucionet e varësisë së MD kanë miratuar një plan integriteti me urdhër të |

| | | |
|---|---|---|
| | | brendshëm të titullarit të institucionit. |
| Vlera e synuar 2022 | Të gjitha institucionet qendrore (ministritë) miratuan dhe publikuan një plan integriteti | Vlera e synuar është arritur. Të gjitha ministritë e linjës kanë miratuar një plan integriteti me urdhër të titullarit të institucionit. |
| Vlera e synuar 2023 | Të gjitha varësitë e institucioneve qendrore miratuan dhe publikuan një plan integriteti | Të gjithë ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë kanë miratuar dhe publikuar një plan integriteti.<br><br>Nga institucionet e varësisë të ministrive të linjës,<br>Policia e Shtetit dhe Instituti i Higjenës kanë miratuar një PI.<br><br>Ministritë e linjës po koordinojnë këtë proces edhe për insititucionet e tyre të varësisë. |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

**Niveli i realizimit të objektivit A.9**

Niveli i realizimit të Objektivit *A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë* në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për për periudhën janar - qershor 2023 është **40%.**

Shkalla e realizimit të objektivit A.9 për këtë periudhë raportimi është **mjaftueshëm** (31-50 për qind e masave të realizuara).

### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e mbledhur nga Ministria e Drejtësisë për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për 6M1 2023. Linket e publikimit të planeve të Integritetit të institucioneve gjenden më lart.

### Risqet për realizimin e Objektivit A.9

Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për të hartuar raportet e monitorimit si dhe numri i lartë i institucioneve të varësisë të ministrive qendore, evidentohet si një risk potencial në vijueshëmrinë e realizimit të objektivit A.9.

### *A.10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit*

Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:

*A.10: Statistika të konsoliduara dhe të harmonizuara për korrupsionin prodhohen dhe publikohen në mënyrë periodike (Çdo vit).*

Plani i veprimit për Objektivin A.10 parashikon 2 Aktivitete dhe 2 Masa.

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.10** për vitin 2023 *është: statistikat prodhohen dhe publikohen një herë në vit; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C1, D1; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit statistikor duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C, D1, D2, D3 dhe të prodhuara dhe të botuara çdo vit.*

Vlerat e synuara për vitin 2022 ka qenë po e njëjta. Gjatë këtij viti janë hartuar 3 raporte statistikore 6 mujori II 2021/Vjetori 2021 dhe 6MI 2022. Kështu vlera e arritur për këtë tregues performance, ka qenë 100%.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masat (2) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| A. 10.1 | Mbledhja, përpunimi dhe harmonizimi i të dhënave statistikore mbi korrupsionin |
| A. 10.1.1 | Informacion statistikor i prodhuar mbi korrupsionin (raport 6- mujor/vjetor) *Raporti vjetor 2023 hartohet dhe përfundon brenda TM I 2024 |
| A.10.2 | Mbledhja dhe harmonizimi i të dhënave statistikore për asetet e konfiskuara dhe sekuestruara me vendim gjykate për veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe përcjellja pranë Komisionit Evropian |

DRAFT

| | |
|---|---|
| A. 10.2.1 | Informacion statistikor i prodhuar lidhur në veprat penalë të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, sipas parashikimeve në Kodin Penal<br><br>*Raporti vjetor 2023 hartohet dhe përfundon brenda TM I 2024 |

Realizimi i masave të parashikuara do të kryhet përmes aktiviteteve që fillojnë prej janarit të vitit 2022 dhe vazhdojnë përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit të veprimit (vjetor).

Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, koordinon procesin e mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të të dhënave statistikore nga Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, SPAK, AAPSK, si dhe gjykatat e të treja niveleve për veprat penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit sipas parashikimeve në Kodin Penal.

Gjatë janar-qershor 2023, janë mbledhur, përpunuar dhe harmonizuar statistikat e konsoliduara për veprat penale në lidhje me korrupsionin (Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, SPAK dhe Gjykatat) për gjashtëmujorin e dytë dhe vitin 2022. Poashtu, janë mbledhur të dhënat për asetet e konfiskuara, për veprat penale në lidhje me korrupsionin për gjashtëmujorin e dytë dhe vitin 2022. Këto të dhëna do të publikohen në "Vjetarin Statistikor 2022".
Gjithashtu, janë mbledhur të dhënat për asetet e konfiskuara për veprat penale në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar për gjashtëmujorin e dytë dhe vitin 2022. Këto të dhëna do të publikohen në "Vjetarin Statistikor 2022". Është kryer koordinimi dhe plotësimi I tabelave të track record's për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për gjashtëmujorin e dytë dhe vitin 2022. Kështu janë hartuar 2 raporte statistikore (6 mujori II 2022/Vjetor 2022). Raporti vjetor 2022 do të publikohet dhe botohet në Vjetarin Statistikor 2022. Kostoja e realizimit të kësaj mase është e mbuluar nga buxheti i shtetit.

Për shkak të riorganizimit të gjykateve ka ende nevojë për të kryer disa rakordime shtesë e në vijim raportet e hartuara të publikohen në faqen e Ministrisë së Drejtësisë.

Në vijim, shërbimet e Komisionit Evropian në kuadrin e mbështetjes së kapaciteteve të vendeve kandidate/kandidate potenciale, për të mbledhur dhe raportuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të plotë, të dhënat në lidhje me historikun e ndjekjeve dhe dënimeve penale, kanë krijuar një platformë të re elektronike për mbledhjen, raportimin dhe përpunimin e këtij informacioni. Kjo platformë u pilotua në muajin Korrik 2022. Vendosja e të dhënave në këtë platformë do të kryhet nga përfaqësuesit e çdo shteti kandidat/kandidat potencial, e cila do të zëvendësojë praktikën e mëparshme të shkëmbimit të informacionit.

Kjo platformë është e strukturuar në dy grupe/faqe kryesore të dhënash:

1. Në grupin e parë të përmbledhjeve sasiore do të raportohen të dhëna bruto mbi numrin e personave fizikë/juridikë të hetuar/proceduar/gjykuar për fushat e veprave penale të listuara, duke zëvendësuar formën e raportimit me tabela excel të ndjekur deri më tani për raportimet 6 mujore /

1 vjeçare. Në version e rishikuar platforma përmban një zgjerim të fushës së veprave penale konkretisht veprat penale të: prodhimit dhe trafikimit të narkotikëve; trafikimit të qënieve njerëzore; terrorizmit; kontrabandës së duhanit; vrasjeve të lidhura me bandat; trafikimit të migrantëve; trafikimit të armëve; mashtrimit kompjuterik; trafikimit të mjeteve motorike; falsifikimit të parave; falsifikimit, në vijim të veprave penale në fushat e korrupsionit; krimit të organizuar dhe pastrimit të parave që ishin të njohura nga takimi i pilotimit.

2. Faqja tjetër e platformës kërkon një raportim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe më të detajuar të proceseve të lidhura me veprat penale të korrupsionit në nivele të larta, krimit të organizuar dhe pastrimit të parave. Në këtë faqe të platformës do të raportohen të gjitha veprimet e ndërrmara që nga nisja e hetimeve deri në përfundim të procesit gjyqësor.

Gjithashtu në këtë format të rishikuar, fushat e shtuara të raportimit kanë pësuar disa ndryshime nga formati zyrtar i mbajtur deri më sot në kuadrin e raportimit vjetor, ku përveç ndarjes së disa fushave, raportimi në platformë do të listohet në numër personash fizikë/juridikë të hetuar/proceduar/gjykuar dhe jo numrin e çështjeve.

Vendosja dhe përditësimi i këtyre të dhënave në platformë do të kryhet nga përfaqësuesit të cilët përzgjidhen nga shtetet përkatëse. Komisioni në pozitën e monitoruesit do të ketë mundësinë që të shikojë në kohë reale çdo raportim apo ndryshim në platformë, por në kuadrin e raportimit zyrtar sistemi do t'i dërgojë automatikisht 3 email-e kujtese (3 muaj, 1 muaj dhe 1 javë nga marrja automatike e të dhënave), në momentin që Komisioni vendos një datë raportimi.

Kuadri i rishikuar i platformës dhe zgjerimi i fushës së veprave penale që do të raportohen, sjell nevojën e njoftimit dhe njohjes me platformën edhe të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), institucione të cilat deri më sot nuk kanë qenë pjesë e këtyre takimeve, pasi fushat e kërkuara kanë qenë jashtë juridiksionit të përgjithshëm.

Në këtë kuptim, Shërbimet e Komisionit Evropian kanë komunikuar mundësinë e zhvillimit të takimeve brenda ose jashtë vendit (sipas kërkesës), për të rritur më tej kapacitetet brenda administratës si dhe për të fuqizuar të gjitha institucionet e interesuara me qëllim përdorimin e saktë të platformës së re elektronike.

Në përfundim, vlerësohet se ky tregues performance konsiderohet i realizuar, pasi gjatë kësaj periudhe raportuese janë mbledhur, përpunuar dhe harmonizuar statistikat e konsoliduara për veprat penale në lidhje me korrupsionin për gjashtëmujorin e dytë dhe vitin 2022. Për pasojë janë hartuar 2 raporte statistikore (6 mujori II 2022/Vjetor 2022), të cilat mbeten për t'u publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, pas kryerjes së disa rakordime shtesë.

Ky tregues performance vlerësohet i arritur në masën 95%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | |
|---|---|
| | N/A |

DRAFT

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | 2017 | 1 |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | Statistikat prodhohen dhe publikohen një herë në vit; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C1, D1; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit statistikor duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C, D1, D2, D3 dhe të prodhuara dhe të botuara çdo vit. |
| | 2020 | Statistikat prodhohen dhe publikohen një herë në vit; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C1, D1; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit statistikor duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C, D1, D2, D3 dhe të prodhuara dhe të botuara çdo vit (treguesi është arritur në masën 100%) |
| | 2021 | Statistikat prodhohen dhe publikohen një herë në vit; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C1, D1; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit statistikor duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C, D1, D2, D3 dhe të prodhuara dhe të botuara çdo vit |
| | 2022 | Statistikat prodhohen dhe publikohen një herë në vit; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C1, D1; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit statistikor duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C, D1, D2, D3 dhe të prodhuara dhe të botuara çdo vit. |

DRAFT

| | | |
|---|---|---|
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Statistikat prodhohen dhe publikohen një herë në vit; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C1, D1; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit statistikor duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C, D1, D2, D3 dhe të prodhuara dhe të botuara çdo vit. |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **95%** |

### Niveli i realizimit të objektivit A.10

Niveli i realizimit të Objektivit A.10 *Analizimi i prirjeve të korrupsionit dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit* në lidhje me realizimin e treguesit të performancës për periudhën janar - qershor 2023 **është 95%.**

Shkalla e realizimit të objektivit A.10 për këtë periudhë raportimi është **shumë mirë** (86-111 për qind e masave të realizuara).

### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Ministria e Drejtësisë për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për 6M 1 2023.

### Risqet për realizimin e Objektivit A.10

Risku i realizimit të këtij objektivi ka mundësi "të ulët" të ndodhjes dhe ndikim "të mesëm" në arritjen e objektivit. Risqet lidhen kryesisht me afatin e përpunimit të të dhenave statistikore nga struktura përgjegjese, procesit të riorganizimit të gjykateve dhe rakordimin e platformës së re elektronike për mbledhjen, raportimin dhe përpunimin e informacionit, me ndihmën e shërbimeve të Komisionit Europian.

### *A.11 Adaptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore*

Për këtë objektiv jnaë përcaktuar 2 tregues performance:

*A.11.a: Raporti i bashkive që kanë hartuar plane vendore antikorrupsion dhe plane integriteti (në përputhje me strategjinë ndër-sektoriale kundër korrupsionit)*

*A.11.b: Numri i Bashkive që alokojnë një zë të veçantë të buxhetit për zbatimin e politikës vendore antikorrupsion*

Plani i veprimit për Objektivin A.11 parashikon 3 Aktivitete dhe 3 Masa.

**A.11.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.11** për vitin 2023 është *61 bashki miratojnë planin e integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut*.

Për vitin 2022 vlera e synuar ka qenë 40 bashki miratojnë planin e integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut.  Duke qenë se vlera e arritur gjatë kësaj periudhe raportuese ka qenë 21 bashki kanë miratuar planet e integritetit, treguesi i performancës është konsideruar i realizuar në masën 50%.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masat (2) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| A. 11.1 | Takime informuese për hartimin e Planeve Vendore të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes në të gjitha bashkitë e vendit (në vijim të 6 bashkive pilot) |
| A. 11.1.1 | Takime informuese të realizuara me titullarë të bashkive/me stafet e bashkive dhe finalizim i modelit të dokumentit |
| A.11.2 | Përgatitja e Planeve Vendore të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes dhe dërgimi i tyre për miratim pranë këshillave bashkiake |
| A. 11.2.1 | Takime teknike konsultative të realizuara (faza I) 10 bashki miratojnë Plane Lokale të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes për vitin 2020 (faza II) 10 bashki miratojnë Plane Lokale të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes për vitin 2021 (faza III) 40 bashki miratojnë Plane Lokale të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes për vitin 2022 (faza IV) të gjitha (61) bashki miratojnë Plane Lokale të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes për vitin 2023 |

Për *janar-qershor 2023*, AMVV ka zhvilluar 5 takime teknike konsultative me njësitë e vetqeverisjes vendore, konkretisht në Bashkitë Lushnje dhe Librazhd, në funksion të procesit që lidhet me hartimin dhe miratimin e Planeve Vendore të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes. Janë kryer gjithashtu fushata informimi për përcaktimim e një buxheti specifik për implementimin e masave specifike të planeve të integritetit, njëherazi me takimet teknike konsultative të zhvilluara në Bashkitë Lushnje dhe Librazhd.

Në përfundim, duke mbajtur parasysh targetin e treguesit të performancës për vitin 2022 si dhe faktin që vetëm Bashkia Roskovec ka miratuar një plan integriteti gjatë kësaj periudhe raportuese, duke e çuar numrin total në 22 bashki në vend, vlerësohet që ky tregues performance është arritur në masën 36%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | N/A |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | AMVV-ja dërgon udhëzuesin, për të gjitha bashkitë. |
| | 2020 | 6 bashki miratojnë planin e integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut (treguesi është arritur në masën 16.6%) |
| | 2021 | 10 bashki miratojnë planin e integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut |
| | 2022 | 40 bashki miratojnë planin e integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | 40 bashki miratojnë planin e integritetit në përputhje me vlerësimin e riskut |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **36%** |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

**A.11.b**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës A.11.b** për vitin 2023 *është: 61 bashki alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit.*

Për vitin 2022, vlera e synuar ishte *40 bashki alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit*, nga të cilat rezultoi se asnjëra nuk ka alokuar buxhet për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit, e për pasojë treguesi i performancës ishte 0% i realizuar.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (1) dhe masat (1) si më poshtë.

DRAFT

| | |
|---|---|
| A. 11.3 | Inkurajimi i bashkive të përcaktojnë një buxhet specifik për implementimin e politikave vendore AK, në përputhje me strategjinë antikorrupsion; Inkurajimi i bashkive të tjera për vitet në vijim |
| A. 11.3.1 | Fushata informimi për përcaktimin e një buxheti specifik për implementimin e masave specifike të planeve të integritetit/total 6 bashki për vitin 2020/total 10 bashki për vitin 2021/total 40 bashki për vitin 2022/total 61 bashki për vitin 2023 |

Për periudhën e monitorimit *janar-qershor 2023*, raportohet se Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore/MB ka inkurajuar bashkitë që të përfshijnë në buxhet një zë specifik për implementimin e Planit të Integritetit. AMVV vazhdon informimin për përcaktimin e buxhetit mbi mplementimin e masave specifike të planeve të integritetit. Janë kryer gjithashtu fushata informimi për përcaktimim e këtij buxheti për implementimin e masave specifike të planeve të integritetit, njëherazi me takimet teknike konsultative të zhvilluara në Bashkitë Lushnje dhe Librazhd.

Megjithatë, gjatë kësaj periudhe, asnjë bashki nuk raportohet të ketë alokuar buxhet për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit, e për pasojë ky tregues performance është vlerësuar përsëri me 0%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | N/A |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | N/A |
| | 2020 | 6 bashki alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit |
| | 2021 | 10 bashki alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit |
| | 2022 | 40 bashki alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | 61 bashki alokojnë 1% të buxhetit për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **0%** |

**Niveli i realizimit të objektivit A.11.**

Niveli i realizimit të *Objektivit A.11. Adaptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-qershor 2023 **është 18%.**

Përllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{NR A.11} = \frac{\text{TP A11.a (36\%)} + \text{TP A.11.b (0\%)}}{2\ \text{TP}} \times 100\% = 18\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit A.11 për këtë periudhë raportimi është **dobët** (0-30 për qind e masave të realizuara).

### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për periudhën 6M 1 2023.

### Risqet për realizimin e Objektivit A.11

Risku i realizimit të këtij objektivi është i lartë për shkak të rreziqeve të lidhura me mjedisin e brendshëm që lidhen me komunikimin dhe informimin si dhe me çështje të tjera që lidhen me mjedisin rregullativ. Gjithashtu fakti që mungesa e buxhetit për miratimin e planeve të integritetit vijon për të dytin vit rradhazi, e bën këtë objektiv të vështirë për t'u realizuar në fund të vitit 2023. Pra ka mundësi të lartë risku dhe ndikim të mesëm të tij.

### *Realizueshmëria e objektivave specifike të qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit (Qasja A)*

Mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe përpunimin e të dhënave të treguesve të performancës tabela më poshtë paraqet shkallën e realizimit të 11 objektivave specifike të qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit.

Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave - duke mbledhur realizueshmërinë në përqindje të treguesve të performancës dhe pjestuar me numrin e treguesve – realizueshmëria e qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit është _%.

| Objektivi | Realizueshmëria |
|---|---|
| A.1. Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion | 75 % |
| A.2. Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike | 100% |

| | |
|---|---|
| A.3. Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike | 100% |
| A.4. Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit | 50% |
| A.5. Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave | 100% |
| A.6. Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike | |
| A.7. Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut | 81.75% |
| A.8. Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion | 50% |
| A.9. Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë | 40% |
| A.10. Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit | 95% |
| A.11. Adaptimi i politikave anti-korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore | 18% |

Realizueshmëria e qëllimit strategjik për parandalimin e korrupsionit, e cila është në masën 61.34% tregon për një rezultat të mirë përgjatë periudhës janar - qershor 2023. Qasja parandaluese në luftën kundër korrupsionit është një sfidë thelbësore për çdo shoqëri dhe strukturë institucionale. Vihet se re një angazhim për të sjellë transparencë dhe hapësirë të informacioneve relevante për veprimtarinë e autoriteteve publike.

Vijojnë gjithashtu ritme të mira sa i takon përdorimit të teknologjisë dhe sistemeve elektronike për të siguruar autenticitetin e dokumenteve dhe transaksioneve, duke ulur mundësinë e manipulimit dhe mashtrimit. Policia e Shtetit ka pasur një rol të shtuar duke treguar angazhimin dhe veprimet e forcave të rendit për zbulimin dhe ndjekjen penale të aktorëve.

Ritme të kënaqshme vihen re edhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përgjatë kësaj periudhe raportuese, duke arritur një nivel të mirë të zbatimit të treguesve të performancës që vlerësohen në tërësi komplekse dhe me një risk të lartë të ndodhjes së tyre.

Nga ana tjetër vihen ende re mangësi në raportet e auditimit nga partitë politike, çertifikuar nga auditorë të jashtëm apo sanksione që janë dhënë për raste të shkeljeve të evidentuara. Kjo tregon nevojën për më shumë angazhim për të zbuluar dhe ndëshkuar ata që shkelin ligjin dhe për të forcuar llogaridhënien.

Përpjekjet e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit ndaj vlerësimit të riskut dhe përmirësimit të integritetit, përbëjnë një politikë e rëndësishme shtetërore. Kjo përpjekje synon të identifikojë zonat me rrezikshmëri të lartë për korrupsionin dhe të planifikojë masat për ta

DRAFT

parandaluar. Megjithatë treguesi i limituar për njësitë e vetqeverisjes vendore dëshmon se shërbimet lokale kanë ende nevojë për mbikqyrje dhe përmirësim, duke i kushtuar më tepër vëmendje përpjekjeve për të parandaluar dhe adresuar korrupsionin.

Ministria e Drejtësisë prodhon gjithashtu statistika të konsoliduara dhe të harmonizuara për korrupsionin në mënyrë periodike, gjë e cila ka ndihmuar në monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të masave parandaluese, duke lejuar identifikimin e fushave ku ka nevojë për veprime të mëtejshme.

Përmes këtyre hetimeve dhe masave, Shqipëria ka ndërmarrë hapa në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Megjithatë, sfida vazhdon dhe është e nevojshme të vijohet me përpjekjet për të forcuar institucionet, të thellohet transparenca dhe të ndërmerren masa të tjera për të krijuar një shoqëri të ndershme dhe të integruar.

***Qasja Ndëshkuese - Përmbledhje për arritjet në ndëshkimin e korrupsionit***

Përmes **qëllimit të politikës (qasjes) ndëshkuese SNKK** ka për qëllim që institucionet ligjzbatuese dhe veçanërisht ato të pavarura, të cilat kanë një rol thelbësor në këtë proces, duhet të monitorojnë zbatimin e ligjit dhe sundimin e shtetit të së drejtës, duke siguruar kështu transparencën dhe integritetin e organeve shtetërore.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë.

| Qasja (Qëllimet e Politikës) | Masat dhe Aktivitetet | Realizimi i Masave dhe aktiviteteve | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Masa dhe aktivitete të parashikuara për periudhën janar - qershor 2023 | Masa dhe aktivitete **plotësisht** të realizuara | Masa dhe aktiviteteve **pjesërisht** të realizuara[37] | Masa dhe aktivitete të **parealizuara**[38] |
| Ndëshkuese | Masa | 20 | 7 | 3 | 10 |
| | Aktivitete | 29 | 10 | 2 | 17 |

Rezulton se nga 23 masa e 32 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2020 – 2023, për janar-qershor 2022, për Qasjen B (Ndëshkuese), janë zbatuar 7 masa/10 aktivitete prej tyre, 3 masa/2 aktivitete janë ende në proces zbatimi dhe 10 masa/17 aktivitete janë të pazbatuara përkatësisht (masa B.1.1; B.1.3; B.1.4; B.1.11; B.2.1; B.2.2; B.2.3; B.3.4; B.4.3 dhe B.4.4 dhe

[37] Aktivitet "pjesërisht i realizuar" është ai aktivitet që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.
[38] Aktivitet "i parealizuar" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind

aktivitete B.1.1.1; B.1.1.2; B.1.3.1; B.1.4.1; B.1.11.1; B.2.1.1; B.2.2.1; B.2.3.1; B.2.3.2; B.2.3.3; B.2.3.4; B.2.3.5; B.2.4.2; B.3.4.1; B.4.1.2; B.4.3.1 dhe B.4.4.1).

GRAFIK

Nga 9 treguesit e performances për qasjen parandaluese (B), është arritur vlera e synuar për 0 tregues performance, është arritur pjesërisht vlera e synuar për 2 tregues performance si edhe nuk është arritur vlera e synuar për 7 tregues performance.

| **Qasja Ndëshkuese** | Treguesit e performancës | Realizimi i Treguesve të Performancës | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Vlera e synuar është realizuar plotësisht[39] | Vlera e synuar është realizuar pjesërisht[40] | Vlera e synuar nuk është e realizuar[41] |
| | 9 | 0 | 2 | 7 |

GRAFIK

***B.1 Përmirësimi i efiçencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit.***

Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:

*B.1.a: Numri i kallëzimeve për korrupsion (rastet dhe personat)*

*B.1.b: Numri i kërkesave për sekuestrimin e pasurive në rastet e korrupsionit*

*B.1.c: Vlera e parashikuar e të ardhurave nga krimi të sekuestruara në rastet e korrupsionit*

Plani i veprimit për Objektivin B.1 parashikon 20 Aktivitete dhe 13 Masa.

| | |
|---|---|
| B. 1.1 | Forcimi i kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit, këtyre të fundit dhe gjyqësorit |
| B.1.1.1 | Kryerja e vlerësimit të nevojave për trajnim (I) Hartimi i programit të trajnimit (II) |
| | PP, Prokurori e Posaçme, Komisioni i Policisë Gjyqësore |
| B.1.1.2 | Kryerja e trajnimit/Nr. i personave të trajnuar; (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj) |
| B. 1.2 | Monitorimi dhe raportimi i të dhënave statistikore lidhur me sekuestrimet |

[39] Që është realizuar në shkallën 100 për qind

[40] Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

[41] Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mblidhen të dhëna

DRAFT

| | |
|---|---|
| B.1.2.1 | Formati i raportimit statistikor dhe procesi i mbledhjes së të dhënave i krijuar |
| B.1.2.2 | Raportimi periodik i kryer |
| B. 1.3 | Forcimi i kapaciteteve në logjistikë dhe burime njerëzore i strukturave të hetimit të korrupsionit dhe krimit ekonomik |
| B.1.3.1 | Numri i stafit të rekrutuar, pajisur me mjetet/kushtet e nevojshme të punës dhe trajnuar |
| B. 1.4 | Rritja e përdorimit të mjeteve të posaçme të hetimit në procedimet për vepra penale në fushën e korrupsionit për rezultate më efektive në luftën kundër tij |
| B.1.4.1 | Nr. i rasteve të aplikimit të neneve 221, 294/a, 294/b të K.Pr.P. |
| B. 1.6 | Kryerja e trajnimeve të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit |
| B.1.6.2 | Kryerja e trajnimit/grupet e trajnimit (25 persona/grup) - total nr. i personave të trajnuar, 126 persona/vit (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj). |
| B. 1.7 | Kryerja e trajnimeve për rritjen e nivelit profesional të efektivëve të angazhuar për të dokumentuar veprat penale në fushën kundër korrupsionit dhe krimeve në detyrë (PSH/OPGJ në strukturën kundër korrupsionit) |
| B.1.7.1 | Kryerja e vlerësimit të nevojave për trajnim dhe hartimi i programit trajnimit |
| B.1.7.2 | Kryerja e trajnimit; (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj). |
| B. 1.9 | Mekanizma specifike për të zhvilluar luftën kundër korrupsionit në kuadër të administrimit dhe menaxhimit e aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara që rrjedhin nga korrupsioni |
| B.1.9.1. | Ngritja e grupit të punës për hartimin e akteve nënligjore |
| B.1.9.2 | Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr.34/2019 (janar-dhjetor 2020) |
| B.1.9.3 | Krijimi i regjistrit elektronik, për mbajtjen, formën, raportimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara si dhe përcaktimin e organeve publike apo subjekteve që kanë të drejtë të kenë akses në të Portali i AAPSK/e-shërbime |
| B. 1.10 | Rritja e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve dhe konferencave të përbashkëta me institucionet homologe ndërkombëtare |
| B.1.10.1 | Module trajnimi të hartuara (I) Seanca trajnimi të kryera (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj) |
| B. 1.11 | Rritja e kapaciteteve profesionale të stafit të AAPSK në fushën e administrimit të shoqërive të sekuestruara dhe të konfiskuara |
| B.1.11.1 | Trajnime të kryera për stafin (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj) |
| B. 1.12 | Rritja e kapacitetit hetimor nëpërmjet forcimit të strukturës së hetimit dhe shfrytëzimit të instrumentave ligjorë që shërbëjnë për përmbushjen e veprimtarisë si në aspektin procedurial penal dhe të veprimtarisë inteligjente |

| | |
|---|---|
| B.1.12.1 | Nr. i rasteve zbuluara të dyshuara për kryerje apo implikim në veprimtari të kundërligjshme të punonjësve të strukturave, objekt i veprimtarisë së ShÇBA (I) Nr. referimesh (II) Nr. punonjësish të proceduar (III) Nr. punonjësish të arrestuar/ndaluar si dhe nr. operacionesh të kryera (IV) |
| B. 1.13 | Rritja e numrit dhe cilësisë së hetimeve proaktive, për punonjës të strukturave, objekt i veprimtarisë së ShÇBA |
| B.1.13.1 | Numri i hetimeve proaktive të finalizuara me dokumentimin ligjor dhe goditjen e rasteve të veprimtarisë së kundraligjshme të kryer nga punonjës të strukturave, objekt i veprimtarisë së ShÇBA |

Masat dhe aktivitetet e parashikuara në planin e veprimit, për këtë objektiv nuk janë qartësisht të ndara sipas tre treguesve të objektivit. Për këtë arsye zbatimi i aktiviteteve dhe realizimi masave është analizuar në mënyrë të agreguar për të tre treguesit, ndërsa vlerësimi për secilin tregues është kryer sipas vlerës së synuar për 2023.

**B.1.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.1.a** për vitin 2022 *është: **rritja** me 5% e numrit total të kallëzimeve për korrupsion (numri total i të çështje dh të pandehurve të dërguar në gjykatë) krahasuar me vitin paraardhës.*

Për vitet 2022 vlera e synuar ka qenë po e njëjta. Gjatë këtij viti janë dërguar 36 procedime në gjykatë, me 158 të pandehur, çka ka ndikuar që treguesi i performancës të jetë arritur në masën 100%.

Për periudhën *janar - qershor 2023*, është kryer vlerësimi i nevojave për trajnim dhe është hartuar programi i trajnimit. Drejtoria e Pergjithshme e Policisë së Shtetit ka miratuar programin e shkollimeve dhe trajnimeve të policisë shtetit për vitin 2023, përmes urdhërit Nr.378 datë 03.03.2023.

Policia e Shtetit ka kryer 6 trajnime me 86 përfitues nga të cilat 24 femra, konkretisht:

1.Mbi hetimin e avancuar të krimit financiar, i organizuar nga IPA EU4FOCAL në Hotel Internacional Tirana, me 10 përfitues, nga të cilet 4 femra.

2.Mbi Pastrimi i parave dhe rikuperimin e aseteve, i organizuar nga IPA EU4FOCAL në Hotel Internacional Tirana, me 4 përfitues nga të cilët 3 femra.

3.Mbi pastrimin e parave dhe rikuperimin e aseteve, i organizuar nga IPA EU4FOCAL Hotel Colosseu Shkodër, me 4 përfitues nga të cilet 3 femra.

4.Mbi hetimin e veprave penale të Kondrabandës, evazionit fiskal, mashtrimit në kredi dhe përcaktimi i rezultateve ne garat sportive, organizuar nga Akademia e Sigurise me 23 përfitues nga të cilët 9 femra.

5.Për monedhën virtuale dhe format e reja të krimit, të kryera përmes internetit, organizuar nga ekspertë të EU4FOCAL, në Hotel Internacional Tirana, me 5 përfitues nga të cilët 0 femra.

6.Për hetimet proaktive për veprat penale të korrupsionit, prokurimit publik, shkeljes së barazisë në tendera, ndikimit të paligjshëm të personave që ushtrojnë funksione publike, shperdorimi i detyrës dhe fshehja e pasurisë, organizuar nga Drejtoria e Krimit Ekonomik e Financiar me 40 përfitues nga të cilët 5 femra.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | Raste të dërguara në gjykatë: 813 Individët e akuzuar: 974 dhe 0,24 % e rasteve 0,62% e të akuzuarve |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | Rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar në gjykatë |
| | 2020 | Rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar në gjykatë (treguesi është arritur në masën 0%) |
| | 2021 | Rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar në gjykatë (treguesi është arritur në masën 0%) |
| | 2022 | Rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar në gjykatë |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar në gjykatë. |
| | **2023 (targeti i arritur)** | |

DRAFT

Për nëntreguesin *"B.1.a.1: Raporti i procedimeve për "korrupsion të nivelit të lartë" mbi numrin total të kallëzimeve për korrupsion"*, mungon raportimi nga SPAK.

**B.1.b**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.1.b** për vitin 2023 *është: **rritja** me 5% e numrit të kërkesave për sekuestrim për vepra penale të lidhura me korrupsionin, krahasuar me vitin paraardhës.*

Për vitin 2022 vlera e synuar ka qenë po e njëjta. Gjatë këtij viti nuk është realizuar rritje krahasuar me vitin paraardhës mbi numrin e kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit, çka ka rezultuar që treguesi i përformancës të vlerësohet me 0%.

Për periudhën *janar - qershor 2023*,

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | N/A |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | Sistemi i raportimit do të jetë funksional dhe të dhënat do të raportohen. Në vitin 2019 do të arrihet rritja e kërkesave për sekuestrim me 5 % krahasuar me vitin 2018; do të sigurohet raportim periodik gjatë viteve në vijim. |
| | 2020 | Rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit (treguesi është arritur në masën 0%) |
| | 2021 | Rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit (treguesi është arritur në masën 50%) |
| | 2022 | Rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit |
| | **2023 (targeti i synuar)** | Rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të kërkesave |

| | | |
|---|---|---|
| **Vlera e synuar/ Targeti** | | për sekuestrim në rastet e korrupsionit |
| | **2023 (targeti i arritur)** | |

**B.1.c**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.1.c** për vitin 2023 *është:* Është parashikuar fuqizimi dhe vijimi i përdorimit të mjeteve elektronike që mundësojnë transparencë në administratën shtetërore, në sistemet e drejtësisë, në menaxhimin e integruar të informacionit të pasurive në administrim; **5% rritje** krahasuar me vitin e mëparshëm.

Për vitin 2022, ka qenë e njëjta vlerë e synuar. Gjatë kësaj periudhe është ndërtuar, fuksionon dhe përditesohet regjistri elektronik për pasuritë e sekuestruara dhe te konfiskuara. Gjithashtu AAPSK ka marrë në administrim pasuri të sekuestruar për veprën penale të korrupsionit në vleren 4,268,350,439.5 lekë. Për këtë shkak treguesi i performancës është vlerësuar i realizuar në masën 100%.

Për periudhën *janar - qershor 2023*, janë referuar pranë organit të Prokurorisë në total 111 raste për 151 subjekte, nga të cilët ndaluar/arrestuar në kushtet e flagrancës 10 punonjës të strukturave dhe 3 shtetas, si dhe hetohen në gjendje të lirë 141 punonjës të strukturave mbikëqyrëse.

Sipas nivelit të drejtimit janë 151 punonjës e strukturave, të cilët ndahen në:

46 punonjës policie i nivelit të parë drejtues,

96 punonjës policie të nivelit zbatues,

5 punonjës civil (administrativ),

1 efektive të Gardës, § 3 PMNZSH dhe

27 shtetas.

Këto referime janë administruar dhe ndiqet ecuria e tyre, në Sistemin e Menaxhimit të Çështjes/Moduli i Hetimit Procedural Penal. Të grupuara sipas veprave penale, 111 referimet penale për 151 subjekte, klasifikohen:

39 referime ndaj 44 punonjës të strukturave dhe 9 shtetas për veprat penale të "shpërdorim detyre" & "korrupsioni pasiv",

- 26 referime ndaj 50 punonjës të strukturave dhe 12 shtetas për veprën penale "shpërdorim detyre" duke favorizuar "forma të ndryshme të paligjshmërive1",

DRAFT

- 15 referime ndaj 25 punonjësve të strukturave dhe 4 shtetas, për veprën penale të “kryerjes së veprimeve arbitrate”;

- 25 referime ndaj 26 punonjësve të strukturave dhe 2 shtetas, për veprat penale “dëmtime të tjera me dashje”, “dhunë në familje”, “goditje për shkak të detyrës”, etj,

- 6 referime ndaj 6 punonjësve të strukturave për veprën penale “drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt” dhe “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor;

Edhe për këtë 6-mujor të parë të vitit 2023, “abuzimi me detyrën” rezulton të jetë forma më klasike e paligjshmërive, qoftë si formë e vetme apo e gërshetuar me shkelje të tjera, që variojnë nga njëra strukturë vendore në tjetrën e nga lloji i strukturës dhe përgjëgjshmëria ligjore dhe funksionale që ato kanë.

Strukturat e Hetimit të Agjencisë në nivel vendor apo qëndror në kuadër të hetimeve proaktive të ndjekura, nën drejtimin e prokurorit, kanë zbatuar vendime të gjykatave për masat e sigurimit personal për 54 persona nga të cilët 46 subjekte të AMP-së dhe 8 shtetas. Sipas masave të sigurimit personal të caktuara, i ndajmë si vijon:

“arrest në burg” caktuar për 18 persona nga të cilët:

3 punonjës policie të nivelit të parë drejtues

11 punonjës policie të nivelit zbatues

1 punonjës civil (administrative)

1 punonjës i Gardes

2 shtetas

“arrest në shtëpi” caktuar për 6 persona nga të cilët:

2 punonjës policie i nivelit të parë drejtues

4 punonjës policie të nivelit zbatues

1 shtetas

“pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik” caktuar për 28 persona, nga të cilët:

1 punonjës policie i nivelit të mesëm drejtues

9 punonjës policie i nivelit të parë drejtues

14 punonjës policie te nivelit zbatues

1 punonjës civil

3 shtetas (punonjës të IKMT)

“detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” caktuar për 2 shtetas.

Në përfundim, vlerësohet se AAPSK nuk ka kryer vlerësim të nevojave për përmirësim të masave kundër korrupsionit gjatë kësaj periudhe raportuese.

AAPSK ka marrë në administrim pasuri të sekuestruar për veprën penale të korrupsionit në vlerën 32,034,000.00 lekë. Krahasimisht me vitin 2022, ku AAPSK mori në administrim pasuri të sekuestruar për veprën penale të korrupsionit në vlerën 4,268,350,439.5, vlerësohet se ky tregues performance nuk është arritur, pasi nuk është arritur objektivi me vlerë 5% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm.

Megjithatë, duke mbajtur në konsideratë progresin e deritanishëm dhe faktin se ky tregues performance matet në mënyrë tërësore në fund të vitit 2023, është vlerësuar se targeti është arritur në masën 10%.

Për këtë periudhë raportimi mungojn ët ëdhëna konkrete për treguesin. Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | N/A |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | Sistemi i raportimit do të jetë funksional dhe të dhënat do të raportohen si dhe do të vëzhgohen dhe analizohen të gjitha kontratat e mëparshme të pasurisë si dhe analiza e çdo lloj kontakti të pasurisë me personat e tretë; 5% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm. |
| | 2020 | Është parashikuar ngritja e grupit të punës për ndërtimin e akteve nënligjore në referencë të ligjit nr. 34 datë 17.06.2019; 5% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm (treguesi është arritur në masën 0%) |
| | 2021 | Është parashikuar të krijohet regjistri elektronik, për mbajtjen, formën, raportimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, si |

DRAFT

| | | |
|---|---|---|
| | | dhe përcaktimin e organeve publike apo subjekteve që kanë të drejtë në qasjen e informacionit të tij; 5% rritje e asteteve te sekuestruara krahasuar me vitin e mëparshëm. (treguesi është arritur në masën 100%) |
| | 2022 | Është parashikuar të krijohet regjistri elektronik, për mbajtjen, formën, raportimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, si dhe përcaktimin e organeve publike apo subjekteve që kanë të drejtë në qasjen e informacionit të tij; 5% rritje e asteteve te sekuestruara krahasuar me vitin e mëparshëm. |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Vlerësim i nevojave për përmirësim të masave kundër korrupsionit; 5% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **10%** |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje dy-vjeçare.

### Niveli i realizimit të objektivit B.1

Niveli i realizimit të *Objektivit B.1. Përmirësimi i efiçencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit*, në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - qershor 2023 **është _%.**

Përllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{NR B.1} = \frac{\text{TP B.1.a (\%)} + \text{TP B.1.b (\%)} + \text{TP B.1.c (10\%)}}{\text{3 TP}} \times 100\% = \%$$

Shkalla e realizimit të objektivit B.1 për këtë periudhë raportimi është **_.**

### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Prokuroria e Përgjithshme, SPAK dhe AAPSK për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit dhe pasaportës së indikatorëve për 6M1 2023.

### Risqet për realizimin e Objektivit B.1

Risku i realizimit të këtij objektivi është i lartë për shkak të rreziqeve të lidhura me mjedisin e jashtëm dhe paparashikueshërinë mbi vlerat e pasurive të sekuestruara mbi bazën e vendimeve të organeve të zbatimit të ligjit. Pra ka mundësi të lartë risku dhe ndikim të mesëm të tij.

## *B.2 Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit.*

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

*B.2.a: Raporti i procedurave të regjistruara mbi korrupsionin nga referimet e administruara*

*B.2.b: Numri i aksesit në bazat e të dhënave shtesë për policinë dhe prokurorinë*

Plani i veprimit për Objektivin B.2 parashikon 15 Aktivitete dhe 8 Masa.

### B.2.a

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.2.a** për vitin 2023 *është **rritja** me 3% e raportit të numrit të procedimeve të regjistruara për korrupsion përkundrejt numrit total të referimeve të regjistruara në krahasuar me vitin paraardhës.*

Për vitin 2022 vlera e synuar ka qenë po e njëjta. Gjatë këtij viti SPAK ka regjistruar gjithësej 131 proçedime penale me 76 persona nën hetim, për veprat penale që lidhen me korrupsionin, ndërsa Prkuroria e Përgjithshme ka regjistruar 262 procedime me 201 të pandehur. Megjithatë treguesi i performancës ka qenë 0%, pasi për të përllogaritur vlerën e plotë, kërkohej edhe vlera e kallëzimeve penale të ardhura në total nga të dyja prokuroritë, në mënyrëqë të llogaritej raporti me kallëzimet penale të regjistruara.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (14) dhe masat (7) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| B. 2.1 | Nënshkrimi i marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit/rishikimi i marrëveshjeve ekzistuese ndërmjet institucioneve ligjzbatuese dhe institucioneve të ngarkuara në luftën kundër korrupsionit |
| B.2.1.1 | Numri i marrëveshjeve të nënshkruara/ rishikuara (masë e raportueshme në TM IV të çdo viti) |
| B. 2.2 | Rritja e aksesit të mëtejshëm në bazat e të dhënave dhe në regjistrat elektronik shtetëror për kryerjen e hetimeve, nëpërmjet ndërlidhjes së sistemeve |
| B. 2.2.1 | Numri i databazave të aksesuara |
| B. 2.3 | Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional të punës ndërmjet PSH dhe agjencive të tjera ligjzbatuese (dogana, tatime, policia ushtarake, etj) me fokus hetimin e korrupsionit |
| B.2.3.1 | Ngritja e grupeve te përbashkëta të punës |
| B.2.3.2 | Hartimi i plani punës/plani veprimi me fokus hetimin e korrupsionit |
| B.2.3.3 | Udhëzime dhe procedura standarde të përbashkëta ndërmjet PSH dhe agjencive të tjera ligjzbatuese |
| B.2.3.4 | Adresimi i mbivendosjeve dhe / ose boshllëqeve në mandatet institucionale, hetimet e dyfishta ose të njëkohshëm, etj |
| B. 2.4 | Hartimi i procedurave standarde dhe mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet PSH dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe SPAK me fokus hetimin e korrupsionit |
| B.2.4.1 | Ngritja e grupit të punës |
| B.2.4.2 | Hartimi i draftit të procedurave të bashkëpunimit dhe miratimi i tyre |
| B. 2.5 | Forcim bashkëpunimi ndërmjet PSH dhe agjencive të tjera ligjzbatuese me fokus hetimin e korrupsionit, nëpërmjet takimeve të punës |
| B.2.5.1 | Hartimi i një kalendari takimesh pune dhe takime të kryera |
| B. 2.6 | Organizimi i seminareve/ëorkshope të përbashkëta ndërmjet PSH dhe agjencive të tjera ligjzbatuese |
| B.2.6.1 | Analiza shkencore (I) Informacioni dhe përpunimi i të dhënave (II) Tematika specifike te trajtuara (III) Kurrikula/materialet e trajnimit të hartuara |

Realizimi i masave është parashikuar të arrihet përmes aktiviteteve që janë kryer gjatë vitit 2023.

Për *janar-qershor 2023*,

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | |
|---|---|
| | N/A |
| | N/A |

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | 2017 | N/A |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | 64% |
| | 2020 | Rritje me 3 %<br>(treguesi është arritur në masën 100%) |
| | 2021 | Rritje me 3 %<br>(treguesi është arritur në masën 0%) |
| | 2022 | Rritje me 3 % |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Rritje me 3 % |
| | **2023 (targeti i arritur)** | |

**B.2.b**

Vlera e synuar për treguesin e performancës B.2.b për vitin 2023 *është: realizimi i aksesit nga Policia e Shtetit në 22 baza të dhënash shtesë dhe realizimi i aksesit nga Prokuroria në 11 baza të dhënash shtesë.*

Për vitin 2022 vlera e synuar ka qenë realizimi i aksesit nga Policia e Shtetit në 20 baza të dhënash shtesë dhe realizimi i aksesit nga Prokuroria në 9 baza të dhënash shtesë. Fakti që Policia e Shtetit kishte marrë akses në 21 databaza të dhënash, rezultoi që treguesi i performancës u realizua në masën 100%.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktiviteti (1) dhe masa (1) si më poshtë:

| | |
|---|---|
| B. 2.2 | Rritja e aksesit të mëtejshëm në bazat e të dhënave dhe në regjistrat elektronik shtetëror për kryerjen e hetimeve, nëpërmjet ndërlidhjes së sistemeve |
| B.2.2.1 | Numri i databazave të aksesuara |

Realizimi i masave është parashikuar të arrihet përmes aktiviteteve që kryhen duke filluar që duke filluar që nga fillimi i vitit 2023 e në vijim.

Për *janar - qershor 2023*,

Në përfundim, sillet në vëmendje se targeti për vitin 2023 është 22 baza të dhënash për Policinë. Megjithëse Policia e Shtetit nuk ka marrë akses në baza të dhënash shtetërore të reja përgjatë

kësaj periudhe 6 mujore, fakti që aktualisht ka akses në 21 baza të dhënash, nga 22 që është targeti për vitin 2023, është vlerësuar se treguesi është realizuar në masën 50%.

Për këtë periudhë monitorimi, informacioni i marrë lejon të kryhet vlerësimi i mundshëm për të bërë një matje të treguesit. Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | Policia ka akses në 10 baza të Dhënash. Prokuroria ka akses në 8 baza të dhënash. |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | Policia ka akses në 14 baza të dhënash; akses në 3 databaza për prokurorinë |
| | 2020 | Policia ka akses në 16 baza të dhënash; akses në 5 databaza për prokurorinë (treguesi është arritur në masën 0%) |
| | 2021 | Policia ka akses në 18 baza të dhënash; akses në 7 databaza për prokurorinë (treguesi është arritur në masën 100%) |
| | 2022 | Policia ka akses në 20 baza të dhënash; akses në 9 databaza për prokurorinë |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Policia ka akses në 22 baza të dhënash; akses në 11 databaza për prokurorinë |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **50%** |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

### Niveli i realizimit të objektivit B.2

Niveli i realizimit të *Objektivit B.2. Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - qershor 2023 **është _%.**

Përllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:



DRAFT

$$\text{NR B.2} = \frac{\text{TP B.2.a (\%)} + \text{TP B.2.b (50\%)}}{\text{2 TP}} \text{ x } 100\% \ = \%$$

Shkalla e realizimit të objektivit B.2 për këtë periudhë raportimi është në masën _.

**Verifikueshmëria e të dhënave**

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Policia e Shtetit dhe Prokuroria e Përgjithshme për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit dhe pasaportës së indikatorëve për 6M1 2023.

**Risqet për realizimin e Objektivit B.2**

Risku i realizimit të këtij objektivi është i lartë për shkak të rreziqeve të lidhura me mjedisin e jashtëm që lidhen me bashkëpunimin institucional me organet ligjzbatuese. Pra ka mundësi të lartë risku dhe ndikim të mesëm të tij.

### *B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar*

Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:

*B.3.a: Numri i raporteve të rishikimit të hartuara në mënyrë periodike dhe të bëra publike nga Ministria e Drejtësisë mbi përshtatshmërinë e kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare*

*B.3.b: Zbatimi i legjislacionit për ngritjen e një Zyre të Rikuperimit të Aseteve/Pasurive (ZRA)*

Plani i veprimit për Objektivin B.3 parashikon 4 Aktivitete dhe 4 Masa.

**B.3.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.3.a** për vitin 2023 *është: Hartimi i një raport rishikimi i publikuar dhe i dorëzuar tek politikëbërësit.*

*Për vitin 2022*, targeti ka qenë i njëjtë. Gjatë këtij viti është pregatitur një raport rishikimi mbi ZRA i cili është dorëzuar tek politikëbërësi. Për këtë shkak, treguesi i performancës është konsideruar i realizuar në masën 100%.

Ky tregues synon vlerësimin konstant të akteve ligjore e nënligjore në këtë fushë dhe konsolidimin e praktikave dhe kapaciteteve.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (1) dhe masat (1) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| B. 3.1 | Raport mbi vlerësimin e kuadrit ligjor dhe rekomandimet institucionale për ngritjen e ZRA |
| B.3.1.1 | Grup pune për raportin e vlerësimit (faza I) Institucionet (pjesë e grupit të punës) fillojnë procesin e vlerësimit dhe shqyrtimit (faza II) Hartimi i kalendarit të punës (faza III) Draft/dokument vlerësimi dhe rekomandime të dhëna (faza IV) Dokument final mbi rishikimin e kuadrit ligjor të fushës, për ngritjen e ZRA (faza V) |

Gjatë periudhës *janar-qershor 2023*, nuk ka patur zhvillime të reja mbi Zyrën Shqiptare të Rikuperimit të Aseteve. Procesi i koordinimit të punës nga sekretariati teknik pranë Ministrinë e Drejtësisë, për ngritjen dhe funksionimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve është kryer gjatë vitit 2022[42], kohë në të cilën është pregatitur një raport rishikimi i cili është dorëzuar tek politikëbërësi. Për këtë shkak ky tregues performance është konsideruar i parealizuar në këtë periudhë raportuese.

Grupi është në proces finalizimi të vendimmarrjes dhe me miratimin e tij formal, hapi i rradhës është që ZRA do të bëhet funksionale si dhe do hartohen dhe miratohen procedurat e brendshme.

Pregatitja e raportit të rishikimit do të përbëjë një arritje për të vlerësuar përshtatshmërinë e kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare. Ky hap do të ketë gjithashtu ndikim në drejtim të vlerësimit si veprim ligjor dhe identifikimit të çështjeve që mund të nevojiten përmirësime. Megjithatë, vendimarrja është e papërfunduar mbi raportin e rishikimit, pasi pavarësisht dorëzimit të raportit tek politikëbërësi, vendimi për të marrë masat e duhura nuk është finalizuar. Raporti rishikues është i rëndësishëm, pasi duhet të përdoret për të ndërmarrë hapa konkretë në bazë të rekomandimeve të tij.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | N/A |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | Një raport rishikimi i publikuar dhe i dorëzuar te politikëbërësit |
| | 2020 | Një raport rishikimi i publikuar dhe i dorëzuar te politikëbërësit (treguesi është arritur në masën 0%) |

[42] Për referencë, ndiq të dhënat e objektivit B.3.a në raportin e monitorimit të vitit 2022: https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2023/04/Raporti-i-monitorimit-SNKK_Janar-Dhjetor-2022_AL.pdf

DRAFT

| | | |
|---|---|---|
| | 2021 | Një raport rishikimi i publikuar dhe i dorëzuar te politikëbërësit (treguesi është arritur në masën 50%) |
| | 2022 | Një raport rishikimi i publikuar dhe i dorëzuar te politikëbërësit |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Një raport rishikimi i publikuar dhe i dorëzuar te politikëbërësit |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **0 %** |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

**B.3.b**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.3.b** për vitin 2023 vlera e synuar është caktimi i prokurorëve të specializuar të kushtuar vetëm gjurmimit dhe rikuperimit të pasurive.

Për vitin 2022 vlera e synuar ishte bërja funksionale e ZRA dhe njoftimi i Komisionit të BE për ngritjen e ZRA. Duke qenë se ZRA ishte ende në process finalizimi të vendimmarrjes, treguesi i performancës është konsideruar i pazbatuar 0%.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masat (3) si më poshtë.

| B. 3.3 | Miratimi, ngritja dhe vënie në funksion e ZRA |
|---|---|
| B.3.3.1 | ZRA është funksional dhe bërë publik (I) Hartimi dhe miratimi i procedurave të brendshme (rregullore) (II) Burime njerëzore në detyrë (III) |

Gjatë periudhës *janar-qershor 2023*, nuk është realizuar ende e gjithë korniza ligjore për ngritjen e ZRA dhe të jetë përpiluar e publikuar lista e veprave penale për të cilat është i mundur konfiskimi. Gjithashtu, duke qenë se nuk janë caktuar ende prokurorë të specializuar të kushtuar vetëm gjurmimit dhe rikuperimit të pasurive, ky tregues performance është konsideruar i pazbatuar 0%.

Vendimet e politikëbërësit në lidhje me raportin rishikues dhe masat për përmirësimin e kuadrit ligjor kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në realizimin e treguesit. Poashtu, mosrealizimi i plotësimit të kornizës ligjore për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve dhe caktimi i prokurorëve të specializuar për gjurmimin dhe rikuperimin e pasurive ka qenë një pengesë në realizimin e treguesit. Mungesa e kornizës ligjore të nevojshme dhe caktimi i profesionistëve të specializuar, ka rezultuar në

mangësi të kapaciteteve për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare, duke vështirësuar realizimin e objektivit të përmirësimit të kuadrit ligjor.

Vendimet politike, implementimi i legjislacionit dhe përgjegjësia e institucioneve për të ndërmarrë veprime efektive janë faktorë kyç që ndikojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara dhe realizimin e treguesve të performancës.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | N/A |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | Përzgjedhja einstitucionit ku do të ngrihet ZRPja (me vendim qeverie). Zhvillimi i 22 SoP-ve bazë. |
| | 2020 | Baza ligjore për ngritjen e ZRA i identifikuar dhe mbështetës (treguesi është arritur në masën 0%) |
| | 2021 | Korniza ligjore për ngritjen e ZRA i realizuar/Eshtë përpiluar dhe publikuar lista e duhur e veprave penale për të cilat është i mundur konfiskimi. (treguesi është arritur në masën 0%) |
| | 2022 | ZRP-ja është funksionale. Njoftimi i Komisionit të BEsë për ngritjen e ZRP-së |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Prokurorët e specializuar i janë kushtuar vetëm gjurmimit të pasurive dhe rikuperimit. |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **0%** |

Ky tregues është i lidhur pjesërisht me treguesin B.3.a sa i takon realizimit të një vlerësimi të kuadrit ligjor dhe identifikimit të strukturës institucionale për ngritjen e ZRA.

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

DRAFT

*Niveli i realizimit të objektivit B.3*

Niveli i realizimit të *Objektivit B.3. Përmirësimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-qershor 2023 është 0%.

Përllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{NR B.3} = \frac{\text{TP B.3.a (0\%)} + \text{TP B.3.b (0\%)}}{\text{2 TP}} \text{ x } 100\% = 0\%$$

**Verifikueshmëria e të dhënave**

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Ministria e Drejtësisë.

**Risqet për realizimin e Objektivit B.3**

Risku i realizimit të këtij objektivi është i mesëm për shkak proceseve fundore të realizimit të vendimarrjes.

***B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit***

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

*B.4.a: Numri i informacioneve të Policisë i shkëmbyer me vendet e treta dhe institucionet mbi-kombëtare mbikëqyrëse të zbatimit të ligjit.*

*B.4.b: Numri i operacioneve të përbashkëta të Policisë të nisura nga Europol ose Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik ku Shqipëria merr pjesë aktivisht.*

Plani i veprimit për Objektivin B.4 parashikon 5 Aktivitete dhe 4 Masa.

**B.4.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.4.a** për vitin 2023 *është: **rritja me 5%** e numrit total të informacionit të shkëmbyer me vendet e treta dhe institucione ndërkombëtare, krahasuar me vitin e mëparshëm.*

Për vitin 2022 vlera e synuar ka qenë *po rritja me 5% e numrit total të informacionit të shkëmbyer me vendet e treta dhe institucione ndërkombëtare, krahasuar me vitin e mëparshëm.* Gjatë këtij

viti janë shkëmbyer 405 praktika me Interpolin; 2740 korrespodenca me Europolin; dhe 77 praktika me rrjetin CARIN, çka ka rezultuar që ky tregues performance të konsiderohet i realizuar në masën 100%.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (1) dhe masat (1) si më poshtë.

| B. 4.1 | Forcim bashkëpunimi policor kombëtar dhe ndërkombëtar |
|---|---|
| B.4.1.1 | Shkëmbimi i informacionit si edhe hetime të koordinuara e të përbashkëta mes agjencive |
| B.4.1.2 | Konferenca të përbashkëta me agjencitë homologe për shkëmbim eksperience në hetimet e përbashkëta. |

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të numrit të autoriteteve publike të monitoruara çdo 3 mujor.

Për *janar - qershor 2023*, nga Drejtoria për Krimit Ekonomik Financiar në Policinë e Shtetit, është shkëmbyer informacion me partnerët ndërkombëtarë një total prej 443 praktikash, nga te cilat:

-266 praktika me Interpolin.

-79 praktika me Europolin.

-88 praktika me Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Gjithashtu janë kryer 6 trajnime me 86 përfitues nga të cilat 24 femra:

1.Mbi hetimin e avancuar të krimit financiar, i organizuar nga IPA EU4FOCAL në Hotel Internacional Tirana, me 10 përfitues, nga të cilet 4 femra.

2.Mbi Pastrimi i parave dhe rikuperimin e aseteve, i organizuar nga IPA EU4FOCAL në Hotel Internacional Tirana, me 4 përfitues nga të cilët 3 femra.

3.Mbi pastrimin e parave dhe rikuperimin e aseteve, i organizuar nga IPA EU4FOCAL Hotel Colosseu Shkodër, me 4 përfitues nga të cilet 3 femra.

4.Mbi hetimin e veprave penale të Kondrabandës, evazionit fiskal, mashtrimit në kredi dhe përcaktimi i rezultateve ne garat sportive, organizuar nga Akademia e Sigurise me 23 përfitues nga të cilët 9 femra.

5.Për monedhën virtuale dhe format e reja të krimit, të kryera përmes internetit, organizuar nga ekspertë të EU4FOCAL, në Hotel Internacional Tirana, me 5 përfitues nga të cilët 0 femra.

6.Për hetimet proaktive për veprat penale të korrupsionit, prokurimit publik, shkeljes së barazisë në tendera, ndikimit të paligjshëm të personave që ushtrojnë funksione publike, shperdorimi i detyrës dhe fshehja e pasurisë, organizuar nga Drejtoria e Krimit Ekonomik e Financiar me 40 përfitues nga të cilët 5 femra.

Nuk ka patur zhvillime të reja për këtë periudhë raportimi, sa i takon konferencave të përbashkëta me agjencitë homologe për shkëmbim eksperience në hetimet e përbashkëta.

Megjithëse ky tregues performance matet mbi bazë vjetore, për këtë periudhë monitorimi është vlerësuar arritja 50%, meqënëse po vijon puna me shkëmbimin e praktivave me partnerët ndërkombëtarë, por nuk ka ende 5% rritje me vitin 2022.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | 103 |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | Përditësimi i procesit të monitorimit të brendshëm për të marrë të dhëna të detajuara të grumbulluara dhe të zbërthyera. Publikimi i të dhënave; Rritja prej 5% në raport me vitin 2018 |
| | 2020 | Rritje prej 5% në raport me vitin 2019 (treguesi është arritur në masën 0%) |
| | 2021 | Rritje prej 5% në raport me vitin 2019 (treguesi është arritur në masën 100%) |
| | 2022 | Rritje prej 5% në raport me vitin 2021 |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Rritje prej 5% në raport me vitin 2021 |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **50%** |

**B.4.b**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës B.4.b** për vitin 2023 *është: trend rritës në kryerjen **operacioneve të përbashkëta të Policisë,** të nisura nga Europol ose Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik, ku Shqipëria merr pjesë aktivisht.*

Për vitin 2022 vlera e synuar ka qenë *trend rritës krahasuar me vitin e mëparshëm.* Në këtë vit u zhvilluan 3 operacione të përbashkëta të PSH të nisura nga ndërkombëtarët në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik, por duke qenë se pati një trend rritës krahasimisht me vitin paraardhës, treguesi i performancës u konsiderua i zbatuar 100%.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (1) dhe masat (1) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| B. 4.2 | Kryerja e trajnimeve të përbashkëta dhe rritja e bashkëpunimit me institucionet homologe ndërkombëtare si EUROPOL, CEPOL, INTERPOL, CARIN, BAMIN, UNDC, OSBE |
| B.4.2.1 | Trajnime të kryera me kolegë të agjencive homologe (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj). |
| B. 4.3 | Ngritja e skuadrave të përbashkëta hetimore për hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit |
| B.4.3.1 | Nr. i skuadrave të ngritura |
| B. 4.4 | Forcimi i kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve dhe konferencave të përbashkëta me institucionet homologe ndërkombëtare |
| B.4.4.1 | Nr. i aktiviteteve trajnuese dhe nr. i takimeve e kryera dhe nr. i pjesëmarrësve; (sa të trajnuar femra dhe sa meshkuj) |

Realizimi i masës së parashikuar kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të numrit të autoriteteve publike të monitoruara çdo 3 mujor.

Për *janar - qershor 2023*, janë zhvilluar kryer trajnimet me temë:

1.Mbi hetimin e avancuar të krimit financiar, i organizuar nga IPA EU4FOCAL në Hotel Internacional Tirana, me 10 përfitues, nga të cilet 4 femra.

2.Mbi Pastrimi i parave dhe rikuperimin e aseteve, i organizuar nga IPA EU4FOCAL në Hotel Internacional Tirana, me 4 përfitues nga të cilët 3 femra.

3.Mbi pastrimin e parave dhe rikuperimin e aseteve, i organizuar nga IPA EU4FOCAL Hotel Colosseu Shkodër, me 4 përfitues nga të cilet 3 femra.

4.Mbi hetimin e veprave penale të Kondrabandës, evazionit fiskal, mashtrimit në kredi dhe përcaktimi i rezultateve ne garat sportive, organizuar nga Akademia e Sigurise me 23 përfitues nga të cilët 9 femra.

5.Për monedhën virtuale dhe format e reja të krimit, të kryera përmes internetit, organizuar nga ekspertë të EU4FOCAL, në Hotel Internacional Tirana, me 5 përfitues nga të cilët 0 femra.

6.Për hetimet proaktive për veprat penale të korrupsionit, prokurimit publik, shkeljes së barazisë në tendera, ndikimit të paligjshëm të personave që ushtrojnë funksione publike, shperdorimi i detyrës  dhe fshehja e pasurisë, organizuar nga Drejtoria e Krimit Ekonomik e Financiar me 40 përfitues nga të cilët 5 femra.

Gjithësej janë kryer 6 trajnime me 86 përfitues nga të cilat 24 femra.

Duke qenë se gjatë kësaj periudhe monitoruese nuk janë kryer ende operacione të përbashkëta të Policisë të nisura nga Europol ose Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik, ky tregues performance është konsideruar i pazbatuar.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | 2 |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | 4 |
| | 2020 | 5 (treguesi është arritur në masën 60%) |
| | 2021 | Trend rritës (0%) |
| | 2022 | Trend rritës |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Trend rritës |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **0%** |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

### Niveli i realizimit të objektivit B.4

Niveli i realizimit të *Objektivit B.4 Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-qershor 2023 **është 25%.**

Përllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{NR B.4} = \frac{\text{TP B.4.a (50\%)} + \text{TP B.4.b (0\%)}}{\text{2 TP}} \text{ x } 100\% = 25\%$$

DRAFT

Shkalla e realizimit të objektivit B.4 për këtë periudhë raportimi është **dobët** (0 në 30 për qind e masave të realizuara)

### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Policia e Shtetit për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit 6M 1 2023.

### Risqet për realizimin e Objektivit B.4

Risku i realizimit të këtij objektivi është i ulët për shkak të proceseve të ngjashme që kryhen në përgjatë ecurisë së çdo viti.

***Realizueshmëria e objektivave specifike të qëllimit strategjik për ndëshkimin e korrupsionit (Qasja B)***

Mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe përpunimin e të dhënave të treguesve të performancës tabela më poshtë paraqet shkallën e realizimit të 4 objektivave specifike të qëllimit strategjik për ndëshkimin e korrupsionit.

Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave - duke mbledhur realizueshmërinë në përqindjes të treguesve të performancës dhe pjestuar me numrin e treguesve – realizueshmëria e qëllimit strategjik për ndëshkimin e korrupsionit është _%.

| Objektivi | Realizueshmëria |
|---|---|
| B.1. Përmirësimi i efiçencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit | |
| B.2. Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit | |
| B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar | 0% |
| B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit. | 25% |

Realizueshmëria e qëllimit strategjik për ndëshkimin e vlerësohet në masën _%, përgjatë periudhës janar - qershor 2023. Në përgjithësi, bazuar në të dhënat e dhëna, vlerësohet se realizueshmëria e qëllimit strategjik për ndëshkimin e korrupsionit, përfshirë të gjitha objektivat e saj, është në një shkallë të mesme. Është e rëndësishme të vazhdojë puna në përmirësimin e efiçencës së hetimeve penale, bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese dhe kuadrit ligjor për të arritur rezultate

më të mira në luftën kundër korrupsionit. Po ashtu, është thelbësore të rritet pjesëmarrja dhe bashkëpunimi ndërkombëtar për të adresuar korrupsionin në nivel kombëtar. Gjatë kësaj periudhe ka pasur përpjekje për të përmirësuar bashkëpunimin ndërkombëtar, por ajo ende nuk është e plotë dhe ka nevojë për zhvillime të tjera.

***Qasja Ndërgjegjësuese - Përmbledhje për arritjet në ndërgjegjësimin mbi korrupsionin***

Përmes **qëllimit të politikës (qasjes) ndërgjegjësuese SNKK** synon të rrisë pjesëmarrjen e publikut në luftën kundër korrupsionit duke e denoncuar atë dhe duke qenë aktiv në iniciativat e parandalimit të korrupsionit, edukimin e publikut dhe ndërmarrjen e aktiviteteve me efekt ndërgjegjësimi.
Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë.

| Qasja (Qëllimet e Politikës) | Masat dhe Aktivitetet | Realizimi i Masave dhe aktiviteteve | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Masa dhe aktivitete të parashikuara për periudhën janar - qershor 2023 | Masa dhe aktivitete **plotësisht** të realizuara | Masa dhe aktiviteteve **pjesërisht** të realizuara[43] | Masa dhe aktivitete të **parealizuara**[44] |
| Ndërgjegjësuese | Masa | 6 | 6 | 1 | 1 |
| | Aktivitete | 10 | 10 | 1 | 6 |

GRAFIK

Rezulton se nga 6 masa e 10 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit 2020 – 2023, për janar-qershor 2023, për Qasjen C (Ndërgjegjësuese), janë zbatuar 6 masa/10 aktivitete, 1 masë/1 aktivitet janë ende në proces zbatimi dhe 1 masë/6 aktivitete janë të pazbatuara përkatësisht (masa C.3.1 dhe aktivitete C.3.1.1; C.3.1.2; C.3.1.3, C.3.1.4; C.3.1.5 dhe C.3.1.6).

Nga 7 treguesit e performances për qasjen parandaluese (C), është arritur vlera e synuar për 1 tregues performance, është arritur pjesërisht vlera e synuar për 2 tregues performance si edhe nuk është arritur vlera e synuar për 4 tregues performance.

[43] Aktivitet "pjesërisht i realizuar" është ai aktivitet që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.
[44] Aktivitet "i parealizuar" është ai i cili është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind

| Qasja Ndërgjegjësuese | Treguesit e performancës | Realizimi i Treguesve të Performancës | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Vlera e synuar është realizuar plotësisht[45] | Vlera e synuar është realizuar pjesërisht[46] | Vlera e synuar nuk është e realizuar[47] |
| | 7 | 1 | 3 | 3 |

GRAFIK

DRAFT

### *C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit*

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

*C.1.a: Krijimi i planeve vjetore të komunikimit dhe vizibilitetit të Strategjisë Kundër Korrupsionit.*

*C.1.b: Numri i fushatave vjetore të ndërgjegjësimit për luftën kundër korrupsionit.*

**C.1.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës C.1.a** për vitin 2023 është *miratimi dhe zbatimi i Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimit.*

Për vitin 2022, objektivi ishte *realizimi i vlerësimit dhe rishikimit të Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimit*. Duke qenë se është vlerësuar dhe rishikuar Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2022, dhe i publikuar poashtu në faqen e Ministrisë së Drejtësisë, objektivi është konsideruar i realizuar në masën 100%.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (2) dhe masat (2) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| C.1.1 | Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit në zbatim të SNKK/vjetor, i hartuar |
| C.1.1.1 | Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2020 i hartuar nga grupi i punës/miratuar nga MD |
| C.1.1.2 | Plane vjetore Vizibiliteti dhe Komunikimi të rishikuara dhe miratuara (2021/2022/2023) |
| C.1.4 | Transparence e shtuar në bërjen publike të raporteve të monitorimit të SNKK dhe zbatimit të planit të veprimit AK dhe dokumenteve të tjera shoqëruese të tij |

| | |
|---|---|
| C.1.4.1 | Raporte periodike monitorimi të Planit të Veprimit/të Pasaportës së Treguesve (publikim i tyre) (raporte 3M/6M/vjetore) |
| C.1.4.2 | Publikim/shpërndarje e e-buletine të dokumenteve të AK (raporte; monitorime etj.) në target grupe studentë/OSHC/forume biznesi |

Realizimi i masave të parashikuara kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit të zbatimit të planit të veprimit.

Gjatë *janar - qershor 2023*, Ministria e Drejtësisë ka hartuar disa aktivitete ndërgjegjësuese e informuese specifike.

Ministria e Drejtësisë ka zhvilluar fushatën e parë publike për vitin 2023. Në rrjetet e komunikimit të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion, janë shfaqur një seri me 15 video udhëzuese dhe ndërgjegjësuese për të nxitur qytetarët duke denoncuar praktikat dhe abuzimet në institucionet publike, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve antikorrupsion. Këto video informuese, synojnë të promovojnë mekanizmin e raportimit të rasteve të dyshuara të korrupsionit, pranë koordinatorëve kundër korrupsionit.

Në datën 12 maj, 2023 u zhvillua një intervistë televizive në stacionin SCAN TV me Drejtorin e Politikave Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë, ku u diskutua mbi çështjet e politikave antikorrupsion, masat dhe objektivat e administratës shqiptare, si dhe roli i tyre në procesin e integrimit evropian.

Intervista mund të aksesohet në: https://www.youtube.com/watch?v=w22uyHMdy0Q

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, ka rritur bashkëpunimin dhe interaktivitetin e saj me qytetarët nëpërmjet përdorimit të rrjeteve sociale. Tashmë aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, mund të ndiqet në profilet e Facebook, Twitter dhe LinkedIN, ku njoftohen në mënyrë të rregullt masat antikorrupsion, angazhimet dhe aktivitetet rregullatore, funksionale dhe bashkëpunuese.

https://www.facebook.com/profile.php?id=100089045846 23

https://twitter.com/DrejtoriaAK

https://www.linkedin.com/company/88693364/

Në përfundim, vlerësohet kryesisht se Ministria e Drejtësisë në rolin edhe të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit *ka rishikuar Planin vjetor të vizibilitetit dhe komunikimit në fushën antikorrupsion*. PK&V 2022 përmban në total 12 aktivitete për t'u zhvilluar përgjatë vitit 2023, me fokus luftën kundër korrupsionit. Përmbajtja e tij është gjithëpërfshirëse dhe e targetuar kundrejt grupeve të ndryshme të interesit. Dokumenti është publikuar në faqen web të Ministrisë së Drejtësisë në linkun https://www.drejtesia.gov.al/instumenta-viti-2023/. Për këtë shkak, ky tregues performance, vlerësohet i realizuar në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | N/A |
| | 2018 | Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2018 finalizohet në 3 Mujorin 2 të vitit |
| | 2019 | - Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2019 108 finalizohet dhe publikohet në 3 Mujorin 1 të vitit.<br>- Buxheti specifik i alokuar për zbatimin e Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimit |
| | 2020 | Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2020 finalizohet dhe publikohet në 3 Mujorin 1 të vitit.<br>- Janë zbatuar 50% e detyrave të ndërgjegjësimit dhe komunikimit të parashikuara në Planin e Vizibilitetit dhe Komunikimit 2019. (treguesi është arritur në masën 100%) |
| | 2021 | Zbatim i 100% i aktiviteteve të Parashikuara (treguesi është arritur në masën 100%) |
| | 2022 | Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit i vlerësuar dhe rishikuar |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit i vlerësuar dhe rishikuar |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **100%** |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.



DRAFT

**C.1.b**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës C.1.b** për vitin 2023 është: *Rishikimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese do të bëhet çdo vit/4 fushata në vit*, për 2023 vlera e synuar është po e njëjta.

Gjatë vitit 2022, objektivi i ishte po i njëjti. Duke qenë se MD kreu 3 aktivitete ndërgjegjësuese përgjatë vitit, ky tregues performance është vlerësuar në masën 100%.

Për të arritur vlerat e treguesit për vitet për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (10) dhe masat (2) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| C.1.2 | Instrumente ndërgjegjësuese dhe informuese kundër korrupsionit të zbatuara në vend |
| C.1.2.1 | Ideimi, hartimi dhe miratimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese e informuese specifike; (aktivitete me mesazhe të qarta/të përshtatshme për femra dhe meshkuj; numri i aktiviteteve që adresojnë pasojat specifike të korrupsionit) - përgjatë viteve 2020/2021/2022/2023 |
| C.1.2.2 | Java e Integritetit 2020 (3- 11 shkurt 2020) - tryeza, forume AK, aktivitete sportive etj. |
| C.1.2.3 | Tryezë për promovimin e planit të integritetit të MD , modeli i dokumentit për institucionet e qeverisjes qendrore në vend |
| C.1.3 | Mekanizma me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe të besimit të publikut në forcimin e luftës kundër korrupsionit |
| C.1.3.1 | Botime të publikuara në kuadër të ndërgjegjësimit qytetar në luftën kundër korrupsionit në Shqipëri: - Broshurë: SNKK (v.2020) - Broshurë: Hapat për të denoncuar korrupsionin në Shqipëri (v.2020) |
| C.1.3.2 | Takime duke angazhuar të rinjtë (auditoret universitare) dhe komunitetet parauniversitare për njohjen e pasojave që vijnë nga korrupsioni, në fusha si arsim/shëndetësi/tatimedogana/prona/gender, (v.2020/2021/2022/2023) |
| C.1.3.3 | Film Festival Antikorrupsion 2020 |
| C.1.3.4 | Organizimi e pjesëmarrja në evente mediatike mbi antikorrupsionin:/takime me gazetarët/konferenca/deklarata/e- KKK/MD TM II 2020 TM IV 2020 kosto administrative 15 buletine/njoftime etj. |
| C.1.3.5 | Seminar/workshop për antikorrupsionin me grupe të interesuara/identifikuara nga SNKK (v.2020/2021/2022/2023) |
| C.1.3.6 | Seminare për forcim kapacitetësh të vlerësimit të riskut të integritetit për stafin drejtorisë AK (kurikula AK) |
| C.1.3.7 | Dita Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit (9 dhjetor) - aktivitet ndërgjegjësues në MD, aktivitet që kryhet për çdo vit të zbatimit të PV |
| C.1.4 | Transparence e shtuar në bërjen publike të raporteve të monitorimit të SNKK dhe zbatimit të planit të veprimit AK dhe dokumentave të tjera shoqëruese të tij |

| | |
|---|---|
| C.1.4.1 | Raporte periodike monitorimi të Planit të Veprimit/ të Pasaportës së Indikatorëve (publikim i tyre) (raporte 3M/6M/vjetore) |
| C.1.4.2 | Publikim/shpërndarje e e-buletine të dokumenteve të AK (raporte; monitorime, etj) në target grupe studentë/OSHC/forume biznesi |

Realizimi i masave (2) të parashikuara kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të aktiviteteve dhe eventeve ndërgjegjësuese të kryera çdo 3 mujor.

Gjatë *janar – qershor 2023*, Ministria e Drejtësisë ka hartuar, dakordësuar në nivel teknik dhe miratuar raportin e monitorimit janar-dhjetor 2022 në takimin e GTA të datës 19 prill 2023. Raporti gjendet i aksesueshëm në linkun: https://drejtesia.gov.al/viti-2022-2/ Gjithashtu është hartuar dhe dakordësuar në nivel teknik, në takimin e datës (*në takimin e datës 20 qershor 2023*) raporti i monitorimit janar-mars 2023 i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015 - 2023. Draft raporti gjendet i aksesueshëm në linkun:https://www.drejtesia.gov.al/raporte-monitorimi-2023/

Ministria e Drejtësisë ka hartuar raportin e monitorimit të Planit të Integritetit për vitin 2022, i cili merr në vlerësim në total 16 masa, nga të cilat: 13 masa janë zbatuar plotësisht, 2 janë në proces zbatimi dhe 1 e pazbatuar. Ky Plan Integriteti për Ministrisë së Drejtësisë, është një instrument institucional i luftës kundër korrupsionit, i cili përbën një evidencë të rëndësishme që institucioni ofron më shumë llogaridhënie, transparencë, dhe veprimtari sipas ligjit dhe rregullave.

Po ashtu është publikuar buletini e muajit janar, shkurt, mars, prill, maj dhe qershor, të aksesueshëm në linkun: https://drejtesia.gov.al/e-buletin/

Samiti për Demokraci, si iniciativë e Presidentit të SHBA-ve, vijoi zhvillimin e mbledhjeve antikorrupsion (cohorti antikorrupsion), me zhvillimin e takimeve online të ekspertëve të vendeve të rajonit tonë, zhvillimin e konferencës rajonale të Evropës Jug-Lindore nën drejtimin e Bullgarisë, dhe për të kulmuar me aktivitetin ndërkombëtar në SHBA në 30-31 mars 2023. Në takimet teknike, vendi u përfaqësua nga zyrtarë të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe nga përfaqësues të ILDPKPI.

Në datën 29.05.2023, Ministri i Drejtësisë organizoi një tryezë diskutimi mbi masat antikorrupsion me përfaqësuesit e dhomave dhe shoqatave të biznesit. Tematika e takimit ishte bashkërendimi i masave për ndërhyrje dhe rritja e bashkëveprimit mes palëve sektori publik me atë privat.

Në datat 15 dhe 16 qershor 2023, u zhvillua Forumi për Dialog, Prespë 2023, me tematikë: “Mbi çrrënjosjen e korrupsionit përmes politikave të mirëqeverisjes dhe reformës në drejtësi”, në të cilin mori pjesë Ministri i Drejtësisë z.Ulsi Manja.

Në datën 24.04.2023, Ministri i Drejtësisë nënshkroi marrëveshjen e Zotimit të Transparencës (Transparency Pledge) me Koalicionin e Organizatave të Shoqërisë Civile pranë UNCAC duke garantuar më shumë transparencë, bashkëpunim dhe bashkë-bërje të politikave antikorrupsion. Ky

DRAFT

proces i paraprin edhe vlerësimit në kuadër të ciklit të dytë të vlerësimit të zbatimit të Konventës së OKB-së kundër Korrupsionit (UNCAC), që zhvillohet së shpejti.

Ministria e Drejtësisë mori pjesë në punimet e Samitit Ndërkombëtar të Drejtësisë për Luftën kundër Krimit Kibernetik - "Samiti i Evropës Jug-lindore i krimit kibernetik", në Sibenik, Kroaci, në datat 21-23 maj 2023. Në këtë takim u diskutan propozime për të gjetur masa dhe ndërhyrje të reja kundër fenomenit të krimeve kibernetike, si metoda dhe instrumente që rrezikojnë shërbimet dhe lidhen me krimin e korrupsionit, duke tejkaluar kufijtë e shteteve.

Në datën 13.06.2023, Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion mori pjesë në konferencën e organizuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes në kuadër të Koalicionit të vendeve të Europës Juglindore për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

Ministria e Drejtësisë është në fazën përfundimtare të zhvillimit të një sistemi elektronik për menaxhimin e denoncimeve mbi rekordet korruptive. Ky sistem do të ndërveprojë me platformën unike qeveritare e-Albania dhe do të mundësojë menaxhimin dhe përpunimin e të gjitha informacioneve të lidhura me denoncimet dhe rekordet korruptive, duke nisur nga denoncimet e qytetarëve dhe të bizneseve, deri në zgjidhjen përfundimtare të tyre.

Në datat 23 – 25 maj 2023, u zhvillua një takim mbi hartimin e një Udhëzuesi praktik veprimi procedurash, për oficerët e policisë gjyqësore dhe prokurorët. Ky dokument do të jetë një sintezë me udhëzime të detajuara, mbështetur në kuadrin ligjor, rregullator në fuqi dhe veprimet procedurale të praktikës. Procesi i hartimit të këtij udhëzuesi po koordinohet nga Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion në bashkëpunim me UNODC.

Në datat 18 – 19 maj 2023, një pjesë e stafit të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë, mori pjesë në një seminar ndërkombëtar të organizuar nga UNODC, në Kazakistan. Tema e seminarit ishte intensifikimi i hetimit të korrupsionit dhe forcimi i bashkëpunimit në projektet e investimeve ndërkombëtare.

Në datat 16 -17 maj 2023, u zhvillua një takim-trajnim rajonal në Podgoricë, Mal të Zi, organizuar nga Qendra e RACVIAC dhe organizata rajonale kundër korrupsionit – RAI, mbi konfliktin e interesave në Sektorin e Sigurisë, takim në të cilin mori pjesë një specialist nga Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion.

Në datën 16.06.2023, Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit dhe Agjencia Kombëtare Italiane kundër Korrupsionit – ANAC zhvilluan një takim, në të cilin diskutuan për tema me rëndësi, si: edukimi ligjor për mekanizmat antikorrupsion, shtrirja emjeteve të ndëshkimit administrativ, forcimi i kapaciteteve të profesionistëve të ligjit për hartimin e politikave eficente kundër korrupsionit, forcimi i kapaciteteve teknike dhe rritja e kualiteteve administrative.

Në 18 janar 2023, Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit dhe Shkolla e Magjistraturës lidhën marrëveshje bashkëpunimi për trajnimin e vazhdueshëm të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit. Përmes kësaj marrëveshjeje, të dy institucionet do të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre me qëllim formimin vazhdues të koordinatorëve antikorrupsion, për të përmirësuar dhe garantuar aftësitë

profesionale të tyre, në shqyrtimin e rasteve të korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës, si dhe kryerjen e hetimeve administrative brenda fushës së përgjegjësisë të institucionit.

Zyrtarë të nivelit të lartë të Ministrisë së Drejtësisë morën pjesë në seminarin rajonal të organizuar nga UNODC, për bashkëpunimin e agjencive antikorrupsion dhe autoriteteve të kontrollit të financave publike në rajonin e Ballkanit Perëndimor, të zhvilluar në datat 31.05 – 02.06.2023, në Vjenë, Austri.

Në datat 06 - 07.06.2023, Ministria e Drejtësisë mori pjesë në takimin e zhvilluar në Shkup, Maqedoni e Veriut, me fokus forcimin e rezistencës ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit të të rinjve në Evropën Juglindore, takim i organizuar nga Kryesia e OSBE-së në Maqedonisë së Veriut dhe Initiativa Globale Kundër Kriminalitetit Transnacional (GI-TOC).

Përgjatë datave 26- 30.06.2023, stafi i Ministrisë së Drejtësisë mori pjesë në Shkollën e Integritetit, të organizuar nga Transparency International, në Vilnus, Lituani,  me tematika të cilat lidhen me transparencën, integritetin publik, sjelljet korruptive, korrupsioni në sport dhe korrupsioni në sektorin e mbrojtjes.

Në përfundim, duke qenë se gjatë vitit 2023, është zhvilluar një fushatë publike, nga 4 të parashikuara, duke promovuar rrjetin e koordinatorëve antikorrupsion, si një mekanizëm  i luftës ndaj korrupsionit në përballjen e qytetarit me administratën publike, ky tregues performance, vlerësohet i arritur në masën **25%.** Në rrjetet e komunikimit të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion, Facebook, Twitter dhe LinkedIn, janë shfaqur një seri me 15 video udhëzuese dhe ndërgjegjësuese për të nxitur qytetarët duke denoncuar praktikat dhe abuzimet në institucionet publike, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve antikorrupsion.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | N/A |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | Përmirësimi i mostolerimit të korrupsionit nga institucionet publike |
| | 2020 | Rishikimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese do të bëhet çdo vit/4 fushata në vit (treguesi është arritur në masën 100%) |
| | 2021 | Rishikimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese do të bëhet çdo vit/4 fushata në vit (treguesi është arritur në masën 100%) |

DRAFT

| | | |
|---|---|---|
| | 2022 | Rishikimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese do të bëhet çdo vit/4 fushata në vit |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Rishikimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese do të bëhet çdo vit/4 fushata në vit |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **25%** |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

**Niveli i realizimit të Objektivit C.1**

Niveli i realizimit të Objektivit C.1 *Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-qershor 2023 **është 62.5%.**

Përllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{NR C.1} = \frac{\text{TP C1.a (100\%) + TP C.1.b (25\%)}}{\text{2 TP}} \text{ x } 100\% = 62.5\%$$

Nisur nga realizimi i masave të raportuara, shkalla e realizimit të objektivit C.1 për këtë periudhë raportimi **është mirë** (51- 85 për qind e masave të realizuara).

**Verifikueshmëria e të dhënave**

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit/ Ministria e Drejtësisë për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për 6M1 2023.

**Risqet për realizimin e Objektivit C.1**

Risku i realizimit të këtij objektivi është i ulët, ka mundësi të ulët të ndodhjes dhe ndikim të ulët të tij, pasi nuk paraqet risk evident.

DRAFT

***C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit***

Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:

*C.2.a:* Numri i denoncimeve të qytetarëve për korrupsion të denoncuara në platformën www.shqipëriaqeduam.al

*C.2.b:* Numri i rasteve të korrupsionit nga denoncimet e qytetarëve në ëëë.shqiperiaqeduam.al, të cilat i raportohen Policisë së Shtetit/Prokurorisë Shqiptare

Plani i Veprimit për Objektivin C.2 parashikon (4) Aktivitete dhe (3) Produkte/Masa.

**C.2.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës C.2.a** për vitin 2023 është: *rritje prej 40% në krahasim me vitin e mëparshëm.*

*Për vitin 2022 vlera e synuar ishte po rritje prej 40% në krahasim me vitin e mëparshëm.* Gjatë kësaj periudhe, pranë Drejtorisë së Pëgjithshme të Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë u administruan në total 1342 ankesa, nga të cilat:

- 1180 ankesa u administruan në rrugë shkresore;
- 111 ankesa u administruan në rrugë elektronike (email);
- 43 ankesa u deleguan nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB).

Për këtë arsye ky tregues performance u vlerësua i zbatuar në masën 100%.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masat (2) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| C.2.1 | Raportimi periodik i ADB mbi denoncimet e dorëzuara në portal |
| C.2.1.1 | Raporti i prodhuar dhe i publikuar |
| C. 2.2 | Dorëzimi i kërkesave mujore për institucionet e linjës për mbledhjen e numrit të qytetarëve të denoncimeve për korrupsion në portalin të cilat janë raportuar në Policinë e Shtetit/Prokurori |
| C.2.2.1 | Raporti periodik i prodhuar dhe i publikuar |
| C.2.2.2 | Nr. i rasteve të referuara PSH/Prokurori; (rastet e referuara të ndara mbi bazë gjinie) |



DRAFT

Realizimi i masës të parashikuar kryhet përmes masave (2) dhe aktiviteteve të parashikuara që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të hartimit dhe publikimit të raportit vjetor në 3 mujorin e katërt të vitit.

Për periudhën Janar – Qershor 2023, rezultojnë të dhënat si më poshtë:

ADB ka hartuar raporte mujore për rastet e trajtuara në Platformën e Bashkëqeverisjes, ku pjesë është dhe ankesi për rastet e ardhura në  rubrikën "Denonco korrupsionin". Në website do të publikohet vetëm raportimi vjetor i cili do të hartohet me mbylljen e vitit 2023.

Gjatë kësaj periudhe monitorimi, nuk është hartuar dhe publikuar një raport i cili të përmbajë të dhëna për dorëzimin e kerkesave mujore për institucionet e linjës për mbledhjen e numrit të qytetarëve të denoncimeve për korrupsion në portal, të cilat janë raportuar në prokurori.

Ky raport prodhohet dhe publikohet në fund të vitit në faqen zyrtare te shqiperiaqeduam.al dhe në linkun zyrtar të Kryeministrisë.

ADB ka përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion 7 raste të reja. ADB nuk referon drejtpërdrejt raste në Prokurori apo Polici. Rastet e dyshuara të korrupsionit, ADB i përcjell pranë MD/KKK, e cila pas hetimit të thelluar administrativ, i referon rastet pranë organeve të ndjekjes penale.

Pas trajtimit të të gjitha çështjeve në total, Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion ka referuar 9 raste për ndjekje penale pranë organit të prokurorisë me 28 persona të kallëzuar.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, janë kryer 2 aktivitete informuese mbi mënyrën e funksionimit të portalit për publikun, të aksesueshme në linket e mëposhtme:

https://fb.watch/iRA-K7YKWB/

https://instagram.com/shqiperiaqeduam?igshid=YmMyMTA2M2Y=

Në përfundim, numri i denoncimeve të qytetarëve për korrupsion të denoncuara në platformën www. shqiperiaqeduam.al, për këtë periudhë raportuese është në total 1440. Gjithashtu pranë DPA janë administruar në total 202 ankesa të qytetarëve përgjatë kësaj periudhe raportuese. Targeti vjetor është 3007 denoncime (duke u nisur nga arritja për vitin 2022 + 40% rritje). Deri tani janë kryer 1440 denoncime për korrupsion. Indikatori për këtë periudhë raportuese është arritur në masën 48%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

<table>
<tr><td rowspan="5">Vlerat Bazë</td><td colspan="2">N/A</td></tr>
<tr><td colspan="2">N/A</td></tr>
<tr><td>2017</td><td>N/A</td></tr>
<tr><td>2018</td><td>N/A</td></tr>
<tr><td>2019</td><td>Rritje prej 30% në krahasim me vitin paraprak</td></tr>
</table>

DRAFT

| | | |
|---|---|---|
| | 2020 | Rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak (treguesi është arritur në masën 58%) |
| | 2021 | Rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak (treguesi është arritur në masën 0%) |
| | 2022 | Rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak |
| | **2023 (targeti i arritur)** | 48% |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

**C.2.b**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës C.2.b** për vitin 2023 është: ***rritje** prej 40% në krahasim me vitin paraprak.*

Për vitin 2022, objektivi ishte po ***rritje** prej 40% në krahasim me vitin paraprak.* Nga shifrat e raportuara, ky tregues performance u vlerësua i realizuar në masën 100%.

Për të arritur vlerat e treguesit për vitet për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (3) dhe masat (2) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| C. 2.2 | Dorëzimi i kërkesave mujore për institucionet e linjës për mbledhjen e numrit të qytetarëve të denoncimeve për korrupsion në portalin të cilat janë raportuar në Policinë e Shtetit/Prokurori |
| C.2.2.1 | Raporti periodik i prodhuar dhe i publikuar |
| C.2.2.2 | Nr. i rasteve të referuara PSH/Prokurori; (rastet e referuara të ndara mbi bazë gjinie) |
| C.2.3 | Transparencë e rritur e ADB, specifikisht për rastet e denoncimeve kundër korrupsionit |
| C.2.3.1 | Aktivitete informuese mbi mënyrën e funksionit të portalit për publikun (publikime/ ëeb/ njoftime) |

Realizimi i masave së parashikuara (2) kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme të aktiviteteve.

*Për janar - qershor 2023*, nuk është hartuar dhe publikuar një raport i cili të përmbajë të dhëna për dorëzimin e kerkesave mujore për institucionet e linjës për mbledhjen e numrit të qytetarëve të denoncimeve për korrupsion në portal, të cilat janë raportuar në prokurori.

Ky raport prodhohet dhe publikohet në fund të vitit në faqen zyrtare te shqiperiaqeduam.al dhe në linkun zyrtar të Kryeministrisë.

ADB ka përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion 7 raste të reja. ADB nuk referon drejtpërdrejt raste në Prokurori apo Polici. Rastet e dyshuara të korrupsionit, ADB i përcjell pranë MD/KKK, e cila pas hetimit të thelluar administrativ, i referon rastet pranë organeve të ndjekjes penale.

Pas trajtimit të të gjitha çështjeve në total, Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion ka referuar 9 raste për ndjekje penale pranë organit të prokurorisë me 28 persona të kallëzuar.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, janë kryer 2 aktivitete informuese mbi mënyrën e funksionimit të portalit për publikun, të aksesueshme në linket e mëposhtme:

https://fb.watch/iRA-K7YKWB/

https://instagram.com/shqiperiaqeduam?igshid=YmMyMTA2M2Y=

Në përfundim, konstatohet se ADB ka përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion 7 raste të reja. Në përfundim të hetimeve administrative nga DPA janë përcjellë pranë organit të Prokurorisë 9 kallëzime për ndjekje penale, me 28 persona të kallëzuar. Targeti vjetor është 28 kallëzime (40% rritje). Deri tani janë kryer 9 kallëzime. Indikatori për këtë periudhë raportuese është arritur në masën 32%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | N/A |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | Rritje prej 30% në krahasim me vitin paraprak |
| | 2020 | Rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak (treguesi është arritur në masën 58%) |
| | 2021 | Rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak (treguesi është arritur në masën 0%) |
| | 2022 | Rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak |

DRAFT

| | | |
|---|---|---|
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak |
| | **2023 (targeti i arritur)** | 32 % |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

***Niveli i realizimit të Objektivit C.2***

Niveli i realizimit të *Objektivit C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-qershor 2023 **është 40%.**

Përllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{NR C. 2} = \frac{\text{TP1 C.2.a (48\%)+ TP2 C.2.b(32\%)}}{\text{2TP}} \text{ x } 100\% = 40\%$$

Nisur nga realizimi i masave të raportuara, shkalla e realizimit të objektivit C.2 për këtë periudhë raportimi **është mjaftueshëm** (nga 31 në 50 për qind e masave të realizuara).

**Verifikueshmëria e të dhënave**

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit 6M1 2023.

**Risqet për realizimin e Objektivit C.2**

Risku i realizimit të këtij objektivi është i mesatar.

### *C.3 Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile*

Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:

*C.3.a: Hartimi i një Programi Antikorrupsion nga AMSHC-ja*

*C.3.b: Raporti i projekteve të antikorrupsionit të financuar nga AMSHC*

*C.3.c: Alokimi i buxhetit në mbështetje të projekteve të Anti-korrupsionit nga OSHC-të*

Plani i Veprimit për Objektivin C.3 parashikon (9) Aktivitete dhe (2) Produkte/Masa.

**C.3.a**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës C.3.a** për *vitin 2023* vlera e synuar është*: përfundimi i vlerësimit të jashtëm mbi zbatimin vjetor të Programit vjetor të vitit 2022.*

Për vitin 2022, objektivi vjetor ishte *përfundimi i vlerësimit të jashtëm mbi zbatimin vjetor të Programit vjetor të vitit 2021*. Duke qenë se ky aktivitet u realizua, ky tregues performance, u vlerësua i zbatuar në masën 100%.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masat (1) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| C.3.1 | Thirrje të hapura për propozime specifike në luftën kundër korrupsionit, të financuara nga AMSHC si pjesë e programit antikorrupsion dhe riprogramim të fondeve për këtë program (aktivitete që kryhen çdo vit gjatë PV) |
| C.3.1.1 | Hartimi i termave të referencës |
| C.3.1.2 | Pritja e aplikimeve<br>20% e projekteve në fushën e prokurimeve; 20% në fushën e arsimit; 20% në fushën e shëndetësisë; 20% në fushën e zbatimit të ligjit) |
| C.3.1.3 | Vlerësimi i aplikimeve |
| C.3.1.4 | Shpallja e fituesve |
| C.3.1.5 | Raportimet finale të OSHC-ve |
| C.3.1.6 | Relacionet e AMSHC/produktet finale të projekteve |

Realizimi i masës të parashikuar (1) kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme publikimit të thirrjeve të hapura për programin AK.

Për periudhën *janar-qershor 2023*, AMSHC nuk raporton se janë hartuar termat e referencës apo janë pritur aplikime sipas kategorive të përcaktuara: 20% e projekteve në fushën e prokurimeve; 20% në fushën e arsimit; 20% në fushën e shëndetësisë dhe 20% në fushën e zbatimit të ligjit. Për këtë shkak nuk janë vlerësuar aplikime dhe nuk janë shpallur fituesit përkatës. Gjatë kësaj periudhe monitorimi mungojnë gjithashtu raportimet finale të OSHC-ve dhe relacionet mbi produktet finale të projekteve.

Në përfundim, vlerësohet se nuk është arritur objektivi mbi përfundimin e vlerësimit të jashtëm mbi programin antikorrupsion të vitit 2022, e për pasojë ky tregues performance rezulton i pazbatuar 0%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | N/A |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | Ngritja e programit antikorrupsion;<br>Prodhimi dhe publikimi i Raportit vjetor të zbatimit të programit antikorrupsion |
| | 2020 | Është përfunduar vlerësimi mbi zbatimin vjetor të programit antikorrupsion të vitit 2019 (treguesi është arritur në masën 0%) |
| | 2021 | Është përfunduar vlerësimi i jashtëm mbi programin antikorrupsion të vitit 2020 (treguesi është arritur në masën 100%) |
| | 2022 | Është përfunduar vlerësimi i jashtëm mbi programin antikorrupsion të vitit 2021 |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i synuar)** | Është përfunduar vlerësimi i jashtëm mbi programin antikorrupsion të vitit 2022 |
| | **2023 (targeti i arritur)** | **0%** |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

**C.3.b**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës C.3.b** për *vitin 2023 vlera e synuar është rritje 20% në krahasim me vitin e mëparshëm,* për vitin 2023 vlera e synuar është po e njëjta.

Gjatë vitit 2022, vlera e synuar për treguesin e performancës C.3.b ishte po rritje 20% në krahasim me vitin e mëparshëm, e cila nuk u arrit.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masat (1) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| C.3.1 | Thirrje të hapura për propozime specifike në luftën kundër korrupsionit, të financuara nga AMSHC si pjesë e programit antikorrupsion dhe riprogramim të fondeve për këtë program (aktivitete që kryhen çdo vit gjatë PV) |

| | |
|---|---|
| C.3.1.1 | Hartimi i termave të referencës |
| C.3.1.2 | Pritja e aplikimeve; 20% e projekteve në fushën e prokurimeve; 20% në fushën e arsimit; 20% në fushën e shëndetësisë; 20% në fushën e zbatimit të ligjit) |
| C.3.1.3 | Vlerësimi i aplikimeve |
| C.3.1.4 | Shpallja e fituesve |
| C.3.1.5 | Raportimet finale të OSHC-ve |
| C.3.1.6 | Relacionet e AMSHC/produktet finale të projekteve |

Realizimi i masës të parashikuar (1) kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme publikimit të thirrjeve të hapura për programin AK.

Në periudhën *janar-qershor 2023*, AMSHC nuk raporton se janë hartuar termat e referencës apo janë pritur aplikime sipas kategorive të përcaktuara: 20% e projekteve në fushën e prokurimeve; 20% në fushën e arsimit; 20% në fushën e shëndetësisë dhe 20% në fushën e zbatimit të ligjit. Për këtë shkak nuk janë vlerësuar aplikime dhe nuk janë shpallur fituesit përkatës. Gjatë kësaj periudhe monitorimi mungojnë gjithashtu raportimet finale të OSHC-ve dhe relacionet mbi produktet finale të projekteve.

Në përfundim, vlerësohet se nuk është arritur objektivi prej 25% i vitit 2023, e për këtë arsye ky tregues performance vlerësohet i paarritur.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | 14.29% |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | 20% |
| | 2020 | 20% (treguesi është arritur në masën 0%) |
| | 2021 | 25% (treguesi është arritur në masën 0%) |
| | 2022 | 25% |
| | **2023 (targeti i synuar)** | 25% |

| Vlera e synuar/ Targeti | **2023 (targeti i arritur)** | **0%** |
|---|---|---|

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

**C.3.c**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës C.3.c** për vitin 2023 është: ***rritje 25%*** *në krahasim me vitin e mëparshëm.*

*Për vitin 2022*, vlera e synuar ishte po e njëjta. AMShC shpalli kandidatë përfitues të fondeve, një numër organizatash me një vlerë rreth 12.000.000, por kjo vlerë nuk ishte e dedikuar për projektet antikorrupsion dhe për këtë shkak treguesi i performances u vlerësua i paarritur 0%.

Në përfundim, vlerësohet se nuk është arritur objektivi prej 25% i vitit 2023, e për këtë arsye ky tregues performance vlerësohet i paarritur.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2020-2023 janë parashikuar aktivitetet (6) dhe masat (1) si më poshtë.

| | |
|---|---|
| C.3.1 | Thirrje të hapura për propozime specifike në luftën kundër korrupsionit, të financuara nga AMSHC si pjesë e programit antikorrupsion dhe riprogramim të fondeve për këtë program (aktivitete që kryhen çdo vit gjatë PV) |
| C.3.1.1 | Hartimi i termave të referencës |
| C.3.1.2 | Pritja e aplikimeve<br>20% e projekteve në fushën e prokurimeve; 20% në fushën e arsimit; 20% në fushën e shëndetësisë; 20% në fushën e zbatimit të ligjit) |
| C.3.1.3 | Vlerësimi i aplikimeve |
| C.3.1.4 | Shpallja e fituesve |
| C.3.1.5 | Raportimet finale të OSHC-ve |
| C.3.1.6 | Relacionet e AMSHC/produktet finale të projekteve |

Realizimi i masës të parashikuar (1) kryhet përmes aktiviteteve që vijojnë përgjatë gjithë vitit me vlera të matshme publikimit të thirrjeve të hapura për programin AK.

Në periudhën *janar-qershor 2023*, AMSHC nuk raporton se janë hartuar termat e referencës apo janë pritur aplikime sipas kategorive të përcaktuara: 20% e projekteve në fushën e prokurimeve; 20% në fushën e arsimit; 20% në fushën e shëndetësisë dhe 20% në fushën e zbatimit të ligjit. Për

këtë shkak nuk janë vlerësuar aplikime dhe nuk janë shpallur fituesit përkatës. Gjatë kësaj periudhe monitorimi mungojnë gjithashtu raportimet finale të OSHC-ve dhe relacionet mbi produktet finale të projekteve.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **Vlerat Bazë** | N/A | |
| | N/A | |
| | 2017 | 13.56% |
| | 2018 | N/A |
| | 2019 | 20% |
| | 2020 | 20% (treguesi është arritur në masën 0%) |
| | 2021 | 25% (treguesi është arritur në masën 0%) |
| | 2022 | 25% |
| | **2023 (targeti i synuar)** | 25% |
| **Vlera e synuar/ Targeti** | **2023 (targeti i arritur)** | **0%** |

*Shënim*: referuar pasaportës së indikatorëve, ky tregues ka frekuencë matje vjetore.

### Niveli i realizimit të Objektivit C.3

Niveli i realizimit të *Objektivit C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-qershor 2023 **është 0%.**

Përllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{NR C.3} = \frac{\text{TP1 C.3.a (0\%)} + \text{TP2 C.3.b(0\%)} + \text{TP3 C.3.c(0\%)}}{\text{3TP}} \text{ x } 100\% = 0\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit C.3 për këtë periudhë raportimi është **dobët.**

DRAFT

### Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat këtij treguesi do duhet të raportoheshin nga AMSHC për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit dhe pasaportës së indikatorëve për periudhën janar-qershor 2023.

### Risqet për realizimin e Objektivit C.3

Risku për realizimin e Objektivit C.3 vijon të mbetet konstant për shkak të nivelit të ulët të zbatimit të tij përgjatë secilës periudhë monitoruese.

### *Realizueshmëria e objektivave specifike të qëllimit strategjik për ndërgjegjësimin e qytetarëve kundër korrupsionit (Qasja C)*

Mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe përpunimin e të dhënave të treguesve të performancës tabela më poshtë paraqet shkallën e realizimit të 3 objektivave specifike të qëllimit strategjik për ndërgjegjësimin e qytetarëve kundër korrupsionit.

Duke aplikuar të njëjtën formulë të nxjerrjes së shkallës së realizimit të objektivave - duke mbledhur realizueshmërinë në përqindjes të treguesve të performancës dhe pjestuar me numrin e treguesve – realizueshmëria e qëllimit strategjik për ndërgjegjësimin e korrupsionit është 34.16 %.

| Objektivi | Realizueshmëria |
|---|---|
| C.1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit | 62.5% |
| C.2. Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit | 40% |
| C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile. | 0% |

Realizueshmëria e qëllimit strategjik për ndërgjegjësimin e korrupsionit, është në masën 34.16 % përgjatë periudhës janar - qershor 2023. Ministria e Drejtësisë në ushtrimin e rolit të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit ka luajtur njër rol udhëheqës dhe aktiv në organizimine aktiviteteve, pjesëmarrjen në evente të tjera dhe bashkëpunime me partnerë të fushës. Por, gjithashtu, institucionet e përcaktuara nga Plani i Veprimit dhe konkretisht AMSHC, duhet të marrin në tërësi një rol më përfshirës dhe bashkëpunues për të arritur rezultate më të mira.

## PROGRESI LIDHUR ME OBJEKTIVAT REZULTATET DHE IMPAKTIN

### 3.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit

Mbështetur në informacionin mbi vlerat e synuar të aktiviteteve dhe masave të realizuara, të treguesve të performances, realizimi i objektivave për *janar - qershor 2023* është si më poshtë.

| Realizimi sipas aktiviteteve/masave | Realizimi sipas treguesve |
|---|---|
| Dobët - 1 objektivë<br>Mjaftueshëm - 0 objektiva<br>Mirë - 7 objektiva<br>Shumë mirë - 10 objektiva<br>Tejkaluar – N/A objektiv | Dobët - 4 objektiva<br>Mjaftueshëm - 3 objektiva<br>Mirë - 4 objektiva<br>Shumë mirë - 5 objektiva<br>Tejkaluar - 2 objektiva |

### Histori suksesi (përmes masave prioritare)

Arritjet kryesore më të rëndësishme për periudhën *janar – qershor 202*3, në zbatim të Planit të Veprimit 2020-2023, të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit janë si më poshtë vijon:

1. Monitorimi dhe digjitalizimi i kërkesave dhe përgjigjeve: Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka ndjekur progresin e autoriteteve publike dhe njësive të Vetëqeverisjes Vendore në instalimin e regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve, gjë e cila ka rezultuar në rritjen e transparencës dhe efikasitetit në veprimtarinë publike.
2. Efikasiteti i Agjencisë së Prokurimit Publik: APP ka arritur objektivat e saj duke përmirësuar procedurat e prokurimit publik dhe mbajtur në kontroll nivelin e ndryshimeve të kontratave. Ky sukses ka ndikuar në zvogëlimin e riskut potencial të shpërdorimit të fondeve publike dhe ka rritur besimin e qytetarëve në procesin e prokurimit.
3. Platforma E-Albania dhe digjitalizimi i shërbimeve publike: Platforma e administruar nga AKSHI, ka ndihmuar në reduktimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe burokracisë në marrjen e shërbimeve publike. Ky process ka ndikuar që edhe gjatë kësaj periudhe raportuese të shënohet një sukses i dukshëm në rritjen e transparencës dhe efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike.

4. Sistemi i deklarimit të pasurive dhe interesave: ILDKPKI ka vijuar të mirëmbajë dhe të përmirësojë sistemin e deklarimit të pasurive dhe interesave privatë, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien e zyrtarëve publikë.

5. Forcimi i kapaciteteve: Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar Programin e Trajnimit të Vijueshëm Profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik për vitin 2023. Gjatë kësaj periudhe janë trajnuar 125 auditues të brendshëm dhe janë kryer vlerësime të jashtme të cilësisë në disa institucione. Poashtu, janë trajnuar edhe inspektorë financiarë publikë mbi menaxhim e riskut dhe kontrollin e brendshëm financiar publik.

6. Platforma e denoncimit të bashkëqeverisjes: Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje ka siguruar një platformë të qëndrueshme dhe të besueshme për qytetarët për të denoncuar praktikat e parregullta dhe abuzive. Kështu, qytetarët kanë mundur të ankohen dhe të raportojnë raste të dyshuara të korrupsionit, konflikteve të pronësisë, sjelljeve të paligjshme të punonjësve të strukturave policore, vendosjes së gjobave në mënyrë të padrejtë, dhe çështje të tjera. Përmes kësaj platforme janë marrë gjithsej 143 ankesa, të cilat janë trajtuar me përgjegjësi dhe rastet serioze janë referuar për ndjekje penale.

7. Bashkëpunimi për hetimet e korrupsionit: Agjencia e Mbikqyrjes Policore ka pasur një bashkëpunim të frytshëm me strukturat e Policisë së Shtetit në kuadër të operacionit "Toyota Double". Në këtë operacion janë proceduar disa persona të dyshuar për veprat penale të shpërdorimit të detyrës, kontrabandës me mallrat e licensuara dhe shkeljes së ligjit të akcizës. Ky bashkëpunim ka rezultuar në hetimin dhe procedimin e personave të dyshuar për këto vepra penale.

8. Rritja e kapaciteteve për hetimin e korrupsionit: Policia e Shtetit ka vijuar të ndërtojë kapacitete përmes strukturave të specializuara që merren me hetimin e krimit të korrupsionit. Gjatë kësaj periudhe 6-mujore, janë evidentuar 443 vepra penale me 510 autorë. Niveli i zbulueshmërisë për Policinë e Shtetit është në masën 84.19%. Për veprat penale të korrupsionit janë evidentuar 194 vepra penale, nga të cilat janë zbuluar 167, ose 86.8%. Bashkëpunimi i shtuar dhe shkëmbimi i informacionit me partnerët ndërkombëtarë ka ndihmuar në këtë punë.

9. Hetimet administrative dhe ndëshkimi i paligjshmërive: Drejtoria e Pëgjithshme Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë ka vijuar punën me rezultate solide në kryerjen e hetimeve administrative. Gjatë kësaj periudhe janar-qershor 2023, janë administruar 202 ankesa, dhe janë dhënë masa disiplinore, masa për largim nga detyra, rekomandime dhe janë referuar raste në prokurori. Kjo tregon angazhimin e drejtorisë në zbatimin e masave ndëshkuese kundër paligjshmërive.

DRAFT

## 3.2 Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit

Mbështetur në rezultatet e monitorimit të kryer për periudhën *1 janar – 30 qershor 2023*, rezulton se fushat që kanë treguar performance jo rezultative të shoqëruar nga problematika për këtë periudhë raportimi janë objektivë specifikë të shpërndarë në të tre qasjet e SNKK, parandalim-ndëshkim-ndërgjegjësim.

1. Mungesa e resurseve financiare: Mungesa e resurseve financiare për të mbështetur implementimin e planit të veprimit është një sfidë kryesore. Ky fakt ka ndikim të drejtpërdrejtë tek realizimi i objektivave të strategjisë dhe arritja e rezultateve të planifikuara. Nevoja për investime të mjaftueshme financiare është e rëndësishme për të siguruar implementimin e masave parandaluese dhe ndëshkuese efektive kundër korrupsionit.
2. Bashkëpunimi i institucioneve të tjera: Nevoja për përkrahje dhe angazhim të institucioneve të tjera që nuk janë përfshirë në planin e veprimit është një sfidë tjetër. Është e rëndësishme që të gjitha institucionet relevante të bashkëpunojnë dhe të angazhohen në zbatimin e strategjisë për të arritur rezultatet e dëshiruara. Mungesa e bashkëpunimit dhe përkrahjes nga këto institucione mund të krijojë pengesa në përmbushjen e objektivave të vendosura.
3. Zbatimi i masave ndëshkuese: Zbatimi i masave disiplinore dhe ligjore për rastet e korrupsionit dhe sjelljes së paligjshme të zyrtarëve është një sfidë. Është e rëndësishme që rastet e dyshuara të korrupsionit dhe abuzimeve të tjera të ndiqen me seriozitet dhe të trajtohen me efiçencë dhe në kohë. Mungesa e ndjekjes së saktë dhe të shpejtë të rasteve të korrupsionit zvogëlon ndikimin e ndëshkimit dhe sanksioneve në parandalimin e veprave të tilla në të ardhmen.
4. Ndërgjegjësimi i qytetarëve: Rritja e ndërgjegjësimit dhe informimit të qytetarëve për mekanizmat e denoncimit të korrupsionit dhe praktikave të paligjshme është një sfidë tjetër. Është e rëndësishme të inkurajohet qytetarët të kenë vetëdijën për të drejtat e tyre dhe mjetet e disponueshme për të raportuar abuzet. Vetëdija dhe angazhimi i qytetarëve janë thelbësore për të luftuar korrupsionin dhe për të promovuar integritetin në institucione.
5. Zhvillimi i kapaciteteve: Rëndësia e trajnimeve dhe zhvillimit të kapaciteteve për zyrtarët dhe personelin e institucioneve relevante është një sfidë tjetër. Është e nevojshme të investohet në trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve për të siguruar zbatimin e politikave dhe strategjive të vendosura. Mungesa e investimeve të mjaftueshme në këtë drejtim vështirëson realizimin e objektivave të strategjisë.
6. Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit: Mungesa e një sistemi të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi është një sfidë. Pa një sistem të përshtatshëm monitorimi dhe vlerësimi, është e vështirë të vlerësohet efektiviteti dhe progresi i planit të veprimit dhe të merren masat

DRAFT

korrigjuese nëse ka nevojë. Është e rëndësishme të ketë një mekanizëm të përshtatshëm për të monitoruar zbatimin dhe për të adresuar sfidat që shfaqen gjatë procesit.

Këto sfida dhe probleme tregojnë nevojën për angazhim të vazhdueshëm dhe përmirësime në zbatimin e strategjisë. Identifikimi i tyre është një hap i rëndësishëm drejt adresimit të tyre dhe forcimit të luftës kundër korrupsionit.

### *3.3 Konkluzione dhe rekomandime*

Ky raport monitorimi është në përputhje me strukturën e dokumenteve strategjikë sektoriale dhe ndërsektorialë për agjendën e mirëqeverisjes në kuadër të programimit IPSIS. Raporti jep një informacion mbi zbatueshmërinë e qëllimeve të politikës (Qasjeve të strategjisë), të objektivave specifike të strategjisë, të realizueshmërisë së treguesve sipas vlerave të synuara dhe ato të arritura, të zbatueshmërisë së masave (output/produkte) të parashikuara për arritjen e këtyre objektivave e të aktiviteteve konkrete të parashikuara. Raporti jep një informacion specifik mbi realizueshmërinë e masave prioritare të planit të veprimit, problematika të hasura gjatë zbatimit, sfidat e institucioneve si dhe një identifikim të masave të nevojshme korrigjuese për periudhat në vijim.

Raporti i monitorimit *janar – qershor 2023*, përmban të dhëna statistikore dhe analitike bazuar mbi evidenca të matshme dhe të verifikueshme, mbi raportimin e drejtpërdrejtë të institucioneve zbatuese, mbi raporte dhe informacione të publikuara, konsultim me të gjithë faktorët (zbatues dhe vlerësues të procesit) e të dhëna mbi raport progresin e treguesve mbi baza krahasimore për çdo objektiv të strategjisë.

Në përfundim të këtij raporti, rekomandimet janë:

1. Nevojitet rritje e investimeve financiare për të mbështetur zbatimin e strategjisë dhe për të përballuar sfidat në luftën kundër korrupsionit.
2. Institucionet relevante duhet të angazhohen dhe të bashkëpunojnë për të përmbushur objektivat e strategjisë dhe për të forcuar luftën kundër korrupsionit.
3. Zbatimi i masave disiplinore dhe ndëshkuese duhet të jetë prioritet, duke siguruar që rastet e dyshuara të korrupsionit të ndiqen dhe të trajtohen me seriozitet dhe në kohë.
4. Nevojitet përmirësim i ndërgjegjësimit dhe informimit të qytetarëve, duke promovuar mekanizmat e denoncimit të korrupsionit dhe të praktikave të paligjshme.
5. Duhen bërë investime në trajnimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të punonjësve, duke siguruar që ata të jenë të pajisur me njohuri dhe aftësi për të luftuar korrupsionin dhe për të promovuar integritetin.
6. Nevojitet implementim i një sistemi të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi për të vlerësuar efektivitetin dhe progresin e strategjisë dhe për të marrë masat korrigjuese kur është e nevojshme.

7. Bashkitë duhet të alokojnë buxhetin e nevojshëm për zbatimin e Planit të Integritetit dhe të zhvillojnë auditime të brendshme për të vlerësuar integritetin në institucionet e tyre.
8. Institucionet e varësisë të ministrive të linjës duhet të angazhohen në vlerësimin e riskut të integritetit dhe të miratojnë planet e integritetit për të adresuar shkeljet potenciale.
9. Bashkëpunimi ndërkombëtar duhet të forcohet, veçanërisht në sektorët që kanë ndikim në luftën kundër korrupsionit.
10. Nevojitet raportim i rregullt mbi kostot administrative dhe buxhetin e përdorur për të vlerësuar efikasitetin dhe efektivitetin e masave të ndërmarrura.

Këto rekomandime kanë për qëllim të adresojnë sfidat dhe boshllëqet identifikuar në zbatimin e strategjisë dhe për të përmirësuar luftën kundër korrupsionit në të ardhmen.

# III. RISQET/RISKU DHE HAPAT PËR TU ADRESUAR

## 4.1 Vlerësimi i riskut duke përdorur dhe treguesit

Në këtë raport monitorimi, *janar - qershor 2023*, është kryer vlerësimi i riskut për çdo objektiv në përputhje me analizën e riskut të sjell prej institucioneve përgjegjëse ose në mungesë të kësaj analize, të vlerësimit që vetë stafi i Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion i ka bërë riskut në përputhje me nivelin e realizueshmërisë së objektivave.

Numri i rasteve të korrupsionit: Vlerësimi i numrit të rasteve të korrupsionit që janë raportuar dhe trajtuar mund të tregojë për shkallën e përhapjes së korrupsionit dhe efektivitetin e masave parandaluese dhe ndëshkuese.

Niveli i zbulueshmërisë: Përqindja e rasteve të korrupsionit që janë zbuluar dhe trajtuar me sukses duhet të tregojë për efektivitetin e hetimit dhe ndëshkimit të veprave të korrupsionit.

Përgjigja ndaj ankesave: Koha e përgjigjes dhe trajtimi i ankesave të korrupsionit, të tregojë për efikasitetin e mekanizmave të denoncimit dhe trajtimit të rasteve të korrupsionit.

Niveli i bashkëpunimit institucional: Vlerësimi i bashkëpunimit mes institucioneve për hetimin dhe ndëshkimin e rasteve të korrupsionit do duhet të jetë i lidhur me nivelin e koordinimit dhe angazhimit të institucioneve në luftën kundër korrupsionit.

DRAFT

Niveli i ndërgjegjësimit të qytetarëve: Përqindja e qytetarëve të informuar dhe të ndërgjegjshëm për mekanizmat e denoncimit të korrupsionit synohet përmes efektivitetit të fushatave të informimit dhe ndërgjegjësimit publik.

Rritja e kapaciteteve: Vlerësimi i rritjes së kapaciteteve të punonjësve për të hetuar dhe trajtuar raste të korrupsionit mund të tregojë për efikasitetin e investimeve në trajnim dhe zhvillim personal.

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit: Vlerësimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të strategjisë ndërlidhet me efektivitetin dhe progresin në realizimin e qëllimeve të strategjisë dhe adresimin e sfidave të identifikuara.

Bazuar në këto tregues të performancës, mund të identifikohen fushat me risk më të lartë të korrupsionit dhe të përmirësohen masat dhe politikat për t'u përshtatur dhe për të adresuar këto sfida. Ky vlerësim mund të përdoret si bazë për të marrë masat korrigjuese dhe për të forcuar luftën kundër korrupsionit.

### *4.2 Hapat e radhës*

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën për periudhën *janar-qershor 2023* të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që institucionet kanë raportuar dhe të analizës së kryer, adresohen të ndërmerren këto hapa në vijim:

Rishikimi dhe përmirësimi i Planit të Veprimit: Bazuar në konkluzionet dhe rekomandimet e identifikuara në vlerësim, është e nevojshme të rishikohet dhe përmirësohet Planin e Veprimit për të adresuar sfidat dhe boshllëqet e identifikuara. Ky proces duhet të përfshijë pjesëmarrjen e institucioneve relevante, organizatave shoqërore dhe ekspertëve për të siguruar një plan të përmirësuar dhe të përshtatshëm.

Rritja e investimeve financiare: Organet publike duhet të sigurojnë investime të mjaftueshme financiare për të mbështetur zbatimin e strategjisë kundër korrupsionit. Përkatësisht, duhet të kthehet vëmendje ndaj alokimit të buxhetit të nevojshëm për zbatimin e masave dhe aktiviteteve antikorrupsion.

Përmirësimi i bashkëpunimit institucional: Institucionet relevante duhet të zhvillojnë dhe të forcojnë bashkëpunimin mes tyre për hetimin dhe ndëshkimin e rasteve të korrupsionit. Kjo përfshin shkëmbimin e informacionit, koordinimin e aktiviteteve dhe krijimin e një kulture bashkëpunimi për të luftuar korrupsionin.

Zbatimi i masave disiplinore dhe ndëshkuese: Duhen marrë masa për të siguruar që rastet e dyshuara të korrupsionit të ndiqen dhe të trajtohen me seriozitet dhe në kohë. Kjo përfshin zbatimin

DRAFT

e masave disiplinore dhe ligjore për personat e përfshirë në veprat korrupsioniste dhe abuzimet tjera.

Intensifikimi i fushatave të ndërgjegjësimit publik: Është e rëndësishme të vazhdohet me ndërgjegjësimin dhe informimin e qytetarëve për mekanizmat e denoncimit të korrupsionit dhe praktikave të paligjshme. Kjo mund të bëhet përmes fushatave të informimit, organizimit të takimeve publike dhe promovimit të ndërgjegjësimit nëpërmjet mediave sociale dhe burimeve të tjera të komunikimit.

Investimi në trajnim dhe rritjen e kapaciteteve: Nevojitet investim në trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve dhe zyrtarëve të institucioneve relevante për të luftuar korrupsionin dhe për të zbatuar politikat antikorrupsion. Kjo përfshin zhvillimin e programeve të trajnimit, punën me ekspertë të specializuar dhe përdorimin e modeleve të mira ndërkombëtare.

Monitorimi i zbatimit dhe vlerësimi i performancës: Është e rëndësishme të ketë një sistem të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi për të ndjekur zbatimin e strategjisë dhe për të vlerësuar performancën në luftën kundër korrupsionit. Ky vlerësim synon përdorimin e treguesve të performancës dhe raportimin periodik për të rritur efektivitetin dhe për të marrë masat korrigjuese kur është e nevojshme.

DRAFT

# ANEKSI I: RAPORTIMI I INDIKATORËVE DHE OBJEKTIVAVE

| Kodi | Objektivi Specifik | Treguesit e Performancës | Institucioni përgjegjës e për mbledhjen e informacionit | Frekuenc e mbledhjes së të dhënave | Vlera bazë/Viti | Vlera e arritur për periudhën e mëparshme raportuese | Shkalla e realizimit të vlerës së synuar për periudhën e mëparshme raportuese | Vlera e synuar për periudhën raportuese (konkretisht viti 2023) | Vlera arritur për periudhën raportuese (konkretisht 6M1 2023) | Realizimi i vlerës së synuar për periudhën raportuese | Zbatimi i Objektivit Specifik[48] | Probleme /çështje për t'u shënuar | Hapat e Rradhës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | A1. Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion | A.1.a: Numri i institucioneve të cilat kanë zbatuar saktë programe transparence | KMDIDHP | 6M & Vjetor | Viti 2017<br><br>181 institucione kanë zbatuar si duhet programe t e transparencës | Viti 2022<br><br>331 autoritete publike kanë të publikuar në faqet e tyre zyrtare Programin e Transparencës | 103% | Viti 2023<br><br>5% rritje në krahasim me vitin 2022 | 200 autoritete publike qendrore dhe 31 njësi të vetqeverisjes vendore kanë të publikuar në faqet e tyre zyrtare Programin e Transparencës | 66%[49] | | | |
| | | A.1.b Regjistri qëndror për ankesat dhe përgjigjet në autoritetet publike është operacional | KMDIDHP | Vjetor | Viti 2018<br><br>Krijimi i regjistrit qendror dhe miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave | Viti 2022<br><br>Regjistri është funksional në 195 institucione qendrore | 157% | Viti 2023<br><br>Përdorimi i regjistrit nga 25 % më shumë autoritete publike krahasuar me vitin 2021 | Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve është instaluar në 27 autoritete publike duke e cuar numrin total të autoriteteve publike që kanë instaluar regjistrin elektronik në 222 autoritete nga 195 qe ishte ne fund te vitit 2022. | 100% | | | |

- Arritje/mosarritje të sektorit gjatë vitit, që kanë ardhur si rezultat i realizimit/ mosrealizimit të treguesit,

48 Sipas formulës $NR = \frac{TP1NR+TP2NR+TP3NR+TP4NR}{Numri\ në\ i\ Treguesve\ të\ Performanc\ ës\ për\ objetiv} X\ 100\%$

49 Megjithëse nuk ka rritje nga viti 2022 dhe ky objektiv ka një frekuencë matjeje vjetore, në këtë 6M1 2023, duke parë progresin e bërë në 231 autoritete publike, treguesi i performancës është vlerësuar i arritur në masën 66%. Gjatë vitit 2022, 331 autoritete publike kanë të publikuar në faqet e tyre zyrtare Programin e Transparencës. 5% rritje në krahasim me vitin 2022 që është objektivi për vitin 2023, përllogaritet në 17 autoritete publike të shtuara, **pra 348** – objektivi për vitin 2023. Duke qenë se aktualisht janë 231 autoritete publike kanë të publikuar në faqet e tyre zyrtare Programin e Transparencës, llogaritet se ky tregues performance është realizuar në masën 66%.

- Mënyra se si aktivitetet dhe masat kanë ndikuar/çuar në realizimin/ mosrealizimin e treguesit

- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në arritjen e objektivit specifik,

- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në parandalimin/goditjen/ndërgjegjësimin (sipas qasjes së treguesit/objektivit specifik),

- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në zbatimin e reformave kyçe antikorrupsion/ mireqeverisjes (SKZHI),

- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në procesin e integrimit evropian.

DRAFT

| Kodi | Objektivi Specifik | Treguesit e Performancës | Institucioni përgjegjëse për mbledhjen e informacionit | Frekuenc e mbledhjes së të dhënave | Vlera bazë/Viti | Vlera e arritur për periudhën e mëparshme raportuese | Shkalla e realizimit të vlerës së synuar për periudhën e mëparshme raportuese | Vlera e synuar për periudhën raportuese (konkretisht viti 2023) | Vlera arritur për periudhën raportuese (konkretisht 6M1 2023) | Realizimi i vlerës së synuar për periudhën raportuese | Zbatimi i Objektivit Specifik[50] | Probleme/ çështje për t'u shënuar | Hapat e Rradhës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | A2: Rritja e transparencës në planifikimin, detajimin, menaxhimin dhe kontrollin e fondeve buxhetore | A.2.a: Përqindja e elementëve e të modifikuar në Planet Vjetore të Prokurimit | APP | 6M & Vjetor | Viti 2018<br><br>Përqindja e elementeve të ndryshuar në regjistrin e parashikimeve për periudhën janar-dhjetor 2018 është 19.4% | Viti 2022<br><br>Përqindja e elementeve të ndryshuar në regjistrin e parashikimeve është 13.61% | 100% | Viti 2023<br><br>Elementët e ndryshuar në regjistrin e parashikimeve në masën 20% | Elementët e ndryshuar në regjistrin e parashikimeve kanë qenë në masën 8.2%, gjatë kësaj periudhe raportuese. | 100% | | | |
| | | A.2.b: Pjesa e kontratave e të dhëna përmes procedurave të negociuara pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës | APP | 6M & Vjetor | Viti 2017<br><br>Përqindja e procedurave me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ndaj totalit të procedurave të fituara në periudhën Janar-Dhjetor 2017 është 31.8% | Viti 2022<br><br>Përqindja e procedurave me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ndaj totalit të procedurave të fituara është 3.36% | 100% | Viti 2023<br><br>Procedurat me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ndaj totalit të procedurave të fituara në masën 10% | Procedurat me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ndaj totalit të procedurave të fituara kanë qenë gjatë kësaj periudhe raportuese në masën 2.05% | 100% | | | |
| | | B.1.c: Vlera e parashikuar e të ardhurave nga krimi të sekuestruara në rastet e korrupsionit | AAPSK | Dy vjeçare | N/A | Viti 2022<br><br>Është ndërtuar, fuksionon dhe perditesohet regjistri elektronik për pasuritë e sekuestruara dhe te konfiskuara<br><br>AAPSK ka marre ne administrim pasuri te sekuestruar per vepren penale te | 100% | Viti 2023<br><br>Vlerësim i nevojave për përmirësim të masave kundër korrupsionit; 5% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm. | AAPSK ka marrë në administrim pasuri të sekuestruar për veprën penale të korrupsionit në vlerën 32,034,000.00 lekë | % | | | |

63 Sipas formulës $NR = \frac{TP1NR+TP2NR+TP3NR+TP4NR}{Numri\ në\ i\ Treguesve\ të\ Performancës\ për\ objektiv}$ X 100%

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | korrupsionit ne vleren 4,268,350,439.5 leke | | | | | | | |

- Arritje/mosarritje të sektorit gjatë vitit, që kanë ardhur si rezultat i realizimit/ mosrealizimit të treguesit,
- Mënyra se si aktivitetet dhe masat kanë ndikuar/ çuar në realizimin/ mosrealizimin e treguesit,
- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në arritjen e objektivit specifik,
- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në parandalimin/goditjen/ndërgjegjësimin (sipas qasjes së treguesit/objektivit specifik),
- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në zbatimin e reformave kyçe antikorrupsion/ mireqeverisjes (SKZHI),
- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në procesin e integrimit evropian,

DRAFT

| Kodi | Objektivi Specifik | Treguesit e Performancës | Institucioni përgjegjëse për mbledhjen e informacionit | Frekuence e mbledhjes së të dhënave | Vlera bazë/Viti | Vlera e arritur për periudhën e mëparshme raportuese | Shkalla e realizimit të vlerës së synuar për periudhën e mëparshme raportuese | Vlera e synuar për periudhën raportuese (konkretisht viti 2023) | Vlera arritur për periudhën raportuese (konkretisht viti 6M1 2023) | Realizimi i vlerës së synuar për periudhën raportuese | Zbatimi i Objektivit Specifik[64] $NR = \frac{TP1NR+TP2NR+TP3NR+TP4NR}{Numri\ në\ i\ Treguesve\ të\ Performancës\ për\ objetiv}$ | Probleme/çështje për t'u shënuar | Hapat e Rradhës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **B2. Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit** | B.2.a: Raporti i procedurave të regjistruara mbi korrupsionin nga referimet e administruara | PP<br>SPAK | Vjetor | 64 % viti 2019 | Viti 2022<br><br>SPAK ka regjistruar gjithësej 131 proçedime penale me 76 persona nën hetim, për veprat penale që lidhen me korrupsionin.<br><br>PP ka regjistruar 262 procedime me 201 të pandehur. | 0 %<br><br>(Nuk është llogaritur % pasi kërkohej edhe vlera e kallëzimeve penale të ardhura në total, në mënyrë që të llogaritet raporti me kallëzimet penale të regjistruara) | Viti 2023<br><br>Rritje me 5 % | | | | | |
| | | B.2.b: Numri i aksesit në bazat e të dhënave shtesë për policinë dhe prokurorinë | PP<br>SPAK<br>PSH | Vjetor | 8/2017 | Viti 2022<br><br>Policia ka akses në 21 databaza të dhënash. | 100 % | Viti 2023<br><br>Policia ka akses në 22 baza të dhënash;<br>Akses në 11 databaza për prokurorinë | Policia e Shtetit nuk ka marrë akses në baza të dhënash shtetërore përgjatë kësaj periudhe 6 mujore. | 50 % | | | |

- Arritje/mosarritje të sektorit gjatë vitit, që kanë ardhur si rezultat i realizimit/ mosrealizimit të treguesit,

Treguesi i performancës B.2.b vlerësohet në masën 50%, duke qenë se ky është një proces vijues, i cili matet në fund të vitit 2023. Gjithashtu, në total, Policia e Shtetit ka akses në 21 databaza të dhënash, krahasimisht me 22, që është objektivi i indikatorit për vitin 2023.

- Mënyra se si aktivitetet dhe masat kanë ndikuar/ çuar në realizimin/ mosrealizimin e treguesit,
- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në arritjen e objektivit specifik,

64 Sipas formulës $NR = \frac{TP1NR+TP2NR+TP3NR+TP4NR}{Numri\ në\ i\ Treguesve\ të\ Performancës\ për\ objetiv}$ X 100%

- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në parandalimin/goditjen/ndërgjegjësimin (sipas qasjes së treguesit/objektivit specifik),
- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në zbatimin e reformave kyçe antikorrupsion/ mireqeverisjes (SKZHI),
- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në procesin e integrimit evropian,

DRAFT

| **Kodi** | **Objektivi Specifik** | **Treguesit e Performancës** | **Institucioni përgjegjës e për mbledhjen e informacionit** | **Frekuence mbledhjes së të dhënave** | **Vlera bazë/Viti** | **Vlera e arritur për periudhën e mëparshme raportuese** | **Shkalla e realizimit të vlerës së synuar për periudhën e mëparshme raportuese** | **Vlera e synuar për periudhën raportuese (konkretisht viti 2023)** | **Vlera arritur për periudhën raportuese (konkretisht 6M1 2023)** | **Realizimi i vlerës së synuar për periudhën raportuese** | **Zbatimi i Objektivit Specifik**[65] | **Probleme/çështje për t'u shënuar** | **Hapat e Rradhës** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **B3. Përmirësimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar** | B.3.a: Numri i raporteve të rishikimit të hartuara në mënyrë periodike dhe të bëra publike nga Ministria e Drejtësisë mbi përshtatshmërinë e kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare | MFE/MD | Vjetor | Viti 2017 | Viti 2022<br><br>Është pregatitur një raport rishikimi mbi ZRA i cili është dorëzuar tek politikëbërësi, gjatë vitit 2022 | 100 % | Viti 2023<br><br>Një raport rishikimi i publikuar dhe i dorëzuar tek politikëbërësit | Gjatë kësaj periudhe moniotrimi, nuk është pregatitur një raport rishikimi mbi ZRA i cili të jetë dorëzuar tek politikëbërësi. | 0% | | | Finalizimi i vendimarrjes së ZRA |
| | | B.3.b: Zbatimi i legjislacionit për ngritjen e një Zyre të Rikuperimit të Pasurive | MFE/MD | Vjetor | Viti 2018 | Viti 2022<br><br>Në process finalizimi i vendimmarrjes për strukturën e ZRA. | 0 % | Viti 2023<br><br>Prokurorët e specializuar i janë kushtuar vetëm gjurmimit të pasurive dhe rikuperimit | Finalizimi i vendimmarrjes për strukturën e ZRA vijon të mbetet në process edhe në 6M1 2023. | 0% | | Nuk është realizuar ende e gjithë korniza ligjore për ngritjen e ZRA dhe të jenë caktuar prokurorët e specializuar, të cilët të jenë kushtuar vetëm gjurmimit të pasurive dhe rikuperimit. | Ngritja e strukturës së ZRA |

- Arritje/mosarritje të sektorit gjatë vitit, që kanë ardhur si rezultat i realizimit/ mosrealizimit të treguesit

Pregatitja e këtij raporti tregon një arritje për të vlerësuar përshtatshmërinë e kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare. Ky është një hap në drejtim të vlerësimit si veprim ligjor dhe identifikimit të çështjeve që mund të nevojiten përmirësime. Megjithatë, vendimarrja është e papërfunduar mbi raportin e rishikimit. Pavarësisht dorëzimit të raportit tek politikëbërësi, vendimarrja për të marrë masat e duhura nuk është finalizuar. Raporti rishikues

65 Sipas formulës $NR = \frac{TP1NR+TP2NR+TP3NR+TP4NR}{Numri\ në\ i\ Treguesve\ të\ Performanc\ ës\ për\ objetiv}$ X 100%

është i rëndësishëm, pasi duhet të përdoret për të ndërmarrë veprime konkrete në bazë të rekomandimeve të tij.

Gjithashtu, në përputhje me objektivin, nuk janë caktuar ende prokurorë të specializuar të kushtuar vetëm gjurmimit të pasurive dhe rikuperimit. Ky mosrealizim për këtë periudhë raportuese ndikon kundrejt kapaciteteve për zbulimin dhe ndjekjen e krimeve ekonomike dhe financiare, duke vështirësuar arritjen e rezultateve të pritshme. Kështu ka ende qartësisht sfida dhe pengesa që duhet të adresohen në përmirësimin e kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare. Është e nevojshme të vazhdohet puna në hartimin e politikave dhe implementimin e masave për të forcuar kapacitetet e zbatimit ligjor dhe për të arritur rezultatet e dëshiruara në luftën kundër këtyre krimeve.

- Mënyra se si aktivitetet dhe masat kanë ndikuar/ çuar në realizimin/ mosrealizimin e treguesit:

Aktivitetet dhe masat kanë ndikuar në realizimin e pjesshëm të treguesit, duke krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë me arritjet dhe mosarritjet në sektorin e ndjekjes penale të krimeve ekonomike dhe financiare. Aktiviteti i përgatitjes së raportit rishikues mbi Zyrën e Rikuperimit të Aseteve ka treguar një përpjekje për të vlerësuar përshtatshmërinë e kuadrit ligjor aktual. Ky raport është i detajuar dhe ofron rekomandime të qarta për përmirësimin e kuadrit ligjor, si dhe ka potencialin të ndikojë në marrjen e vendimeve të duhura dhe në përmirësimin e kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare.

Vendimet e politikëbërësit në lidhje me raportin rishikues dhe masat për përmirësimin e kuadrit ligjor kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në realizimin e treguesit. Poashtu, mosrealizimi i plotësimit të kornizës ligjore për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve dhe caktimi i prokurorëve të specializuar për gjurmimin dhe rikuperimin e pasurive mund të jetë një pengesë në realizimin e treguesit. Mungesa e kornizës ligjore të nevojshme dhe caktimi i profesionistëve të specializuar, mund të rezultojnë në mangësi të kapaciteteve për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare, duke vështirësuar realizimin e objektivit të përmirësimit të kuadrit ligjor.

Vendimet politike, implementimi i legjislacionit dhe përgjegjësia e institucioneve për të ndërmarrë veprime efektive janë faktorë kyç që ndikojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara dhe realizimin e treguesve të performancës.

- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në arritjen e objektivit specifikë:

Ndikimet e arritjes ose mosarritjes së treguesit janë të rëndësishme në këtë fazë, në arritjen e objektivit specifik të "Përmirësimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar". Raporti mbi përshtatshmërinë e kuadrit ligjor jep një vlerësim objektiv mbi performancën ekzistuese. Kjo mund të ndihmojë në identifikimin e nevojave të përmirësimit në

DRAFT

kuadrin ligjor dhe në rregullimin e çështjeve që mund të kenë rezultuar në mangësi ose vështirësi në ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare.

Raportet e rishikimit të hartuara në mënyrë periodike do të ofrojnë në të ardhmen një mundësi për të bërë rekomandime konkrete për përmirësimin e kuadrit ligjor. Nëse rekomandimet e raporteve janë të vërtetuara dhe implementohen në praktikë, atëherë objektivi specifik për përmirësimin e kuadrit ligjor mund të realizohet me sukses.

Për shkak të mosfinalizimit të vendimeve për të adresuar rekomandimet e raporteve rishikuese, mosrealizimi për pjesën e dytë të të objektivit specifik, mund të ndërlikojë arritjen e tij. Vonesat në marrjen e vendimeve institucionale mund të krijojnë pengesa dhe vonesa në përmirësimin e kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare. Në rastin kur korniza ligjore për ngritjen e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve nuk është realizuar ende, mosrealizimi i treguesit ndikon drejtpërdrejtë në arritjen e objektivit specifik. Mungesa e një Zyre të specializuar dhe të caktuar prokurorëve të specializuar krijon vështirësi në zbatimin e ligj në mënyrë efektive dhe në luftën kundër krimeve ekonomike dhe financiare.

Në tërësi, ndikimet e arritjes ose mosarritjes së treguesit janë të rëndësishme për të vlerësuar se në çfarë masë objektivi specifik është realizuar. Ata japin sinjale për përshtatshmërinë e masave dhe aktiviteteve që janë ndërmarrë dhe ndihmojnë në identifikimin e hapat e nevojshëm për përmirësimin e kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare.

- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në parandalimin/goditjen/ndërgjegjësimin (sipas qasjes së treguesit/objektivit specifik):

Arritja e treguesit dhe realizimi i objektivit specifik për përmirësimin e kuadrit ligjor ka ndikim të drejtëpërdrejtë në parandalimin e krimit. Përmirësimi i ligjeve dhe rregulloreve për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare mund të sanksionojë veprimtarinë kriminale dhe të krijojë kushte më të vështira për zbatimin e veprave të tilla. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe implementimi i rekomandimeve të raporteve rishikuese ndikon në rritjen e ndërgjegjësimit të personave të përfshirë në krime ekonomike dhe financiare. Duke ndryshuar dhe forcuar ligjin, si dhe duke bërë raportet publike, mund të krijohet vetëdija dhe një kulturë e re në shoqëri që ndihmon në zvogëlimin e veprimtarisë kriminale dhe në parandalimin e saj.

Mosarritja e treguesit dhe mungesa e përmirësimeve në kuadrin ligjor mund të limitojë ndëshkimin efektiv të krimit ekonomik dhe financiar. Nëse ligji nuk është efektiv për të ndjekur autorët e veprave penale, ata mund të vazhdojnë të kryejnë veprimtarinë e tyre kriminale përmes burimeve financiare. Për të arritur rezultate pozitive në parandalimin, goditjen dhe ndërgjegjësimin e krimit ekonomik dhe financiar, është e rëndësishme të zhvillohen ligjet dhe politikat e duhura, të monitorohet zbatimi i tyre dhe të ndërmerren masat e nevojshme për të adresuar çështjet dhe mangësitë identifikuar në treguesin e performancës.

- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në zbatimin e reformave kyçe antikorrupsion/ mireqeverisjes (SKZHI):

Angazhimi i politikëbërësve drejt një agjende kombëtare antikorrupsion dhe, respektivisht, drejt përmirësimit të kuadrit institucional dhe legjislativ në fushën e antikorrupsionit është parësor. Duke qenë se ekziston nevoja për të forcuar vlerësimin e rreziqeve dhe dobësive ndaj korrupsionit si dhe efektivitetin e mekanizmave për parandalimin, ky tregues ndërthuret me forcimin e përpjekjeve antikorrupsion të parashikuara në SKZHI.

- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në procesin e integrimit evropian.

Ndikimi i arritjes së këtij treguesi në procesin e integrimit evropian është i rëndësishëm, pasi progresi në fushën e ndjekjes penale të krimeve ekonomike dhe financiare është një nga kushtet e rëndësishme për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Arritja e treguesit në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare është një hap drejt harmonizimit me standardet evropiane. Bashkimi Evropian kërkon që vendet kandidate të kenë një sistemi ligjor të fuqishëm për të luftuar krimin ekonomik dhe financiar dhe të ketë institucione efektive për zbatimin e ligjit.

Arritja e treguesit në aspektin e raportit të rishikimit të Zyrës së Rikuperimit të Aseteve, dëshmon për një hap pozitiv në ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare. Kjo reflekton një angazhim të vendit në luftën kundër korrupsionit.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se integrimi evropian është një proces kompleks dhe përfshin shumë aspekte të tjera përveç ndjekjes penale të krimeve ekonomike dhe financiare. Arritja e treguesit vetëm në këtë fushë ndikon pozitivisht në rrugën drejt integrimimit evropian duke demonstruar përpjekjet e vendit për të përmbushur standardet dhe kushtet e nevojshme.

| Kodi | Objektivi Specifik | Treguesit e Performancës | Institucioni përgjegjëse për mbledhjen e informacionit | Frekuenc e mbledhjes së të dhënave | Vlera bazë/Viti | Vlera e arritur për periudhën e mëparshme raportuese | Shkalla e realizimit të vlerës së synuar për periudhën e mëparshme raportuese | Vlera e synuar për periudhën raportuese (konkretisht viti 2023) | Vlera arritur për periudhën raportuese (konkretisht 6M1 2023) | Realizimi i vlerës së synuar për periudhën raportuese | Zbatimi i Objektivit Specifik[66] | Probleme/çështje për t'u shënuar | Hapat e Rradhës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **B4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar** | B.4.a: Numri i informacioneve të Policisë i shkëmbyer me vendet e treta dhe institucionet mbi-kombëtare mbikëqyrëse të zbatimit të ligjit | PSH | Vjetor | Viti 2017<br>103 | Viti 2022<br>Janë shkëmbyer 405 praktika me Interpolin; 2740 korrespodenca me Europolin; dhe 77 praktika me rrjetin CARIN. | 100 % | Viti 2023<br>Rritje prej 5% në raport me vitin 2022 | Janë shkëmbyer 266 praktika me Interpolin; 79 praktika me Europolin; dhe 88 praktika me r Departamentin e Mardhëniev e Ndërkombëtare. Totali i praktikave të shkëmbyera është 443, për këtë periudhë raportuese. | 50%[67] | | | |
| | | B.4.b: Numri i operacioneve të përbashkëta të Policisë të nisura nga Europol ose Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik ku Shqipëria merr pjesë aktivisht | PSH | Vjetor | Viti 2017<br>2 | Viti 2022<br>3 operacione të përbashkëta të PSH të nisura nga ndërkombëtarët në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik. | 100% | Viti 2023<br>Trend rritës | Nuk janë kryer ende operacione të përbashkëta të Policisë të nisura nga Europol ose Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik | 0% | | | |

- Arritje/mosarritje të sektorit gjatë vitit, që kanë ardhur si rezultat i realizimit/ mosrealizimit të treguesit,

66 Sipas formulës $NR = \frac{TP1NR+TP2NR+TP3NR+TP4NR}{Numri\ në\ i\ Treguesve\ të\ Performanc\ ës\ për\ objetiv}$ X 100%

[67] Megjithëse ky tregues performance matet mbi bazë vjetore, për këtë periudhë monitorimi është vlerësuar arritja 50%, meqënëse po vijon puna me shkëmbimin e praktivave me partnerët ndërkombëtarë, por nuk ka ende 5% rritje me vitin 2022.

- Mënyra se si aktivitetet dhe masat kanë ndikuar/shpënë në realizimin/ mosrealizimin e treguesit
- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në arritjen e objektivit specifik
- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në parandalimin/goditjen/ndërgjegjësimin (sipas qasjes së treguesit/objektivit specifik)
- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në zbatimin e reformave kyçe antikorrupsion/ mireqeverisjes (SKZHI)
- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në procesin e integrimit evropian

DRAFT

| Kodi | Objektivi Specifik | Treguesit e Performancës | Institucioni përgjegjëse për mbledhjen e informacionit | Frekuence e mbledhjes së të dhënave | Vlera bazë/Viti | Vlera e arritur për periudhën e mëparshme raportuese | Shkalla e realizimit të vlerës së synuar për periudhën e mëparshme raportuese | Vlera e synuar për periudhën raportuese (konkretisht viti 2023) | Vlera arritur për periudhën raportuese (konkretisht 6M1 2023) | Realizimi i vlerës së synuar për periudhën raportuese | Zbatimi i Objektivit Specifik[68] | Probleme/çështje për t'u shënuar | Hapat e Rradhës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **C1. Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit** | C.1.a: Krijimi i planeve vjetore të komunikimit dhe vizibilitetit të Strategjisë Kundër Korrupsionit | MD/KKK | Vjetor | Viti 2017 | Viti 2022<br><br>Është vlerësuar dhe rishikuar Plani i Vizibilitetit dhe Komunikimit për vitin 2022 | 100 % | Viti 2023<br><br>Miratimi dhe zbatimi i Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimit është pjesë integrale e veprimtarisë së K4. | Ministria e Drejtësisë ka miratuar Planin e Komunikimit dhe Vizbilitetit për vitin 2023, i aksesueshëm në linkun: https://www.drejtesia.gov.al/instumenta-viti-2023/ | 100% | | | |
| | | C.1.b: Numri i fushatave vjetore të ndërgjegjësimit për luftën kundër korrupsionit | MD/KKK | Vjetor | Viti 2018 | Viti 2022<br><br>MD ka kryer 3 aktivitete ndërgjegjësuese për vitin 2021 | 75% | Viti 2023<br><br>Rishikimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese do të bëhet cdo vit/ 4 fushata në vit | Është zhvilluar një fushatë publike për vitin 2023, duke promovuar rrjetin e koordinatorëve antikorrupsion, si një mekanizëm i luftës ndaj korrupsionit në përballjen e qytetarit me administratën publike. Në rrjetet e komunikimit të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion, Facebook, Twitter dhe LinkedIn, janë shfaqur | 25% | | | |

68 Sipas formulës $NR = \frac{TP1NR + TP2NR + TP3NR + TP4NR}{Numri\ në\ i\ Treguesve\ të\ Performanc\ ës\ për\ objetiv}$ X 100%

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | një seri me 15 video udhëzuese dhe ndërgjegjësuese për të nxitur qytetarët duke denoncuar praktikat dhe abuzimet në institucionet publike, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve antikorrupsion | | | | |

- Arritje/mosarritje të sektorit gjatë vitit, që kanë ardhur si rezultat i realizimit/mosrealizimit të treguesit

Ministria e Drejtësisë ka miratuar Planin e Komunikimit dhe Vizibilitetit për vitin 2023, si dhe ka zhvilluar një fushatë publike për luftën kundër korrupsionit në përballje me administratën publike. Synimi i saj ishte për të ndërgjegjësuar publikun dhe nxitur atë të denoncojnë praktikat dhe abuzimet në institucionet publike pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit. Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion ka shfaqur një seri video me 15 udhëzime në rrjetet e saj sociale. Njëkohësisht kjo fushatë ka promovuar edhe rrjetin e koordinatorëve antikorrupsion si një mekanizëm të rëndësishëm për luftën kundër korrupsionit. Këto arritje kanë ndikuar në rezultatin e realizimit gjatë vitit 2023. Fakti që Ministria e Drejtësisë ka miratuar Planin e Komunikimit dhe Vizibilitetit për vitin 2023 e ka realizuar në masën 100%, që në këtë periudhë 6 mujore, objektivin për vitin 2023, për treguesin e performancës C.1.a. Nga ana tjetër, realizimi i një fushate publike për vitin 2023, nga 4 fushata publike, të parashikuara për gjithë vitin, përbën realizim në masën 25% të treguesit të performancës C.1.b.

- Mënyra se si aktivitetet dhe masat kanë ndikuar/ çuar në realizimin/ mosrealizimin e treguesit

Zhvillimi i fushatës publike për luftën kundër korrupsionit ka qëllimin e ndërgjegjësimit të publikut dhe nxitjes së tyre për të denoncuar praktikat dhe abuzimet në institucionet publike. Kjo fushatë ka ndikuar në rritjen e vetëdijes së publikut lidhur me pasojat e korrupsionit dhe në rritjen e përfshirjes së tyre në luftën kundër tij. Përdorimi i rrjeteve sociale si Facebook, Twitter dhe LinkedIn për të shfaqur një seri me 15 video udhëzuese dhe ndërgjegjësuese ka nxitur qytetarët që të jenë aktivë në luftën ndaj korrupsionit si dhe të njohin më mirë rolin dhe funksionin e Rrjetit të

Koordinatorëve Antikorrupsion. Gjithashtu miratimi dhe zbatimi i Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimit përbën një instrument të shtuar në qasjen ndërgjegjësuese.

- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në arritjen e objektivit specifik:

Treguesi i dytë i performancës, i cili është "Numri i fushatave vjetore të ndërgjegjësimit për luftën kundër korrupsionit", është realizuar pjesërisht. Kjo arritje ka patur një ndikim pozitiv në realizueshmërinë e objektivit specifik. Nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit, publiku ka mundur të informohet dhe edukohet mbi pasojat dhe dëmet e korrupsionit. Kjo ndikim ka synuar poashtu të shkaktojë një ndryshim të vetëdijes dhe sjelljes së publikut duke rritur nivelin e përgjegjësisë ndaj korrupsionit dhe ndihmuar në kultivimin e një mjedisi më të të drejtë. Është e rëndësishme të përmendet se ndikimi i arritjes ose mosarritjes së treguesit në arritjen e objektivit specifik do mund të vlerësohet me saktësi në fund të vitit 2023, kur do të shihet nëse janë arritur ose jo, 4 fushtata të ndërgjegjësimit publik si dhe efektet që ato kanë pasur.

- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në parandalimin/goditjen/ndërgjegjësimin (sipas qasjes së treguesit/objektivit specifik)

Arritja e treguesit të realizuar, i cili përfshin zhvillimin e fushatave vjetore të ndërgjegjësimit për luftën kundër korrupsionit, ka ndikuar në parandalimin, goditjen dhe ndërgjegjësimin e luftës ndaj korrupsionit. Përmes fushatave të ndërgjegjësimit, publiku është informuar për pasojat dhe dëmet e korrupsionit. Me ndërgjegjësimin mbi këtë çështje, publiku mund të jetë më i vetëdijshëm dhe më i përgjegjshëm në veprimet e tyre, duke u shmangur nga veprimtaria korruptive. Kjo mund të ketë ndikim në parandalimin e rasteve të reja të korrupsionit dhe në krijimin e një klime pune të re.

- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në zbatimin e reformave kyçe antikorrupsion/ mireqeverisjes (SKZHI

Lufta ndaj korrupsionit është një nga shtyllat dhe përparësitë kryesore të SKZHI. Megjithëse ndërgjegjësimi publik, nuk është drejtpërdrejt një çështje e cila duhen adresuar sipas rekomandimeve të raporteve ndërkombëtare në fushën e antikorrupsionit, të përmendura në SKZHI, ajo gjithsesi vijon të luajë një rol kyç, si një nga tre komponentët e luftës ndaj korrupsionit.

- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në procesin e integrimit evropian

Këto dy tregues performance nuk evidentojnë një lidhje të drejtpërdrejtë në procesin e integrimit evropian. Megjithatë arritja e treguesit të dytë të performancës, në këtë rast, numri i fushatave vjetore të ndërgjegjësimit për luftën kundër korrupsionit, ka ndikim pozitiv në procesin e

integrimit. Integrimi evropian ka një ndër kriteret kryesore për anëtarësim në *acquis* luftën kundër korrupsionit dhe përmirësimi i administratës publike. Në procesin e integrimit evropian, BE vlerëson përpjekjet dhe rezultatet e vendit aplikant në luftën kundër korrupsionit. Duke realizuar fushata të ndërgjegjësimit të suksesshme, që inkurajojnë qytetarët të denoncojnë praktikat dhe abuzimet në institucionet publike, vendi tregon se është i angazhuar në luftën kundër korrupsionit dhe ka marrë masa efektive për të adresuar këtë problem.

Shqipëria synon të kenë një sistem të fortë ligjor, qeverisje të mirë, dhe të kenë ndërgjegjësim të gjerë për pasojat e korrupsionit. Duke realizuar fushatat e ndërgjegjësimit dhe duke promovuar rrjetin e koordinatorëve antikorrupsion, vendi tregon se është duke i adresuar sfidat e korrupsionit në nivel të administratës publike dhe është duke e nxitur pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në luftën kundër korrupsionit.

Në këtë mënyrë, arritja e treguesit të performancës për fushatat e ndërgjegjësimit ndikon në ndërtimin e një sistemi më të fortë institucional dhe ligjor në vend, që është një nga synimet kryesore të procesit të integrimit evropian. Kjo mund të rrisë besimin e BE-së në aftësitë e vendit për të zbatuar rregullat dhe standardet evropiane në luftën kundër korrupsionit, duke përmirësuar kështu perspektivën e vendit në procesin e integrimit evropian.

DRAFT

| Kodi | Objektivi Specifik | Treguesit e Performancës | Institucioni përgjegjëse për mbledhjen e informacionit | Frekuenc e mbledhjes së të dhënave | Vlera bazë/Viti | Vlera e arritur për periudhën e mëparshme raportuese | Shkalla e realizimit të vlerës së synuar për periudhën e mëparshme raportuese | Vlera e synuar për periudhën raportuese (konkretisht viti 2023) | Vlera arritur për periudhën raportuese (konkretisht 6M1 2023) | Realizimi i vlerës së synuar për periudhën raportuese | Zbatimi i Objektivit Specifik[69] $NR = \frac{TP1NR+TP2NR+TP3NR+}{Numri\ në\ i\ Treguesve\ të\ Performan}$ | Probleme/çështje për t'u shënuar | Hapat e Rradhës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **C2. Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat në denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit** | C.2.a: Numri i denoncimeve të qytetarëve për korrupsion të denoncuara në platformën www. shqiperiaqed uam.al | ADB | Vjetor | Viti 2017 | Viti 2022<br><br>Pranë Drejtorisë së Pëgjithshme të Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë janë administruar në total 1342 ankesa, nga të cilat:<br>-1180 ankesa janë administruar në rrugë shkresore;<br>-111 ankesa janë administruar në rrugë elektronike (email);<br>- 43 ankesa janë deleguar nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje (ADB). | 100% | Viti 2023<br><br>Rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak | Numri i denoncimeve të qytetarëve për korrupsion të denoncuara në platformën www. shqiperiaqeduam.al, është në total 1440.<br><br>Gjithashtu pranë DPA janë administruar në total 202 ankesa të qytetarëve përgjatë kësaj periudhe raportuese. | Targeti vjetor është 3007 denoncime (duke u nisur nga arritja për vitin 2022 + 40% rritje). Deri tani janë kryer 1440 denoncime për korrupsion. Indikatori për këtë periudhë raportuese është arritur në masën 48%. | | | |
| | | C.2.b: Numri i rasteve të korrupsionit të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve në www.shqiperiaqeduam.al, | ADB | Vjetor | Viti 2018 | Viti 2022<br><br>Në përfundim të hetimeve administrative nga DPA janë përcjellë pranë organit të | 100 % | Viti 2023<br><br>Rritje prej 40% në krahasim me vitin paraprak | ADB ka përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion 7 raste të reja. Në | Targeti vjetor është 28 kallëzime (40% rritje). Deri tani janë kryer 9 kallëzime. | | | |

69 Sipas formulës $NR = \frac{TP1NR+TP2NR+TP3NR+TP4NR}{Numri\ në\ i\ Treguesve\ të\ Performancës\ për\ objetiv} X\ 100\%$

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | të cilat i raportohen Policisë së Shtetit/Prokurorisë Shqiptare | | | | Prokurorisë 20 kallëzime për ndjekje penale , për rastet ku përveç shkeljeve administrative janë konstatuar edhe elementë të veprave penale. | | | përfundim të hetimeve administrative nga DPA janë përcjellë pranë organit të Prokurorisë 9 kallëzime për ndjekje penale, me 28 persona të kalëzuar. | Indikatori për këtë periudhë raportuese është arritur në masën 32%. | | | |

- Arritje/mosarritje të sektorit gjatë vitit, që kanë ardhur si rezultat i realizimit/mosrealizimit të treguesit:

Bazuar në treguesin e parë të performancës, që është numri i denoncimeve të qytetarëve për korrupsion të denoncuara në platformën www.shqiperiaqeduam.al, me një total prej 1440 denoncimesh, mund të konkludohet se ka pasur një interes të vazhdueshëm dhe nxitje të publikut për të përdorur mekanizmat në denoncimin e korrupsionit dhe konkretisht plaftormën e bashkëqeverisjes. Kjo është një arritje pozitive, pasi tregon se publiku po merr pjesë aktive në luftën kundër korrupsionit dhe është i angazhuar në parandalimin e tij. Gjatë vitit 2022, pranë Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje janë paraqitur 2148 raste për trajtim. Duke u nisur nga arritja për vitin 2022 + 40% rritje, targeti vjetor është 3007 denoncime. Deri tani janë kryer 1440 denoncime për korrupsion. Kështu konkludohet se indikatori për këtë periudhë raportuese është arritur në masën 48%.

Megjithatë, për të vlerësuar arritjet e sektorit gjatë vitit, duhet të përfshihet edhe treguesi i dytë i performancës, që është numri i rasteve të korrupsionit të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve në www.shqiperiaqeduam.al, të cilat i raportohen Policisë së Shtetit/Prokurorisë Shqiptare. Sillet në vëmendje se ADB nuk bën drejtpërsëdrejti kallëzime penale në prokurori, pasi rastet e ardhura në platformën e saj, pasi filtrohen, kalojnë për trajnim tek Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit. Gjatë 6M1 të vitit 2023, ADB ka përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion 7 raste të reja. Në përfundim të hetimeve administrative nga DPA janë përcjellë pranë organit të Prokurorisë 9 kallëzime për ndjekje penale, me 28 persona të kalëzuar.

Gjatë vitit 2022, DPA ka përcjellë pranë organit të Prokurorisë, 20 kallëzime. Targeti i vitit 2023 është 40% në krahasim me vitin paraprak, pra 28 kallëzime penale. Deri tani janë kryer 9 kallëzime. Indikatori për këtë periudhë raportuese vlerësohet se është arritur në masën 32%.

- Mënyra se si aktivitetet dhe masat kanë ndikuar/ çuar në realizimin/ mosrealizimin e treguesit:

DRAFT

Aktivitetet dhe masat kanë ndikuar në realizimin e treguesit duke krijuar një ndikim pozitiv në angazhimin e qytetarëve në luftën kundër korrupsionit dhe përdorimin e mekanizmave të denoncimit. Platforma www.shqiperiaqeduam.al ka krijuar një mjet të thjesht për qytetarët për të denoncuar raste të korrupsionit. Platforma ofron një mënyrë të sigurtë dhe të besueshme për të raportuar veprimet e dyshimta të korrupsionit. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje ka ndërmarrë masa për të informuar dhe promovuar platformën në publik. Kjo ka përfshirë fushata informuese në media dhe organizimin e takimeve të hapura për të treguar për funksionimin e platformës dhe rëndësinë e denoncimeve të qytetarëve. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion kanë punuar në përpunimin dhe trajtimin e denoncimeve të pranuara në platformë. Kjo përfshin analizën e detajuar të rasteve, identifikimin e provave dhe dërgimin e tyre për hetime administrative ose penale tek organet kompetente. Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion ka siguruar bashkëpunimin dhe koordinimin e veprimeve me Policinë e Shtetit dhe Prokurorinë. Kjo ka lejuar transferimin e rasteve të konfirmuara të korrupsionit për hetime administrative dhe penale, duke siguruar që ata përfundojnë në organet e drejtësisë për ndjekje penale.

- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në arritjen e objektivit specifik:

Treguesi i parë, që është numri i denoncimeve të qytetarëve për korrupsion të denoncuara në platformën www.shqiperiaqeduam.al, tregon se ka pasur një interes të vazhdueshëm dhe nxitje të publikut për të përdorur mekanizmat e denoncimit. Për të arritur këtë tregues, është dashur që publiku të jetë i informuar dhe të ketë besim në efektivitetin dhe besueshmërinë e platformës. Nëse numri i denoncimeve është në rritje, siç tregohet nga numri i denoncimeve të konstatuara prej 1440, kjo tregon se publiku po angazhohet aktivisht në denoncimin e rasteve të korrupsionit dhe është i motivuar për të luftuar fenomenin.

Treguesi i dytë i performancës, që është numri i rasteve të korrupsionit të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve në platformën www.shqiperiaqeduam.al dhe i raportuar në Policinë e Shtetit/Prokurori, tregon efektivitetin e mekanizmave të denoncimit dhe trajtimit të rasteve. Nëse numri i rasteve të korrupsionit të raportuara është në rritje dhe ato përfundojnë në organet e drejtësisë për ndjekje penale, siç tregohet nga numri i kallëzimeve për ndjekje penale të përcjellura prej 9, kjo tregon se denoncimet janë të besueshme dhe kanë rezultuar në veprime të mëtejshme të institucioneve përballë rasteve të dyshuara të korrupsionit.

Në këtë mënyrë, arritja e treguesit të parë dhe të dytë të performancës tregon se publiku është nxitur dhe ka përdorur aktivisht mekanizmat në denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit. Duke raportuar raste dhe duke i shpallur ato organave të drejtësisë, publiku po merr pjesë aktive në luftën kundër korrupsionit dhe është i angazhuar në parandalimin e tij. Ky ndikim, ndihmon në realizimin e objektivit specifik dhe përforcon përpjekjet për të luftuar korrupsionin dhe promovuar integritetin në shoqëri.

- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në parandalimin/goditjen/ndërgjegjësimin (sipas qasjes së treguesit/objektivit specifik):

Arritja e treguesit të numrit të denoncimeve të korrupsionit dhe numrit të rasteve të korrupsionit të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve ka një ndikim të rëndësishëm në parandalimin dhe ndëshkimin e korrupsionit në shoqëri. Këto tregues dëshmojnë për përfshirjen dhe angazhimin e publikut në denoncimin e veprimeve të dyshimta të korrupsionit dhe për transmetimin e tyre tek organet kompetente të drejtësisë. Në aspektin e parandalimit të korrupsionit, arritja e treguesit dëshmon se publiku është i vetëdijshëm dhe i përfshirë në luftën kundër korrupsionit. Me një numër të lartë të denoncimeve të pranuara, ka më shumë mundësi që rastet e korrupsionit të jenë nën vëzhgim dhe që autorët e tyre të gjurmohen.

Në aspektin e ndëshkimit të korrupsionit, arritja e treguesit tregon se mekanizmat e denoncimit dhe bashkëpunimi mes publikut, Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë janë efektive. Rastet e denoncuara që përfundojnë në organet e drejtësisë dhe që rezultojnë në kallëzime për ndjekje penale dërgojnë një mesazh të fortë mbi veprimin e organeve publike ndaj rasteve të korrupsionit.

Përveç ndëshkimit të autorëve të korrupsionit, arritja e treguesit ka edhe një ndikim parandalues. Nëse qytetarët kanë besim se denoncimet e tyre do të trajtohen në mënyrë serioze dhe se ato do të kenë pasojat e duhura, ata janë më të gatshëm të denoncojnë raste të dyshimta të korrupsionit. Pra, arritja e treguesit të numrit të denoncimeve dhe rasteve të korrupsionit të raportuara ndihmon në parandalimin e mëtejshëm të korrupsionit duke rritur vetëdijen, përfshirjen dhe bashkëpunimin e publikut.

- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në zbatimin e reformave kyçe antikorrupsion/ mireqeverisjes (SKZHI):

Arritja e treguesit të numrit të denoncimeve të korrupsionit dhe numrit të rasteve të korrupsionit të raportuara ka një ndikim të rëndësishëm në zbatimin e reformave kyçe antikorrupsion dhe mirëqeverisjes në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Europian. Në nivelin e reformave kyçe antikorrupsion, arritja e treguesit tregon se mekanizmat e denoncimit dhe institucionet përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit janë funksionale dhe janë në gjendje të përpunojnë dhe të trajtojnë denoncimet në mënyrë efektive. Kjo ndihmon në zbatimin e reformave ligjore dhe institucionale për forcimin e sistemit të drejtësisë, pavarësisht nga ndikimet politike dhe korruptive. Ky proces është jetik për të ndërtuar një sistem ligjor të qëndrueshëm dhe për të krijuar besim tek institucionet shtetërore dhe ligjore.

Në lidhje me komponentin antikorrupsion, arritja e treguesit tregon se ka ndodhur një rritje e angazhimit dhe përfshirjes së publikut në denoncimin e korrupsionit. Kjo reflekton rritjen e

vetëdijes së publikut për rëndësinë e korrupsionit dhe dëshirën për të kundërshtuar fenomenin në shoqëri. Në këtë mënyrë, arritja e treguesit kontribuon në krijimin e një kulture të mireqeverisjes dhe transparencës, ku qytetarët janë pjesëmarrës aktivë në zbatimin dhe monitorimin e politikave dhe projektet qeveritare. Kjo rrit besimin e publikut në institucionet shtetërore dhe krijon një mjedis të favorshëm për ndërtimin e një shoqërie të mireqeverisur.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Europian funksionon si strategji ombrellë për të gjitha strategjitë e tjera kombëtare, duke përfshirë edhe komponentin antikorrupsion. Arritja e treguesit të numrit të denoncimeve dhe rasteve të korrupsionit të raportuara përmes platformës www.shqiperiaqeduam.al dhe trajtimit të tyre nga institucionet relevante kontribuon në zbatimin e politikave dhe reformave specifike antikorrupsion të përcaktuara në strategji. Kjo krijon një sinergji midis përpjekjeve të qeverisë dhe angazhimit të publikut, duke forcuar kuptimin dhe zbatimin e reformave për të luftuar korrupsionin dhe promovuar mirëqeverisjen në vend.

- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në procesin e integrimit evropian:

Arritja edhe e pjesshme e treguesit të numrit të denoncimeve të korrupsionit dhe numrit të rasteve të korrupsionit të raportuara ka një ndikim të rëndësishëm në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë. Kombinimi i përpjekjeve për luftën kundër korrupsionit dhe përforcimin e sistemit të drejtësisë është thelbësor për përparimin e vendit në rrugën drejt integrimin evropian. Në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian, Shqipëria ka demonstruar angazhim real për luftën kundër korrupsionit (*vlerësuar kjo edhe nga GRECO*) dhe përforcimin e sundimit të ligjit. Arritja e treguesit të numrit të denoncimeve dhe rasteve të korrupsionit tregon se Shqipëria po bën përpjekje aktive në këtë drejtim dhe është në rrugën e duhur drejt pajtueshmërisë me kriteret evropiane.

Në këtë kuadër është gjithashtu e nevojshme të kemi institucione të forta dhe transparente që luftojnë korrupsionin. Arritja e treguesit tdëshmon se mekanizmat e denoncimit dhe institucionet shtetërore janë funksionale dhe kanë aftësinë për të trajtuar dhe ndjekur rastet e korrupsionit. Ky faktor krijon një bazë të fortë për zbatimin e reformave institucionale që kërkon procesi i integrimit evropian. Kontributi në luftën kundër korrupsionit, forcimi i sistemit të drejtësisë dhe krijimi i një mjedisi të besueshëm institucional janë faktorë të rëndësishëm për përparimin në rrugën drejt Europës dhe për realizimin e parimeve evropiane të mirëqeverisjes dhe sundimit të ligjit.

| Kodi | Objektivi Specifik | Treguesit e Performancës | Institucioni përgjegjëse për mbledhjen e informacionit | Frekuenc e mbledhjes së të dhënave | Vlera bazë/Viti | Vlera e arritur për periudhën e mëparshme raportuese | Shkalla e realizimit të vlerës së synuar për periudhën e mëparshme raportuese | Vlera e synuar për periudhën raportuese (konkretisht viti 2023) | Vlera arritur për periudhën raportuese (konkretisht 6M1 2023) | Realizimi i vlerës së synuar për periudhën raportuese | Zbatimi i Objektivit Specifik[70] | Probleme/ çështje për t'u shënuar | Hapat e Rradhës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **C3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile** | C.3.a: Hartimi i një Programi Anti-korrupsion nga AMSHC-ja | AMSHC | Vjetor | Viti 2017<br><br>N/A | Viti 2022<br><br>AMShC ka hartuar dhe publikuar një vlerësim mbi zbatimin e programit Anti-korrupsion.<br><br>Gjatë vitit 2022, është përfunduar vlerësimi i jashtëm mbi Programin Anti-Korrupsion të vitit 2021. | 100 % | Viti 2023<br><br>Është përfunduar vlerësimi i jashtëm mbi Programin Anti-Korrupsion të vitit 2022 | Nuk është përfunduar vlerësimi i jashtëm mbi Programin Anti-Korrupsion të vitit 2022 | 0% | | | Vijimi i mbështetjes financiare të projekteve anti-korrupsio |
| | | C.3.b: Përqindja e projekteve mbi anti-korrupsionin të financuar nga AMSHC | AMSHC | Vjetor | Viti 2017<br><br>14.29% | Viti 2022<br><br>Mungon raportimi | 0 % | Viti 2023<br><br>25% | Nuk ka ende një përqindje të projekteve mbi anti-korrupsionin të financuar nga AMSHC | 0% | | | Vijimi i mbështetjes financiare të projekteve anti-korrupsio |
| | | C.3.c: Buxheti i përcaktuar për mbështetjen e Projekteve të Anti-korrupsionit nga OSHC-të | AMSHC | Vjetor | Viti 2017<br>13.56% | Viti 2022<br><br>AMShC ka shpallur kandidatë përfitues të fondeve, një numër organizatash me një vlerë rreth 12.000.000, por kjo vlerë nuk është e dedikuar për projektet antikorrupsion | 0 % | Viti 2023<br><br>25% | Nuk ka ende buxhet të përcaktuar për mbështetjen e Projekteve të Anti-korrupsionit nga OSHC-të | 0% | | | |

70 Sipas formulës $NR = \frac{TP1NR+TP2NR+TP3NR+TP4NR}{Numri\ në\ i\ Treguesve\ të\ Performancës\ për\ objektiv}$ X 100%

- Arritje/mosarritje të sektorit gjatë vitit, që kanë ardhur si rezultat i realizimit/ mosrealizimit të treguesit:

Përgjatë vitit 2023, është vijuar mbështetja financiare të projekteve me objekt anti- korrupsion.

- Mënyra se si aktivitetet dhe masat kanë ndikuar/ çuar në realizimin/ mosrealizimin e treguesit:

Masat e marra nga Bordi Mbikqyrës, në funksion të përballimit të Pandemisë, çuan në mosrealizimin e treguesit. E tërë kjo situatë, ka ardhur si pasojë e reduktimit të fondeve nga ana e Qeverisë Shqiptare për AMShC- në.

- Ndikimi i arritjes/ mosarritjes së treguesit në arritjen e objektivit specifik:

Ndikimi i treguesit është indikator për arritjen e objektivit për shkak se plotësimi i normës së financimit, varet edhe nga organizatat lidhur me çfarë ato kërkojnë të zbatojnë.

- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në parandalimin/goditjen/ndërgjegjësimin (sipas qasjes së treguesit/objektivit specifik):

Arritja relative e treguesit, ka ndikuar në parandalimin sensibilizues të objektivit.

- Ndikimi i arritjes/mosarritjes së treguesit në zbatimin e reformave kyçe antikorrupsion/ mireqeverisjes (SKZHI):

Duke marrë shkasë se aktivitetet janë në baza vjetore, AMShC, merr përsipër që përgjatë vitit 2023, të realizojë të gjitha masat e parashikuara.

· Ndikimi i arritjes/ mosarritjes së treguesit në procesin e integrimit evropian:

Ndikimi i mosarritjes së treguesit, është i ulët përgjatë vitit 2023.

# Aneksi II. Aneksi i Masave dhe Aktiviteteve Janar - Qershor 2023

| Kodi | Objektivat Strategjike dhe Institucionet Përgjegjëse Respektive | Periudha e zbatimit të Planit të Veprimit | | | Kosto indikative PV | Buxheti i planifikuar për vitin raportues | | Buxheti i përdorur | Progresi deri më tani | | Problematikat | Hapa të tjerë | Afati i përfundimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Fundi i vitit | Vlera e Targeti | /OOO total | Totali në % | /OOO total | Totali në % | Buxheti i përdorur deri më tani krahasuar me buxhetin indikativ (në %) | Jep me % zbatimin për çdo Qëllim Politike dhe Objektiv Specifik | I zbatuar<br><br>Zbatuar pjesërisht<br><br>I pazbatuar | text | text | text |
| **1** | **Buxheti total për strategjinë** | | | **Totali 1+2+3** | **100** | | | | | | | | |
| 1 | Qasja parandaluese | | | Totali 1 | | | | | | | | | |
| A.1 | A1. Ritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion | | | | | | | | | | | | |
| | KDIMDHP | | | | | | | | | | | | |
| | 01110 Planifikim, Menaxhim dhe Administrim | | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | KDIMDHP | | | | | |
| A.1.1 | Krijimi i sistemit të matjes së transparencës dhe llogaridhënies, përfshirë metodologjinë e studimit dhe një grup treguesish të transparencës me qëllim matjen dhe raportimin në mënyrë periodike të nivelit të transparencës tek autoritetet publike qendrore dhe të varësisë | 16,464 | | | **Zbatuar pjesërisht / në proces** | 2023 |
| A.1.1. 1 | 1 (një) Raport vjetor mbi indeksin e Transparences së Autoriteteve Publik | Kosto administr ative | | 50% | **Në proces**<br>Raporti vjetor mbi indeksin e Transparencës së këtyre autoriteteve publike është parashikuar për zbatim në 3M4 2023. | 2023 |
| | KDIMDHP | | | | | |
| A.1.1. 2 | Monitorim të transparencës në sasinë e 1/4 të numrit total te autoriteteve publike çdo 3 mujor | 4,116 ( për çdo vit të PV) | 1029 | 100% | **Zbatuar**<br>Është realizuar monitorimi i programeve të transparencës mbi 1/2 të Autoriteteve Qendrore dhe të Varësisë. Në total janë monitoruar 200 nga 313 autoritete publike. | 2023 |
| | KDIMDHP | | | | | |
| A.1.2 | Krijimi i sistemit të matjes së transparencës dhe llogaridhënies, përfshirë metodologjinë e studimit dhe një grup treguesish të transparencës me qëllim matjen dhe raportimin në mënyrë periodike të nivelit të transparencës tek njësitë e vetqeverisjes vendore | 16,464 | | | **Zbatuar pjesërisht / në proces** | 2023 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1.2. 1 | 1 (një) Raport vjetor mbi indeksin e Transparencës së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore | Kosto administr ative | | 50% | **Në proces**<br>Raporti vjetor mbi indeksin e Transparencës së këtyre autoriteteve publike është parashikuar për zbatim në 3M4 2023. | 2023 |
| | KDIMDHP | | | | | |
| A.1.2. 2 | Monitorim të transparencës në sasinë e 1/4 të numrit total te autoriteteve publike çdo 3 mujor | 4,116 ( për çdo vit të PV) | 1029 | 100% | **Zbatuar**<br>Ky monitorim është realizuar në sasinë ½ të numrit total të autoriteteve publike/ njësitë e vetëqeverisjess vendore. Në total janë monitoruar 31 nga 61 Njësi të Vetëqeverisjes Vendore. | 2023 |
| | KDIMDHP | | | | | |
| A.1.3 | Instalimi i regjistrit qëndror të kërkesave dhe përgjigjeve dhe mbikëqyrja e përditësimit të regjistrit nga ana e koordinatorëve për të drejtën e informimit (2020-21 institucione; 2021-24 institucione; 2022-25 institucione; 2023-25 institucione). | 16,008 | | | **Zbatuar** | 2023 |
